



UBT NEWS

Gazetë e studentëve të UBT-së | Janar 2021

POLITICS | ECONOMY | BUSINESS | TECHNOLOGY | EDUCATION | SCIENCE | CULTURE



**Konferenca Ndërkombëtare
e UBT-së mblodhi mbi 700
hulumtues shkencorë**



Faqe 5-6

**UBT mbajti 28 konferenca
online në kohën e pandemisë**




Faqe 7-8

**UBT, institucioni që bëri
revolucion në edukimin
virtual në kohë pandemie**



Faqe 4

- Një hap para të tjerëve | Faqe 9-15
- Aktivitete | Faqe 16-19; 32-37
- Storje suksesi | Faqe 22-31



Recognised for Excellence 5 star

Awarded to: UBT

April 2019

This certificate remains valid for 3 years.



Russell Longmuir



20 YEARS

LEADERSHIP and INNOVATION

Education | Research | Training | Consulting

2001/2021

IMPRESUM

UBT News – gazetë e studentëve
 Botues: Edmond Hajrizi
 Numrin e përgatitën:
 Jehona Kapllani, Edona Jerliu,
 Anisa Rada, Florend Bajrami, Edonit Behluli dhe studentët e Media dhe Komunikimit

Adresa: www.ubt-uni.net


Tel: 038 541 400, 044 541 400

Përgatitje grafike: Albert Zuka

Global UBT Fest 2020

UBT organizoi festivalin më të madh akademik në Kosovë

Për herë të parë në Kosovë, UBT ka organizuar festivalin më të madh akademik e shkencor, Global UBT Fest 2020, festival ky me një qasje ndërdisiplinore, i organizuar në formën online. Ky festival mori vëmendjen e rreth 15 mijë pjesëmarrësve nga vendi, rajoni dhe Evropa, të cilët përgjatë një muaji ndoqën akademi të shumta online, forume, aktivitete kulturoro-artistike, hackings, etj. Në hapje të këtij festivali rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi u shpreh i lumtur që UBT po i ka ofruar Kosovës festivalin akademik me përmasa globale. “Kosova tashmë ka festivalin më të madh akademik me përmasa globale, që lidhet me zhvillimin ekonomik, ndërmarrësisë, inovacionin dhe politikën, ku pritet të marrin pjesë mbi 15 mijë pjesëmarrës që është numër rekord në këtë kohë pandemie. Festivali nuk do të mbahet në mënyrë fizike si shkak i pandemisë, kësaj here Kosovën do ta bëjmë të njohur përmes festivalit më të madh në Evropë në mënyrë virtuale”, tha rektori Hajrizi. Në këtë festival u shpërfaq një qasje ndërdisiplinore, teksa u prezantuan praktikat më të mira në 31 fusha të jetës. U prezantuan ligjërata e u mbajtën kurse nga fusha të ndryshme, nga rreth 500 profesorë, ekspertë, artistë, studentë vendor dhe ndërkombëtarë, që ishin pjesë e aktiviteteve të larmishme, nga më shumë se 150 vende të botës. Ky festival që filloi me 6 korrik dhe mbaroi me 6 gusht, organizoi nën ombrellën e saj 30 Akademi Ndërkombëtare Verore, 25 forume, 25 ngjarje/aktivitete, gara hackings, aktivitete kulturorë e artistike. Akademia verore këtë vit organizoi edicionin e nëntë të saj, me ligjërues e ekspertë vendor e ndërkombëtarë në 31 akademi verore, me emra eminent të fushave përkatëse. Aktiviteti i Akademisë Verore është shtrirë në fusha të ndryshme duke përfshirë: Art dhe Media Digjitale, Mekatronikë, App Fair, Arkitek-




turë dhe Planifikim Hapësinor, VR Academy, Në ceremoninë përmbyllëse të ngjarjes më të madhe akademike në rajon, “Global UBT Fest 2020”, rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, potencoi se festivali ishte i ndërlidhur me të gjitha resurset e UBT-së, si i tillë mori edhe formën e një festivali ndërkombëtarë. Rektori Hajrizi tha se “Global UBT Fest 2020” zgjoi interesimin e pjesëmarrësve nga shumë shtete ndërkombëtare, teksa në fokus kishe inovacionin, zhvillimin e qëndrueshëm, njëherësh pati këndvështrim akademik. “Festivali që është organizuar nga UBT, pati formën e një festivali global, ngaqë zgjoi interesimin e pjesëmarrësve nga shumë shtete të botës. Fokusi

i festivalit ka qenë reziliencia, inovacioni, zhvillimi i qëndrueshëm, pati këndvështrime akademike, u prezantuan shumë tema që prekin aspekte të jetës, dhe gjitha kjo krijoi një eksperiencë të re. Ky festival doli si rezultat i punës së Akademisë Verore Ndërkombëtare për të nëntin vit me radhë, por këtë vit kemi shtuar forume, konferencat, ekspozitat e ndryshme, si dhe këto e kanë formuar në festival të dijës”, theksoi Hajrizi. Ndërkaq zyrtarët e Qendrës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar në UBT, Lirigzona Morina, Ensar Bajrami dhe Erëza Mehmeti, treguan se institucioni përgjatë një muaji zhvilloi aktivitete dhe ngjarje me karakter ndërkombëtar, teksa thanë se festivali ka tejkalu-

ar pritshmërisë për sa i përket pjesëmarrësve. “Festivali u cilësua si ngjarja më inovative në kohën më të vështirë në të cilën po kalon bota, pandemia. Konkretisht UBT Fest ka përcjellë 500 folës vendor e ndërkombëtarë. Një falënderim i veçantë shkon edhe për Media Group-in, të cilët në mënyrë profesionale kanë raportuar lidhur me ngjarjet që ndodhën përgjatë një muaji, njëherësh edhe grupin e IT-së. Po ashtu, edhe sponsorët që na përkrahen, RTK-në, Portalin Telegraf, Ekonomia online”, tha Lirigzona Morina. “Kemi pasur në total 31 akademi verore, 25 forume, 25 ngjarje, 15 hacking, Expo and start-Ups Zones, kjo i ka tejkaluar parashikimet dhe pritshmërinë tonë. Ka qenë eksperiencë e jashtëzakonshme”,

potencoi Ensar Bajrami. “Global UBT Fest ka qenë një prej ngjarjeve me më së shumti pjesëmarrës, ku kemi pasur mbi 10 mijë pjesëmarrës nga vendi rajoni, dhe vendet tjera botërore. Pjesëmarrës kanë qenë shumë të kënaqur, fillimisht për festivalin, për ligjëruesit, për interaktivitetin, teksa janë falënderuar që në këto kohë pandemie u janë ofruar më të rejtat nga 31 fusha të jetës”, tregoi Erëza Mehmeti. Nga Qendra Këshilluese në UBT, ka folur Vjollca Pllana, e cila theksoi se në aktivitetet e akademisë verore u zhvilluan aktivitete dhe u prezantuan hulumtime shkencore, ku morën pjesë profesionistë shëndetësor. “Qendra këshilluese edhe këtë vit ka mbajtur aktivitete në kuadër të festivalit, si dhe ka tejkaluar pritshmëritë tona si organizatorë, dhe kjo na ka motivuar. Virtualisht gjithçka ka shkuar shumë mirë, si në aspektin teknik, si në aspektin e pjesëmarrësve dhe sesioneve. Kanë marrë pjesë shumë profesionistë shëndetësor, pjesëmarrës vendor e ndërkombëtarë, e janë prezantuar hulumtime shkencore. Janë mbajtur aktivitete të ndryshme, punëtori”, tha Pllana. Ndërkohë drejtori i Qendrës për Shërbime Profesionale dhe Produkte, Besnik Skenderi, tha se në kuadër të këtij festivali u mbajt akademi për Shkolla Profesionale, e para e këtij lloji në Kosovë. “Në kuadër të UBT-së, departamenti për Shërbime Profesionale dhe Produkte, ka organizuar edhe akademinë profesionale, e para e këtij lloji në Kosovë, që u organizua për të promovuar produkte profesionale. Me pjesëmarrës të shumtë, kjo akademi është karakterizuar më pjesëmarrës të fushave të ndryshme dhe jo vetëm të fushës teknike. Folës të jashtëzakonshëm, ku kanë përmendur trendet e teknologjisë, etj., njohuri që janë praktikuar përgjatë akademisë”, theksoi Skenderi.



UBT, institucioni që bëri revolucion në edukimin virtual në kohë pandemie



UBT është angazhuar që nga dita e parë që të mbështes me kapacitetet ekzistuese, si dhe kontribuoi drejtpërdrejt në parandalimin e pandemisë botërore të shkaktuar nga Coronavirusi (COVID-19), duke mobilizuar për këtë qëllim burimet njerëzore dhe tërë infrastrukturën teknologjike.

Menjëherë pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për ndërprerjen e procesit edukativo-arsimor në institucioneve arsimore publike dhe private, si masë parandaluese për mbrojtje nga coronavirusi, UBT mobilizoi të gjithë stafin dhe flakë teknologjisë që posedon, planet, mësimin dhe gjithçka i zhvendosi shpejtë e suksesshëm në platformat online.

Shkaku i masave parandaluese me qëllim të mos përhapjes së virusit në vendin tonë, ishim të detyruar të qëndrojmë jashtë amfiteatrove, laboratorëve, klinikave, studiove dhe të reduktojmë prezencën në zyrat tona, mirëpo UBT qëndroi aktiv duke mos u pasivizuar,



duke vlerësuar që edukimi nuk ndalet as në kohët më të vështira, pra jeta akademike vazhdoi fuqishëm me moton "universities never sleep".

Për këtë qëllim, stafi i UBT-së dizajnoi një sistem të integruar për të ndihmuar studentët dhe stafin që të jenë aktiv, të veprojnë edhe në kohë krize dhe të qëndrojnë së bashku përmes teknologjisë së internetit, online dhe në mënyrë virtuale, nga secili vend dhe në secilën kohë.

Duke qenë kështu, mbi 10 mijë studentë e rreth 1 mijë profesorë të UBT-së, menjëherë pas masave të kufizimit filluan mësimin online, përvetësimin e aftësive teorike dhe praktike përmes mësimin të avancuar online.




Me këtë mënyrë të mësimin tejet inovativ morën pjesë 10 mijë studentë, u krijuan 54 mijë mësim, në 141 kurse universitare, e që përfshijnë mbi 20 programe të ndryshme.

Këtë fakt e ka vlerësuar lartë edhe kompania më e madhe

botërore për teknologji virtuale, "EON Reality", ku potencoi rëndësinë se si një institucion nga Kosova përgjatë kohës së pandemisë ka bërë revolucion në sistemin e edukimit përmes platformave Virtual Reality.



UBT përveç iniciativave që mori për zhvendosjen e mësimin online në edukim, bëri një kalim tjetër të rëndësishëm inovativ duke instaluar sistemin e Realitetit Virtual në edukim. Përgjatë kohës së pandemisë, UBT arriti që të ndryshoj standartet arsimore tradicionale duke instaluar procesin e mësimin në CLASSROOM 3.0 si një formë e të ardhmes në edukim.



UBT organizoi edicionin e nëntë të Konferencës Ndërkombëtare për Shkencë, Teknologji, Biznes dhe Inovacion

Konferenca Ndërkombëtare e UBT-së mblodhi mbi 700 hulumtues shkencorë



Me qëllim për të dhënë kontribut në zhvillimin e shkencës dhe të hulumtimit, si dhe për të mundësuar prezantimin e rezultateve të punës shkencore të profesionistëve të fushave të ndryshme, UBT me sukses ka organizuar edicionin e nëntë të Konferencës Ndërkombëtare për Shkencë, Teknologji, Biznes dhe Inovacion. Edicioni i sivjetmë mblodhi mbi 1000 pjesëmarrës, 700 hulumtues shkencorë, prej të cilëve rreth 300 ndërkombëtarë. Punimet morën vlerësime të larta, pasi që ishin profesionale, inovative dhe shumë të nevojshme për fushat në të cilat konferenca shtriu aktivitetin e saj. Përmes organizimit të ngjarjeve të tilla të mëdha shkencore, UBT po bashkon komunitetin e shkencëtarëve, dhe po jep kontribut në zhvillimin e shkencës, duke u mundësuar profesorëve, studentëve e hulumtuesve shkencorë që të prezantojnë të gjeturat dhe hulumtimet e tyre në fusha të ndryshme. Konferenca Ndërkombëtare e UBT-së për Shkencë, Teknologji, Biznes dhe Inovacion, këtë vit aktivitetin e saj e shtriu në 26 fusha të ndryshme që u mbajtën njëkohësisht, përmes platformës online, duke përfshirë fushat: Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri e Komunikimit, Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Mekatronikë, Inxhinieri e Sistemeve dhe Robotikë, Inxhinieri e Energjisë Eficiente, Sisteme të Infor-

macionit dhe Siguri, Arkitekturë – Planifikim Hapësinor, Inxhinieri Ndërtimore, Infrastrukturë dhe Ambient, Juridik, Shkenca Politike, Gazetari, Media dhe Komunikim, Shkenca të Ushqimit dhe Teknologji, Shkenca Farmaceutike dhe Natyrore, Dizajn, Psikologji, Edukim dhe Zhvillim, Modë, Muzikë, Art dhe Media Digjitale, Stomatologji dhe Mjekësi e Aplikuar. Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ka potencuar se konferenca po ndihmon në rrjetëzimin e institucioneve nga shumë vende të botës, teksa ka falënderuar secilin student dhe studiues që kanë dhënë kontribut në bërjen e kësaj konference madhështore. Sipas tij, kjo ngjarje shkencore mundëson shkëmbimin e njohurive dhe shkathtësive në mes të hulumtuesve, profesorëve, studentëve të doktoratës dhe ekspertëve të ndryshëm nga industria. “Kosova përmes UBT-së ka sjellë një frymë evropiane dhe digjitale të aktiviteteve, sidomos aktivitetet me karakter shkencor. Në këtë kohë pandemie është hera e parë që mbahet virtualisht një ngjarje e tillë shkencore më e madhja në Evropën Juglindore, por këtë vit në këtë edicion, të nëntin me radhë, UBT ka arritur jo vetëm të organizojë, por të pranojë hiç më pak se rreth 600 punime shkencore, me rreth 1 mijë autorë, nga shumë shtete të botës”, ka thënë rektori Hajrizi. Sikurse edhe viteve të kaluara, edhe

këtë vit, konferenca u pasurua me pjesëmarrjen virtuale të ekspertëve dhe profesorëve ndërkombëtarë. Moshe Landsman, Philip Ubertini, Paolo Parisi, Andrew Goodspeed dhe Erzsebet Kaponyi nderuan punimet e këtij edicioni me fjalë rasti, të cilët thanë se kjo konferencë shërben si mundësi dhe indikatorë në zhvillimin e inovacioneve edhe në vend.

Ndër të tjerë pjesë e konferencës ishin:

Në Arkitekturë: Vladimíra Šilhánková, Bekim Ceko, Zeke Islamaj, Besa Jagxhiu, Hazir Çadraku, Kujtim Elezi, Nuran Saliu, Pajazit Hajzeri, Michael Pondělíče, W. Verleure, Nora Cimili, Petrit Ahmeti, Zejnulla Rexhepi, Safete Veliu, Lulzim Beqiri, prof. dr. Edmond Hajrizi, Strahinja Trpevski, Dimitar Papasterevski, Nuran Saliu, Andrea Maliqari, Kujtim Elezi, Ferhat Bejtullahu, Besa Jagxhiu, Venera Goxha, Nexhat Balaj, Strahinja Trpevski, Zaklina Angelovska, Nexhat Coçaj, Rrahim Sejdiu, Blertë Sylejmani, Anduela Kasumaj, Kaltrina Spahiu, Kaltrinë Mjaku, Banush Shyqeriu, Zaklina Angelovska, Strahinja Trpevski, Binak Beqaj, Shqiprim Ahmeti, Iclal Kaya, Elvida Pallaska, Ajet Gashi, Drenushë Fidani, Violeta Gesovska, Valentina Zileska Pancovska, Ylber Limani, Belinda Limani, Marjan Ivezaj, Skender Kosumi, Arber Sadiki, Ajhan Bajmaku, Enis Jakupi, Erda Besimi, Granit Haxhimustafa, Rame Hamzaj, Bard

Bajqinovci, Lulzim Beqiri, Bleona Zymberi, Lulzim Beqiri, Jetesa Qerimi, Lulzim Beqiri, Era Krasniqi, Sadije Kelmendi, Dren Gojani, Petrit Ahmeti, Faton Spahiu, Visar Shllaku, Arsim Murseli, Besian Sinani, Serhat Çelikten, Mimoza Sylejmani, Lulzim Beqiri, Rineta Jashari dhe Zana Prelvukaj.

Në Art dhe Media Digjitale: Arben Arifi, Gazmend Ejupi, Nora Weller, Fitore Isufi, Gazmend Ejupi, Burim Berisha, Blerim Gjinovci, Alban Muja dhe Laura Ymeri.


Në Inxhinieri të Ndërtimit: Muhamet Ahmeti, Feti Selmani, Filipo Ubertini, Stojan Kravanja, Tomaz Žula, Bledina Nela, Francesco Rucci, Ferit Gashi, Franco Bontempi, Ferit Gashi, Franco Bontempi, Egla Luca, Ilir Hetemi, Almedina Rapuca, Arsim Rapuca, Namik Kopluku, Naim Munishi, Besa Jagxhiu, Hazir Çadraku, Yasmine Hodza, Erion Luga, Kreshnik Merxhan, Ermal Osaj, Mergim Thaçi, Anjeza Alaj, Agon Sadikaj, Ragip Behrami, Lekë Krasniqi, Driton Kryeziu, Blertë Retkoceri, Idaver Huseini, Fidaim Sahiti, Ahmet Bytyçi, Andrin Kërpaçi, Ilir Abdullahu, Skender Bublaku, Faruk Hajrizi, Bekim Selimi, Ermal Daka, Anjeza Alaj-Murati, Arbëresha Kastrati, Ferhat Bejtullahu, Ilir Mehmedi, Blerton Çalaj, Seda Hatipoğlu, Beni Kizolli, Nol Dedaj, Afrim Sylja, Ahmet Dokuyucu, Flaka Deda, Edon Maliqi, Ramë Hamzaj, Emine Daci, Marjan Ivezaj, Ko-

standin Kristo, Shemsi Mustafa, Febbie C. Verano, Emerson N. Lalamonan, Roselene Tabilon-Tizon, Arberesha Kastrati, Hysniye Jashrai, Egla Luca, Hysen Ahmeti dhe Visar Krelani.

Në SHKI: Edmond Jahjaga, Ramiz Hoxha, Arber Kadriu, Dijar Kadriu, Donjet Salihi, Olimpion Shurdi, Aleksander Biberaj, Iglu Tafa, Genci Mesi, Edin Bula, Besnik Qehaja, Ines Bula, Muhamet Avdyli, Elhame Maloku, Kushtrim Pacaj, Kujtim Hyseni, Donika Sfishta, Edi Hasaj, Samir Ajdarpasiç, Medina Shamolli, Diellza Berisha, Qëndrim Muçolli, Shkëlqim Berisha, Era Kastrati, Muhamet Avdyli, Mirlinda Reqica, Meriton Reqica, Bertan Karahoda, Besnik Qehaja, Behar Haxhismajli, Emin Emini, prof. dr. Edmond Hajrizi, Armend Salihu, Mërgim Hoti, Arber Hoti, Aleksander Biberaj, Olimpion Shurdi, Bledar Kazia, Renalda Kushe, Alban Rakipi, Ermira Daka, Bleron Klaiq, Arjanit Mehana, Krenare Pireva Nuci, Arbër Perçuku, Eriqona Gashi, Vehbi Neziri, Vesa Morina, Lumbardh Elshani, Egzon Hasi, Emin Emini, Behar Haxhismajli, Shpetim Sadriu, Fëllanza Avdimetaj, Zhilbert Tafa, Xhafer Krasniqi, Xhafer Krasniqi, Besnik Qehaja, Boris Arsov, Zoran Aleksov, Vergim Sherifi, Nenad Popovic, Ana Savic, Goran Bjelobaba, Veselinovic Ceda, Hana Stefanovic, Besnik Zabergja, Agon Mehmeti, Andrea Alberici, Kozeta Sevrani, Liza Berisha, Besnik

Duke gërshetuar teknologjinë,

UBT mbajti 28 konferenca online në kohën e pandemisë



Për herë të parë në Kosovë dhe rajon, në një format duke ndërlidhur teknologjinë dhe duke përdorur edhe faqet zyrtare në platformat Facebook, Instagram dhe Youtube, në televizionin "UBT" dhe në Radio "Campus", UBT mbajti 28 video-konferenca online.

Mbështetur nga Grupi i Mediave dhe Grupi i IT-së, konferencat u organizuan me qëllim të informimit, vetëdijesimit dhe diskutimit për pandeminë Covid-19 që ka kapluar botën, teksa u trajtuan tema të fushave të ndryshme.

Temat që u trajtuan gjatë konferencave online janë: "Roli dhe rëndësia e stafit mjekësor në kohë pandemie", "Siguria dhe shëndeti në punë në kohë pandemie", "Ndikimi i pandemisë COVID-19 në ekonominë e Kosovës", "Rëndësia e kujdesit për shëndetin mendor gjatë ballafaqimit me pandeminë", "Siguria kibernetike dhe privatësia në kohë të pandemisë", "Efektet e pandemisë në politikën ndërkombëtare", "Bujqësia sot dhe pas pandemisë", "Të drejtat mbi pronësinë intelektuale", "Shkollimi, trajnimin dhe zhvillimi profesional online në kohë pandemie", "Qasja e qytetarëve në shërbimet publike në kohë pandemie", "Drejtesia Kushtetuese



në Kosovë- zhvillimi dhe pritshmëritë", "Ndikimi i mediave në sensibilizimin e pandemisë së coronavirusit në Kosovë", "Edukimi online në kohë pandemisë", "Aktiviteti fizik në kohën e coronavirusit COVID-19", "Roli i të ushqyerit shëndetshëm aplikimi i masave të mira higjienike në parandalimin e pandemisë", "Bujqësia sot dhe pas pandemisë", "5G Artificial Intelligence and Internet of Things", "Roli i medias në sport", "Pandemia dhe Ballkani: Si u ballafaquan shqiptarët me COVID-19", "Shëndeti publik oral dhe COVID19", "Roli i infermierit gjatë pandemisë COVID-19 në vendin tonë", "Perspektiva e Ballkanit Perëndimor në





kontekst të sfidave në rritje në Bashkimin Evropian”, “Liria e shtypit dhe e shprehjes gjatë ushtrimit të profesionit të gazetarisë në Kosovë”.

Në këto konferenca folën dhe dhanë ekspertizat e tyre profesionale shumë ekspertë të fushave nga vendi, rajoni dhe Evropa.

Pandemia COVID-19 ka prekur thuajse gjitha shtetet e botës, andaj, video-konferencat shërbyen si arenë diskutimi rreth masave që shtetet për rreth kanë ndërmarrë dhe ndikimin e masave në numrin e të infektuarve, ndikimin e kësaj pandemie në ekonomi, shëndet, si dhe menaxhimi i saj nga vendi dhe shtetet në përgjithësi.



Në Kampusin Inovativ të UBT-së, në Lipjan

Jetësohet projekti për ndërtimin e Qendrës më të madhe të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë "UBT Smart City"

Me një hapësirë rreth 28 mijë metra katrorë, në Kampusin Inovativ të UBT-së, në Lipjan, po jetësohet Qendra e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e ashtuquajtur "UBT Smart City", e cila do të jetë qendra e parë e këtij lloji në Kosovë, që do të mundësojë rritjen e vendeve të punës, ndërmarrësisë, inovacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë. Qendra e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit do të jetë e vendosur në Parkun Shkencor dhe Teknologjik të UBT-së, në të cilin do të bëhet zhvillimi i shkencës, do të kryhen eksperimente dhe do të zhvillohen produkte inovative, ku me ndërtimin e këtij objekti, i gjashti brenda Kampusit Inovativ të UBT-së, arrihet plotësimi i ekosistemit inovativ, dhe duke ia shtuar teknologjitë smart kjo hapësirë i plotëson



kushtet për një Smart City dhe si e tillë kjo është qendra më unike në Ballkanin Perëndimor.

Me një arkitekturë të veçantë të bazuar në standarde të larta dhe me zbatimin e teknologji

sisë të së ardhmes, kjo qendër përveç tjerash do të ketë edhe vende për punë praktike, labo-

ratorët, konviktin, bibliotekën, kuzhinën, inkubator, industri të vogla, hapësira për biznese të reja, qendrat kreative, hapësira sportive dhe të gjitha elemente të tjera të nevojshme për të plotësuar një ekosistem inovativ. Përkundër vështirësive dhe ndikimit të COVID-19, UBT vazhdon t'i qëndrojë besnik strategjive dhe vizionit të saj. I tërë ky investim është bërë dhe po bëhet me qëllim që të kontribuojmë në edukim cilësorë, rritjen e punësimit, zhvillimin e ndërmarrësive të reja inovative dhe bizneseve, si dhe ngritjen e kapaciteteve humane konform kërkesave të tregut të punës, kompetencave të së ardhmes, politikave publike dhe në përgjithësi zhvillimit të qëndrueshëm të Kosovës.

Sipas raportit nga zyrtarët e "The International Certification Network" dhe "Quality Austria"

UBT ricertifikohet për cilësi sipas standardit ndërkombëtar ISO 9001

UBT është institucioni i parë dhe i vetëm që i plotëson standardet ndërkombëtare për menaxhimin e cilësisë i certifikuar nga ISO 9001: 2015, certifikim ky që specifikon termat dhe përkufizimet që zbatohen për të gjitha standardet e menaxhimit të cilësisë dhe sistemit të menaxhimit të cilësisë, të zhvilluara nga ISO/TC 176, e që institucionet apo organizatat e përdorin standardin për të dëshmuar se plotësojnë kushtet dhe kriteret e kërkuara lidhur me menaxhimin e cilësisë. Gjatë kësaj kohë, UBT i ka përbushur të gjitha kriteret e standardit ISO 9001: 2015, pas një auditimi të suksesshëm dhe raportit pozitiv të lëshuar nga zyrtarët e "The International Certifica-

tion Network" dhe "Quality Austria".

UBT ka të themeluar Zyrën për Sigurimin e Cilësisë dhe Performancës, zyrë kjo që përcakton funksionet e të gjithë stafit në procesin e sigurimit të cilësisë dhe performancës, si dhe harton një plan vjetor të zhvillimit, i cili parashikon indikatorët dhe kriteret për sigurimin e cilësisë.

Ekspertët ndërkombëtarë kanë vlerësuar lartë UBT-në për nivelin e menaxhimit të cilësisë, kështu duke e cilësuar UBT-në, si institucion me kulturë të fortë, me përkushtim të lartë ndaj nevojave të studentëve me një qasje etike për mënyrën në të cilën funksionon institucioni.

UBT është lider në implementimin e standardeve ndër-



kombëtare dhe evropiane për cilësi, dëshmuar dhe vlerësu-

ar nga The European Foundation for Quality Management

(EFQM) me Çmimin e Ekselencës me Pesë Yje.

UBT dhe UP institucionet e para për citime në Google Scholar

UBT është renditur institucioni i parë jopublik, në nivel kombëtar, në bazë të citimeve në raportin e fundit të muajit korrik 2020, të titulluar: "TRANSPARENT RANKING: Top Universities by Citations in Top Google Scholar profiles".

UBT ka hyrë në renditjen e ngushtë globale prej rreth 4 mijë universiteteve prestigjioze të përzgjedhura nga 30 mijë universitete, si një ndër top universitetet më të mira anembanë botës në bazë të botimeve të studiuesve dhe profesorëve, citimit të tyre në Google Scholar, teksa prej këtyre institucioneve vetëm gjashtë universitete nga trojet shqiptare kanë arritur të rangohen në këtë listë të ngushtë.

Me këtë rast, rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi poten-

coi se numri i madh i stafit akademik dhe hulumtues, përvoja, angazhimi dhe rezultatet e tyre hulumtuese, si dhe partneriteti me institucione prestigjioze ndërkombëtare në fushën e hulumtimit dhe edukimit, kanë bërë që UBT të jetë pjesë e storjeve të suksesit në nivel global.

"Ky rezultat është edhe një indikator shtesë në kuadër të indikatorëve të tjerë të suksesit të UBT-së që mundëson ngritjen dhe ruajtjen e pozitave të larta ranguese në nivel ndërkombëtar", tha rektori Hajrizi.

UBT tanimë me dhjetëra herë ka ngritur emrin e shtetit tonë në nivelet më të larta botërore në fushën e edukimit, shkencës dhe inovacionit dhe vazhdon të jetë një model për të tjerët në rajon dhe në Ballkan.

UBT, institucioni lider që është shndërruar në Ekosistem të Dijes

UBT si institucion inovativ i arsimit të lartë tashmë është pjesë integrale e shoqërisë, që aktivisht merr pjesë në përbushjen e misionit për përfshirjen në zhvillimin socio-ekonomik të vendit, ku ka krijuar bashkëpunim midis qeverisë, industrisë dhe universitetit në mënyrë që të krijohet inovacion që nxit edhe rritjen ekonomike.

Tash e gati 20 vjet, UBT ka kontribuar gjithnjë në zgjidhjen e sfidave të mëdha të shoqërisë kosovare, duke përfshirë disiplina të ndryshme, përmes hulumtimit, edukimit dhe transferimit të teknologjisë.

Këto vlera bëjnë që UBT të shndërron në 'Ekosistem të Dijes', si dhe të ketë një pozicion të veçantë në shoqëri. Institucioni suksesshëm ka krijuar hapësirë organizative dhe fizike, madje është çelës për shkëmbimin e njohurive me institucionet e evropiane dhe botërore, me të cilët bashkërisht edhe punojnë në projekte madhore, shkëmbimin e stafit



dhe studentëve, e studentët ndërkombëtarë dhe ata të UBT-së bashkëpunojnë ngushtë mes vete. Në Ekosistemin e Dijes, UBT njëkohësisht kryen kërkime themelore në fusha mjaft të gjera dhe me efektivitetin e duhur, por është edhe stimuluesi kryesor për krijimin e produkteve dhe sjelljen e teknologjive të reja, siç ka sjellë në rajon Realitetin Virtual dhe të Shtuar, ofron fuqi punëtore të kualifikuar falë pro-

grameve dhe specializimeve unike. Ky institucion është burim i rëndësishëm i ideve të reja në shkencë dhe teknologji që kontribuojnë në inovacionin në Kosovë, rajon dhe më gjerë, teksa UBT përgatit të diplomuar me kompetenca të larta, krijues të motivuar, të cilët ato ide i shndërrojnë në biznese, organizata joqeveritare, si dhe i jetësojnë falë ndihmës institucionale dhe shtetërore.

Me riakreditimin e programeve të studimit

UBT mbetet institucioni me më së shumti programe studimi të akredituara në Kosovë



UBT, edhe njëherë ka dëshmuar se është numër një në vend për arsimin e lartë, sa i përket numrit të programeve të akredituara dhe specializimeve. Duke dëshmuar çdo herë vetën lidere sa i përket cilësisë në arsimin e lartë në të gjitha fushat e studimit, UBT mbetet zgjedhja e parë për të vazhduar studimet akademike për secilin studentë. Tashmë, UBT është institucioni i vetëm në rajon që po përdor

metodën më të avancuar të realitetit virtual në CLASSROOM 3.0 Bordi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC), në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) ka vendosur që programeve ekzistuese, të cilave u skadon akreditimi gjatë këtij viti dhe nuk kanë qenë pjesë e procesit të vlerësimit nga ekspertët ndërkombëtarë, t'ju vazhdohet akreditimi edhe për një vit.

Këto janë programet e akredituara të studimit në UBT, në të cilat zyrtarisht mund të aplikojnë të gjithë të interesuarit: Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri Menaxhim i Mekatronikës Sistemet e Informacionit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, Inxhinieri e Ndërtimit (Ndërtimtari) dhe Infrastruktura

Shkenca Politike Media dhe Komunikim Juridik Inxhinieri e Energjisë Dizajn i Integruar Shkenca të Ushqimit dhe Bioteknologji Muzika Moderne, Prodhimi Digjital dhe Menaxhimi Agrikultura dhe Inxhinieria e Mjedisit Art dhe Media Digjitale Teknik i Anestezilogjisë Teknik i Radiologjisë Infermieri

Farmaci
Stomatologji

Programet e studimit në UBT, në nivelin Master:
Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi
Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri
Inxhinieri Ndërtimore (Ndërtimtari) dhe Infrastruktura
Menaxhim i Mekatronikës Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor
Media dhe Komunikim
Politika Publike dhe Menaxhim,
Shkenca të Ushqimit dhe Teknologjisë
E Drejta Civile dhe Pronës Juridik, Kriminologji Kompjuterike dhe Forenzikë
Energji Elektrike dhe Tregjet e Energjisë
Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment
E Drejta Biznesore Ndërkombëtare dhe Evropiane
Farmaci
Stomatologji
UBT për herë të parë në Kosovë ka zhvilluar praktikën më të mirë të mësimi bashkëkohor, që janë dëshmuar të suksesshme në universitetet më të mira botërore. Rritja e numrit të studentëve dhe zgjerimi i institucionit nëpër qendrat më të mëdha të Kosovës, dëshmon që UBT, jo vetëm që është e përkushtuar në shkencë dhe inovacion, por vazhdon ta mbajë primatin si institucioni më serioz dhe më i përkushtuar për nga pikëpamja e sjelljes së kuadrove profesionale për tregun e punës.

UBT mbajti virtualisht ceremoninë e gradimit të studentëve

Të emocionuar dhe krenarë që kurorëzuan suksesshëm arritjet gjatë studimeve, këtë vit rreth 1 mijë e 500 absolventë të UBT-së përjetuan një ditë tejet të veçantë, patën një përvojë unike dhe të përsëritshme, pasi që virtualisht mbyllën ciklin e studimeve në profesionet e tyre. Këtë herë lumturinë në këtë ceremoni ata e shprehën online, në ceremoninë e gradimit, që UBT e organizoi për ta në shenjë falënderimi. Suksesi i ditës së sotme, sipas rektorit të UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, është rezultat i punës disavjeçare. Sipas tij, institucioni është përkushtuar që studentët të përgatiten dhe të bëhen profesionistë, e mbi gjitha të jenë imazhi dhe krenaria më e madhe e këtij vendi. "Do të doja që të shpreh respektin tim dhe të shpreh besimin tek ju, sepse që nga sot ju jeni ambasadorë të UBT-së. Si institucion i klasit të lartë të arsimit në Kosovë që është UBT, u kemi ofruar dhe vazhdojmë të ofrojmë mbështetje të lartë për projekte kërkimi



more dhe hulumtime të gjithë studentëve. Sfidat e këtij viti nga pandemia nuk na kanë dhënë shenja që ne të ndalim mësimin, pasi që për ne si institucion është e rëndësishme të vazhdohet ëndrra juaj që keni filluar në rrugën akademike, andaj edhe mësimin e kemi kaluar në formë digjitale.", është shprehur në fjalën përshëndetëse të tij, Presidenti i UBT-së, prof. dr.

Edmond Hajrizi. Rektori Hajrizi, në fjalën e tij drejtuar studentëve, nga Kampusi Inovativ i UBT-së, në Lipjan, ka thënë se Kosova ka nevojë për njerëz kompetentë që kërkohen nga institucionet dhe kompanitë, e ne si UBT kemi ndërtuar personalitete të tilla, sepse ndërtimin e gjeneratave të fuqishme intelektualisht ia kemi borxh vendit dhe mijëra prindërve

që ia besuan UBT-së shkollimin e fëmijëve të tyre. Ish-studentët e UBT-së, Gëzim Selimi, Labinot Vuniqi, si dhe absolventja Erblina Ademi, kanë treguar për eksperiencat e tyre dhe sukseset që ata arritën gjatë dhe pas studimeve në UBT. Ata falënderuan rektorin prof. dr. Edmond Hajrizi, profesorët dhe të gjithë stafin e UBT-së, për përkushtimin, bashkëpunimin dhe

profesionalizmin e treguar. Duke vlerësuar situatën me pandeminë Covid-19, studentët nuk ishin të pranishëm fizikisht, por virtualisht ata dhanë premtimin që do t'i shërbejnë shkencës, do të kontribuojnë me përgjegjësi në zgjidhjen e problemeve të shoqërisë dhe zhvillimit të ardhshëm prosperues.

Nga presidenti i gjigantit teknologjik "EON REALITY", Dan Lejerskar

UBT vlerësohet si institucioni që po bën revolucion në edukimin virtual në botë

Kompania më e madhe botërore për teknologji virtuale, "EON Reality", vlerëson lartë faktin se si një institucion nga Kosova, i vetmi në botë, përgjatë kohës së pandemisë ka bërë revolucion në sistemin e edukimit përmes platformave Virtual Reality, si dhe krijimin e 54 mijë mësimëve.

Dan Lejerskar përmes LinkedIn, ka vlerësuar lartë punën që UBT është duke e bërë në ndryshimin e cilësisë së arsimit në vend dhe botë.

"Një nga shkollat më të mëdha në shtetin më të ri në Evropë, është duke ndryshuar mënyrën se si instruktorët dhe studentët e shohin edukimin në XR gjatë pandemisë", ka shkruar në LinkedIn presidenti i gjigantit teknologjik "EON REALITY", Dan Lejerskar.

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ka thënë se ka pasur një përmirësim të duk-



shëm në rritjen e numrit të përdoruesve që filluan të punojnë me platformën EON-XR.

"Zgjerimi i përdorimit tonë të platformës EON-XR përtej arrijës fillestare ka qenë një suk-

ses për anëtarët e universitetit dhe studentët gjatë kësaj kohe. Aftësia për të dhënë mësim në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe interaktive pa pasur nevojë të takohemi personalisht ka sig-

uruar rezultate që ndryshojnë jetën për sallat tona të leksioneve dhe laboratorët në gjithë këtë kohë pandemie. Zgjerimi ka përfshirë me sukses të gjitha shkollat e universitetit dhe ne

do të vazhdojmë të gjenerojmë më shumë përmbajtje arsimore dhe njohuri përmes përfshirjes së një numri më të madh studentësh, stafi akademik dhe anëtarëve të komunitetit.", ka thënë rektori Hajrizi.

Rektori Hajrizi shtoi se brezi i ardhshëm do të jetë i gatshëm të përvetësojë këtë teknologji të re e cila do të përmirësojë cilësinë e mësimin në distancë.

"Duke parë se si po zhvillohet tregu XR si përdorimin akademik ashtu edhe për industrinë, nuk ka dyshim se ai do të luajë një rol të madh duke shkuar përpara në UBT. Ne kemi qenë shumë të kënaqur me progresin që kemi bërë me EON-XR deri më tani, dhe do të dëshironim të vazhdonim të kultivonim dhe rritim atë marrëdhënie sa më shumë që të ishte e mundur me kalimin e kohës", ka theksuar rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi.

UBT është institucioni i parë arsimor në botë që realizon tërë procesin edukativ në platformën e realitetit virtual

UBT ka qenë gjithmonë prijatar në sjelljen e teknologjive të reja në Kosovë në dhe Ballkan, por tanimë UBT është institucioni i parë në botë që tërë procesin arsimor e ka vendosur në platformën e realitetit virtual, duke nxitur kështu zhvillimin dhe duke mundësuar krijimin e gjeneratave të ardhshme të shkencëtarëve, zhvilluesve dhe sipërmarrësve.

UBT nga tani po hynë në një epokë të re, duke ofruar zbatimin e plotë të CLASSROOM 3.0 dhe duke u bërë Institucioni i parë në botë, edhe para të gjitha universiteteve dhe shkollave prestigjioze, që e arrin këtë.

UBT është nismëtare në sjelljen e inovacioneve të fundit teknologjike, ku së fundmi në partneritet me gjigandin teknologjik, EON Reality, bënë investimin më të madh direkt në Kosovë që nga paslufta, fillimisht vitin e kaluar hapën Qendrën për Realitet Virtual dhe

të Shtuar, tekta 30 milionë dollarë është shuma që po investojnë në jetësimin e tërësishtëm të këtij projekti tejet inovativ.

Përveç që është i pari institucion në botë që bëri të mundur sjelljen e realitetit virtual, UBT këtë platformë e implementoi suksesshëm në sistemin arsimor, madje studentët tanë tashmë kanë filluar të praktikojnë mësimet përmes kësaj teknologjie.

Realiteti virtual u ka krijuar mundësinë studentëve që falë grafikës 3D, imazhet nga kompjuteri të duken nga përdoruesi sikurse të ishin të vërteta, konkretisht simulohen objektet artificiale që shfaqen në ekran me përmbajtje virtuale.

Pra, teknologjia e VR-it u ka krijuar studentëve një botë bindëse dhe shumë atraktive për mësim, ndërkohë ata po e shohin këtë si një mundësi të artë për të eksploruar në fusha të ndryshme



studimi. UBT, si qendra më e madhe teknologjisë virtuale në Ballkan, këtë platformë dëshiron ta instalojë në sistemin arsimor

në Kosovë, me qëllim që gjithë studentët e gjitha institucioneve arsimore në vend, publike dhe private, të përjetojnë teknologjinë

e shekullit 21, njëherësh edhe të përfitojnë aftësitë e duhura në përgatitjen profesionale duke përdorur të tilla teknologji.

Ministrja Bajrami përgëzoi UBT-në dhe shkollat për zhvillimin e mësimin online



Ministrja e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë, Hykmete Bajrami, ka përgëzuar UBT-në dhe

gjitha shkollat që janë duke zhvilluar mësimin në distancë, duke thënë se kjo formë e mësimin do të vazhdojë deri sa të vlejë masa

për ndërprerjen e mësimin në shkolla.

Këto komente ajo i ka bërë në video-konferencën e organizuar nga UBT, me temë: "Rëndësia e edukimit online në kohë pandemie", transmetuar drejtpërdrejtë në UBT TV dhe Radio Campus. Ministrja Bajrami në këtë konferencë online tregoi se në arsimin parauniversitar tashmë janë përfshirë mbi 70 për qind e lëndëve, teksa tha se ministria që ajo drejton ka përgatitur edhe udhëzues se si duhet të implementohet në tërësi mësimi online.

Tutje, ajo tha se sfida e parë që vendi do të përballet në fushën e arsimit është vlerësimi i nxënësve sepse ka laramani të platformave që përdoren, si dhe, sipas saj, do jetë sfidë mbajtja e testit të semimaturës dhe maturës, po që tani për tani ende nuk ka ndonjë ven-

dim në këtë drejtim.

"Nga informacionet që ne si ministri i kemi marrë, jemi informuar që UBT është një nga institucionet e arsimit të lartë, një ndër të parët që në ditët e para pas shpalljes së pandemisë ka filluar aplikimin e arsimit online. Gjithashtu, statistikat tregojnë për ndjekjen e ligjëratave nga një numër i madh i studentëve të UBT-së në mësim në distancë, dhe ky fakt na gëzon e jemi mirënjohës për të gjithë ata që kanë vepruar njësoj në këtë drejtim", potencoi ministrja Bajrami.

"Për MASHTI-n ka qenë jashtëzakonisht sfiduese për dallim prej UBT-së, sepse në fakt ne kemi filluar çdo gjë nga zero. Si institucion UBT ka filluar më herët përdorimin e platformave online për mësim në distancë, të cilat lehtësisht i kemi adaptuar

pas shpalljes së pandemisë nga OBSH-ja. Por, në nivelin parauniversitar vërtetë ka qenë sfiduese. Këtij projekti u janë bashkëngjitur të gjitha palët e interes në mënyrë që të jetë i suksesshëm", theksoi ajo.

Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi ka theksuar që institucioni që ai drejton, falë teknologjisë së fjalës së fundit që posedon, ka implementuar suksesshëm konceptin ndërveprues për mësim online në mënyrë virtuale nga distanca.

Sipas rektorit Hajrizi ky plan strategjik është zhvilluar nga UBT me politika dhe udhëzime të përshtatshme për studentët e gjitha fakulteteve, teksa bëri të ditur që UBT ka vite që ka sjellë në Kosovë mësimin online, prandaj edhe lehtësisht e ka implementuar në praktikë.

UBT, institucioni i vetëm në botë që për dy muaj zhvilloi 20 mijë mësim me realitetin virtual

UBT ka hyrë në rangun e universitete prestigjioze dhe po shërben si institucion model në zhvillimin e inovacioneve teknologjike, së fundmi është vlerësuar si qendra më e madhe ndërkombëtare në mbarë globin për transferimin e njohurive bazuar në realitetin virtual.

Në një artikull kushtuar konkretisht nismës së UBT-së për zhvillimin e kësaj kurrikule, e që është publikuar nga gjigandi teknologjik "EON Reality", vlerësohet lartë fakti se si një institucion nga Kosova, i vetmi në botë, arriti që për vetëm dy muaj të krijojë 20 mijë mësim, në 141 kurse universitare, që përfshijnë mbi 20 programe të ndryshme akademike.

Për herë të parë në botë, ishin mijëra studentë të UBT-së që përfituan mësim bazuar në AVR (Augmented Virtual Reality), mësim që përfshijnë më shumë se 120 mijë gjëra të krijuara nga kjo platformë, duke filluar nga fusha e arkitekturës dhe inxhinierisë, deri tek matematika e përpëruar, dhe madje shumë tema që lidhen me artin, si fotografia konceptuale dhe dizajnimi i studios.

Në këtë artikull theksohet se përdoruesit në mbarë botën, përfshirë edhe anëtarët e rrjetit global të EON



Reality, kanë mundësinë të përfitojnë dhe të marrin rekomandime nga suksesi i një prej qendrave më të mira ndërkombëtare të realitetit virtual, në këtë rast të Qendrës për Realitet Virtual dhe të Shtuar në UBT. Në këtë artikull, themeluesi i realite-

tit EON, Dan Lejerskar, citohet të ketë potencuar se ky sukses i UBT-së përbën një ndikim të madh në akademi, dhe se kjo platformë do të zgjerohet e implementohet edhe nga institucione tjera.

"Shtimi i fundit i këtyre kurseve fan-

tastike dëshmon se Platforma AVR ka qenë një sukses i madh për studentët dhe arsimtarët në të gjithë botën. Jam shumë i ngazëllyer kur shoh se ku mund të shkojmë me këtë në të ardhmen, dhe besoj se dobia e Platformës AVR vetëm do të zgjero-

het pasi bota bëhet më e rehatshme me mësimin dhe punën nga një distancë. Ky është vetëm fillimi, dhe ai tashmë po bën një ndikim të madh në akademi", theksoi ai.

Ndërkaq, rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, tha se realiteti virtual ka qenë evolucion botëror të cilin fillimisht UBT e ka sjellë si projekt, e më pas suksesshëm e ka implementuar në mësim.

"Kemi arritur që përmes UBT-së, Kosova të luan një rol model dhe të ketë ndikim global në teknologjitë e së ardhmen në edukim. Jemi të lumtur që kemi realizuar një projekt të tillë me potencial që parashikohet të ketë rritje. Realitetin virtual kemi arritur ta integrojmë në të tashmen tonë, por edhe në vitet e ardhshme konsiderojmë që do të ketë ende më shumë përparime teknologjike në kuadër të VR-it", theksoi rektori Hajrizi.

UBT përveç që është prijatar në sjelljen e inovacioneve të fundit teknologjike, si institucion ka arritur që vitin e kaluar të lidh partneritet me gjigandin teknologjik, EON Reality, ku janë duke investuar së bashku miliona dollarë në jetësimin e plotë të këtij projekti tejet inovativ.

UBT ofron platformën për realitet virtual gjitha shkollave profesionale në Kosovë

UBT si lider i arsimit të lartë në Kosovë, tanimë do të ofrojë platformën e realitetit virtual për mësim online të gjithë nxënësve që ndjekin shkollat profesionale të profileve të ndryshme në Kosovë.

Kjo platformë është implementuar në kuadër të Qendrës për Realitet Virtual dhe të Shtuar në UBT, qendër kjo më madhe dhe vetmja në Ballkan, falë përmes të cilës, aktualisht në sistemin arsimor të Kosovës është instaluar sistemi arsimor i së ardhmes, i cili zbatohet në bashkëpunim me UBT-së dhe kompanisë më të madhe botërore për teknologji virtuale, EON Reality.

Kjo u bë e ditur në një konferencë online të organizuar nga UBT dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASH-TI), me ç'rast është prezantuar edhe platforma e realitetit virtual para drejtorëve komunalë të arsimit.



Prezantimin e platformës e bëri rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, i cili tha se bashkë me gjigandin teknologjik EON Reality, synojnë që ti ofrojnë vendit teknologjinë e fjalës së fundit,

në mënyrë që ta vendos Kosovën përkrahë shteteve më të zhvilluara të botës.

Sipas rektorit Hajrizi, UBT do ta ndajë këtë pjesë të teknologjisë me palët e interesit, në kuadër të ini-

ciativës globale për mbështetje në kohën e pandemisë, teksa shtoi se zhvillimi i mësimin online përmes platformës së realitetit virtual do të ishte më interaktive dhe do t'u sillte përfitime.

"Është një platformë që krijon shumë mundësi të mira për të gjithë nxënësit duke i përdorur komponentët e ndryshme për realizimin e mësimin në distancë ku janë të përfshira të gjitha elementet. Qasja virtuale gjithashtu krijon mundësi që të bartin laboratorin në shtëpi dhe të mbështesin qasjen për një edukim të personalizuar i fokusuar te interesimi personal. Ne do të ofrojmë edhe trajnime për të gjithë mësimdhënësit lidhur me përdorimin e platformës për realitet virtual", theksoi rektori Hajrizi.

Udhëheqësja e Divizionit për Arsim dhe Aftësim Profesional në MASH-TI, Valbona Fetiu-Mjeku tha se zbatimi

i kësaj platforme do të ishte në të mirë të nxënësve dhe mësimdhënësve, pasi që, siç tha ajo, nxënësit për shkak të pandemisë nuk po mund të ndjekin pjesën praktike. Sipas saj mësimdhënësit nuk do të kenë vështirësi në zbatimin e kësaj platforme tejet inovative.

"Platforma e prezantuar dhe e ofruar nga UBT do të na mundësojë që një botë reale të shohim edhe nga shtëpitë sidomos për nxënësit dhe mësimdhënësit të cilët do të kycen në këtë platformë dhe kjo do të sillte një përfitim shumë të madh", tha Mjeku.

UBT është institucioni i parë arsimor në rajon që ka nisur mësimin online me këtë iniciativë të re, konkretisht duke integruar në mësimin në distancë edhe realitetin virtual dhe të shtuar.

UBT, institucioni i parë në Kosovë që fillon të mbajë provimet online



UBT është institucioni arsimor në vend, ku përveç që është përkushtuar që të ofrojë mësim cilësor, gjithashtu në mësim ka inkuadruar teknologjinë e fjalës së fundit në mënyrë që të ndihmojë studentëve në zhvillimin e tyre profesional.

Tashmë, UBT ka zhvilluar platformën tejet inovative për vlerësimin e studentëve në distancë, duke u bërë kështu institucioni i parë arsimor në Kosovë që zbaton një platformë të tillë.

Sot mijëra studentë të të gjitha fakulteteve të UBT-së, patën rastin të vlerësohen online në afatin plotësues, falë platformës që institucioni e ka zhvilluar enkas për provime. Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond

Hajrizi duke iu dëshiruar suksese të gjithë studentëve në provime tha se UBT ka zhvilluar një platforme dhe një proces të bazuar në praktikën e teknologjisë së fundit për të vlerësuar studentët në distancë.

"Zbatimi i teknologjia të avancuar që gjendet në UBT, zhvillimi i platformave shumë inovative, bëhet me qëllim që studenti të ndahet i kënaqur nga ne, sepse më shumë se gjithçka e duam që suksesin e studentëve tanë. Andaj UBT në kohë pandemie ka marrë masa konkrete që studentët të mos humbin asgjë nga procesi i realizimit të planeve akademike, duke mundësuar që studentët të arrijnë sukseset e veta me kohë", tha rektori Hajrizi.

UBT ftohet nga MASH-TI të japë ekspertizat profesionale lidhur me implementimin e mësimin online

Tash e gati 18 vjet, UBT ka sjellë në Kosovë inovacionet e fundit botërore dhe një primat të tillë po e mban fuqishëm përmes projekteve të shumta inovative, siç është hapja e qendrës më të madhe në Ballkan për realitet virtual, investim 30 milion dollarë ku UBT po e implementon në bashkëpunim me kompaninë gjigande të teknologjisë, EON Reality.

Duke qenë se UBT ka ndryshuar edhe qasjen e vendit ndaj arritjeve të reja teknologjike, rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, është ftuar të marrë pjesë në takim me ministren e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASH-TI), Hykmete Bajrami, për të ndarë përvojën e institucionit që ai drejton në arsimin e bazuar në internet.

Konkretisht, rektori Hajrizi ka ndarë ekspertizat e tij profesio-



nale lidhur me mësimin online në mënyrë virtuale, ku edhe ka shprehur gatishmërinë për të mbështetur ministrinë në hartimin e platformës për mësim online për gjithë nxënësit në vend.

Në këtë takim, rektori Hajrizi potencoi që do të ndihmojë institucionet përkatëse në tejkalimin e situatës së krijuar shkaku i pandemisë

COVID-19, ndërkaq tha se do të japë kontribut profesional dhe akademik për menaxhimin e situatës, sidomos në sistemin arsimor.

UBT vite më parë ka sjellë në Kosovë modelin e arsimit të bazuar në internet, ku po e implementon në institucion me praktikën më të mira inovative të marra nga universitetet botërore.

UBT fitues i aplikimit të platformës së realitetit virtual

Presidenti i gjigandit teknologjik "EON Reality", Dan Lejerskar, ka përgëzuar UBT-në për arritjen suksesi për zhvillimin dhe fuqizimin e aplikimit të platformës së realitetit virtual. Ai në një postim të tij në LinkedIn, ka vlerësuar

se UBT për dy javë ka krijuar mbi 7437 përdorues aktiv duke shtuar bashkërisht 54.425 asete.

"Përgëzojmë Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT) si fitues të çmimit: "AVR Platform Power User Prize", për arritjen e

kësaj jave të 7437 përdoruesve aktivë që kanë krijuar bashkërisht 54.425 asete të shtuara të realitetit virtual. Wow!", thuhet në postimin e presidentit të EON Reality, Dan Lejerskar.

Ekipi i UBT-së shpallet fitues në Kampionatin Ballkanik të MOS-it, vazhdon garën në nivel botëror

Ekipi i UBT-së, i përbërë nga studentet Elita Hajrizi dhe Vlera Saraqi, si dhe nga Artin Ahmeti, është shpallur fitues nga Certiadria në Kampionatin Ballkanik të Microsoft Office Specialist 2020.

Ata, përmes UBT-së, do të përfaqësojnë Kosovën në Kampionatin Botëror të Microsoft Office Specialist, që është planifikuar të zhvillohet në New York, ShBA, më 29 korrik deri më 1 gusht 2021.

Në këtë garë botërore, kampionët e Kosovës do të demonstrojnë aftësitë e tyre në Microsoft Office, përfshirë Word, Excel dhe PowerPoint, në Adobe, përfshirë Photoshop, Illustrator dhe InDesign.

Me këtë rast, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi ka përgëzuar studentët për suksesin e arritur, teksa theksoi se institucioni që ai drejton do të mbështesë të rinjtë për pjesëmarrje aktive në gara të tilla.

"UBT e përfaqëson vazhdimisht Republikën e Kosovës në shumë



mekanizma ndërkombëtarë, duke depërtuar edhe atje ku politika nuk ka mundur të depërtojë, kjo përmes shkencës, teknologjisë e inova-

cionit. Nuk është hera e parë që studentët tanë janë pjesë e fitoreve të mëdha në fusha të ndryshme, duke bërë kështu që studentët tanë të

jenë të barabartë me ata ndërkombëtarë", potencoi Hajrizi. Fituesit e Kampionatit Ballkanik i ka uruar edhe drejtori i Cer-

tiadria, Marko Serafimovski, i cili ka thënë se gara në fjalë u mundëson pjesëmarrësve përvojë të paharruar dhe aftësim profesional.

"Ne jemi veçanërisht krenarë për numrin në rritje të të rinjve që punojnë për të përmirësuar njohuritë e tyre digjitale dhe të kuptojnë se njohuritë digjitale janë të kërkuara dhe mund të sjellin vetëm përfitime. Përveç kësaj, kriza shëndetësore globale vetëm ka theksuar nevojën për të përmirësuar shkrim-leximin digjital, i cili ka qenë qëllimi ynë kryesor që nga fillimi i operacioneve tona. Ne duam t'i përgëzojmë fituesit dhe t'u urojmë atyre fat në Kampionatin Botëror në 2021", citohet të ketë thënë drejtori Serafimovski.

UBT çdo vit merr pjesë në garën e Microsoft Office Specialist "MOS", ku fillimisht shpall fituesit në nivel vendi, e më pas i mbështet ata dhe i përgatit për garën në arenën ndërkombëtare.

UBT e përfaqëson Kosovën në konkursin ndërkombëtar INSPIRELLI AWARDS

Në mesin e 106 shteteve me 1305 projekte dhe 1331 pjesëmarrës, për herë të parë edhe Kosova, falë UBT-së, po përfaqësohet në konkursin ndërkombëtar "INSPIRELLI AWARDS", e cila organizohet në Pragë.

Studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor me 16 punime janë pjesë e kësaj gare. Studentët tanë do të prezantojnë punime të ndryshme inovative si: Community Library, A love affair between solid and motion, Memorial Historical Complex - "Adem Jashari", Africultural Campus, MomaKS, Second home - Dormitory, Cooperation Tunel, AGAVE, SPACE PAVILION - Exploring Shaping, Experiencing etj.

Ekspozita e punimeve të zgjedhura do të ofrohen online dhe në galeritë e partnerëve të përzgjedhur për popullatën dhe komunën e Ouagadougou, kryeqyteti i Burkina Faso dhe qendra administrative, komunikuese, kulturore dhe ekonomike e kombit, për të eksploruar, për të mësuar, për t'u frymëzuar dhe për të përjetuar rehabilitimin e qëndrueshëm futuristik si një mjet elastik konstruktiv i qytetit.

INSPIRELLI AWARDS është konkursi më i madh botëror i studentëve në Arkitekturë, Dizajnit Urban të Peizazhit, dhe Dizajnit të Enterierit, i cili mundëson prezantimin dhe shfaqjen e talentit të arkitektëve të së ardhmes nga mbarë globi.



UBT zgjeron rrjetin e partneriteteve në Pragë, lidh bashkëpunim me Universitetin "Ambis"



UBT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin "Ambis", në Pragë, i cili ka për qëllim bashkëpunimin në të gjitha fushat akademike, të projekteve dhe hulumtimeve me interes të përbashkët për të dy institucionet.

Bashkëpunimi, po ashtu përqendrohet në fushën e botimit, shkëmbimit të botimeve, librave shkencorë, organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, etj.

Falë kësaj marrëveshjeje institucionet mund të bëjnë shkëmbim semestral dhe të studentëve, të organizojnë vizita studimore në shtetet përkatëse, të zhvillojnë konferenca shkencore, apo edhe mund të hartojnë projekte të përbashkëta kërkimore në fushat me interes. UBT tashmë ka rreth 500 bashkëpunime të tilla me universitete dhe institucione të shquara në botë.

UBT zgjeron partneritetin në Letoni, nënshkruan marrëveshje me Universitetin "Riga"

UBT dhe Universiteti teknik "Riga", nga Letonia, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, ku dy institucionet theksojnë qëllimin e tyre për të inkurajuar më tej shkëmbimin e studentëve dhe stafit përmes programit Erasmus+, organizimin e aktiviteteve të përbashkëta kërkimore, punëtori shkencore dhe konferenca me karakter ndërkombëtar. Institucionet ranë dakord për shkëmbim të vazhdueshëm të njohurive, përvojave dhe rezultateve të hulumtimeve shkencore, si dhe të mbështesin zhvillimin e mëtejshëm të institucioneve përkatëse.

Marrëveshja ndëruniversitare është nënshkruar për të bash-



këpunuar në fushën e Teknologjisë, Informacionit dhe Komunikimit, Inxhinierisë, Administrimit të Biznesit, dhe fusha tjera me interes. UBT ka rreth 500 partnerë ndërkombëtarë nga pothuajse të gjitha

vendet e botës, me të cilët, që nga themelimi e deri më sot, ka realizuar një varg aktiviteteve të përbashkëta, prej të cilave më së shumti kanë përfituar stafi dhe studentët e UBT-së.

UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me University of Algarve, nga Portugalia



Me qëllim të zgjerimit të bashkëpunimit ndërkombëtar me universitete dhe institucione nga mbarë bota, rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, së fundmi ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me rektorin e University of Algarve, nga Portuga-

lia, Paulo Aguas. Kjo marrëveshje përkatësisht ka të bëjë në lidhje me shkëmbimin e studentëve, stafit akademik, bashkëpunim në aspektin shkencor dhe teknik në fushat përkatëse, vizita studimore të përbashkëta, etj.

Tutje, marrëveshja e bashkëpunimit ndërinstitucional parasheh edhe pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit në konferenca, seminare ose takime me karakter studimor nga dyja palët. University of Algarve, nga Portugalia, është themeluar në vitin 1979, dhe numëron një numër të konsiderueshëm të programeve të studimit në fusha të ndryshme. Ky universiteti u ofron studentëve mundësi për të eksploruar në karrierë, njëherësh u mundëson atyre përfitimin e aftësive të nevojshme për drejtimet përkatëse.

UBT zgjeron bashkëpunimin me Universitetin Sapienza, nënshkruhet marrëveshje në fushën e ndërtimitarisë

Listës së marrëveshjeve me institucione ndërkombëtare, i është shtuar edhe marrëveshja e bashkëpunimit me Universitetin Sapienza nga Roma, që është nënshkruar nga drejtori për Çështje Akadematike në UBT, prof. dr. Muhamet Ahmeti, përkatësisht Antonio D'Andrea, dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Civile dhe Industriale. Ky bashkëpunim do të shtrihet në fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukt-

turës, teksa udhëheqësit e institucioneve janë pajtuar për bashkëpunim ndërinstitucional, me qëllim për të shkëmbimit të studentëve dhe stafit. Universiteti Sapienza nga Roma, është një universitet kërkimor me seli në Romë të Italisë, si dhe është një nga universitetet më të mëdha evropiane për nga numri i studentëve dhe një nga më të vjetrit në histori, i themeluar në vitin 1303.



UBT prin si punëdhënësi më i madh në arsimin e lartë privat, sipas raportit të MASHT-it dhe ASK-së

Tabela 63. Numri i stafit akademik dhe administrativ sipas gjinisë 2018/2019

Kolegji	Te regullt		Te angazhuar		Staf ijetër (administrativ)		Femra	Meshkuj	Gjithsej
	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj			
AAB	-	-	-	-	-	-	-	-	-
AUK	7	9	7	3	40	37	54	49	103
Fama	31	77	8	36	13	1	52	113	165
Dukagjini	8	21	0	5	4	-	12	26	38
IBCM	5	7	2	2	10	8	17	17	34
ISPE	1	10	0	12	7	2	8	24	32
Juridika	3	18	1	12	5	2	9	32	41
QEAP Heimerer	38	46	23	28	4	-	65	75	140
Rezonanca	98	216	55	97	-	-	153	313	466
Rimvest	10	23	5	16	8	2	23	43	66
Tempulli	4	15	4	26	13	45	21	86	107
Arbëri	1	4	3	5	3	4	7	13	20
UBT	225	560	24	44	33	22	282	626	908
Akademia Evolucion	16	27	2	7	8	6	26	40	66
Dardania	25	58	16	42	8	4	49	104	153
Biznesi	-	-	-	-	-	-	-	-	-


UBT vazhdon të jetë lider në arsimin e lartë jopublik dhe të ketë rol aktiv në shërbim të shoqërisë, si dhe i vetmi institucion arsimor që përkrahë vazhdimisht zvogëlimin e papunësisë në vend. Konkretisht, raporti i publikuar së fundmi nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), sërish nxjerr UBT-në si institucioni numër një për nga numri i stafit të punësuar. Nga 750 sa kanë qenë të punësuar në vitin 2018, UBT vitin e kaluar ka rritur numrin në rreth

1 mijë të punësuar, përfshirë staf akademik dhe administrativ. Në bazë të raportit të MASHT-it dhe ASK-së, stafi i rregullt profesional në UBT, përbëhet nga 560 meshkuj dhe 225 femra, ndërkaq të angazhuar janë 24 meshkuj dhe 44 femra. Teksa, sipas këtij raporti, stafi administrativ në UBT, përbëhet nga 33 femra dhe 22 meshkuj. Nga numri i përgjithshëm i stafit akademik të angazhuar, prej tyre 62 profesorë janë nga rajoni dhe profesorë ndërkombëtarë. Po ashtu, në Kolegjin "Dukagjini" dhe Kolegjin "Arbëri", insti-

tucione që janë nën ombrellën e UBT-së, janë të punësuar 58 staf akademik e administrativ. Paralel me numrin e studentëve, edhe numri i stafit që punësohet në UBT vazhdon të rritet nga viti në vit, ku stafi i angazhuar ka grada të larta shkollimi dhe janë të përgatitur për të ndarë përvojat dhe ekspertizat e tyre profesionale me studentët. Vlen të theksohet se numri i stafit që angazhohet në UBT, vazhdon të rritet nga viti në vit, sikurse edhe numri i studentëve që regjistrohen çdo vit të ri akademik.

UBT përkrah stafin akademik për arritje profesionale

Besnik Qehaja është njëri ndër akademikët e UBT-së, njëherësh student i parë kosovar që ka doktoruar në Universitetin shtetëror "Corvinus University" në Budapest, ku ka fituar gradën doktor i Sistemeve të Informacionit dhe Informatikë. Tema e tij kërkimore ishte e fokusuar në telemjekësi, ku si rezultat i punës Qehaja ka arritur deri tek krijimi i një sistemi të informacioni për monitorimin e pacientëve në kohë reale. Duke folur për rrugëtimin e tij gjatë studimeve të doktoratës, Qehaja bëri të ditur se gjendja e shkaktuar nga pandemia Covid-19 tashmë ka konfirmuar nevojën dhe rëndësinë e një sistemi të tillë inteligjentë, të ci-



lin ai e ka dizajnuar në përpikëri duke u bazuar në gjetjet/kërkesat nga intervistat me doktorët,

infermierët, pacientët, ekspertët e shkencave kompjuterike. "Një falënderim i veçantë i de-

dikohet UBT-së, veçanërisht Rektorit Edmond Hajziri që në vazhdimësi ka mbështetur

avancimin tim akademik, si në nivelin master ashtu edhe në këtë të doktoratës", potencoi ai. Para 19 vitesh, kur edhe u themelua UBT, Kosovës dhe institucioneve arsimore i mungonin në masë të madhe doktorantët që kishin përfunduar studimet jashtë vendit, por falë marrëveshjeve të shumta të UBT-së me institucione arsimore ndërkombëtare, ky numër është shumëfishuar, teksa secili prej tyre që ka kryer doktoratën falë UBT-së, është rikthyer në Kosovë për të ndarë përvojën e fituar dhe për të ngritur nivelin e arsimit në vendin tonë.

UBT u ndan rreth 300 bursa studentëve të dalluar

Për nder të 12-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, UBT ka shpërblyer me bursa studimi rreth 300 studentë të dalluar të të gjitha fakulteteve, të cilët kanë arritur notën mesatare mbi 9.0. Bursat janë ndarë nga rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajziri, siç tha, për të motivuar dhe përkrahur studentët përgjatë gjithë viteve të studimit. "Ne mburremi që studentët tanë kanë sukses në studime. Pra, nuk është pak sepse gjithë këta studentë kanë arritur notë të lartë mesatare. Këta të rinj janë talentët dhe inovatorët e së ardhmes, prandaj gjejnë punë dhe janë më të kërkuarit në tregun e punës. Arritjet e këtyre studentëve na bëjnë shumë krenarë dhe gjithsesi janë motivi jonë si institucion i arsimit të lartë", potencoi rektori Hajziri.

UBT çdo vit ndihmon dhe lehtëson shkollimin e qindra të rinjve nga vendi dhe rajoni, ku ndan bursa në vlerë të 1 milion e 500 mijë eurove, bursa që ndahen me rregullohen e institucionit në kategori të parapara. Pas ndarjes së bursave, rektori Hajziri ka nderuar me çmimin "Excellence Leadership Award" pronarin e shtëpisë të shëndëruar në shkollë në kohën e okupimit, Mehmet Aliu-Hertica. Ky çmim iu dha për të vlerësuar kontributin e familjes së pronarit të kësaj shtëpie, në të cilën patën diplomuar gjenerata të gjimnazit "Sami Frashëri". Familja Hertica shtëpinë e vet e shëndërroi në tempull të rezistencës, duke shënuar një moment historik të mbrojtjes së arsimit shqip.

UBT e nderon me "Excellence Leadership Award" rektorin Ali Jashari



Me qëllim të vlerësimit të atribueteve dhe ndihmës së dhënë Kosovës në aspektin akademik dhe jo vetëm, njëherësh respektimit të veprave të tij si profesor dhe si rektor, UBT ka vendosur

ta nderojë rektorin e Universitetit "Fan S. Noli", nga Korça, Ali Jashari, me çmimin "Excellence Leadership Award". Çmimi është ndarë nga rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Ha-

jrzi, me rastin e 12-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, ku UBT përgjatë një jave do të organizojë aktivitete të ndryshme për nder të kësaj feste. Ky çmim, sipas rektorit Hajziri, u jepet personaliteteve të shquara vendore e ndërkombëtare për kontributin e tyre në sfera të ndryshme të jetës, sikurse edhe profesori, Ali Jashari. Profesori Jashari theksoi se ndjehet i nderuar me këtë çmim, ndonëse sipas tij, respekti i shprehur ndaj tij do të jetë një shtysë që ta mbajë edhe më të fuqishëm bashkëpunimin me UBT-në dhe Kosovën. Prof.dr Ali Jashari ka zhvilluar aktivitet të shumta në Kosovë, përfshirë edhe në aspektin shkencor, njëherësh ka kontribuar dhe ndihmuar vendin aty ku gjithnjë ka pasur nevojë.

Shpaloset monumenti i Joseph R. "Beau" Biden III, para objektit të UBT-së në Gjilan

Para objektit të UBT-së, në Gjilan, sot është shpalosur monumenti i djalit të ndjerë të presidentit të SHBA-ve, Joseph R. "Beau" Biden III, iniciativë kjo e ndërmarrë nga Komuna e Gjilanit.

Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri e ka vlerësuar lartë veprën dhe figurën e tij, teksa e ka falënderuar atë për kontributin e tij si ushtar dhe në ndërtimin e një sistemi ligjor.

"Sot e replikojmë edhe monumentin e Joseph R. "Beau" Biden III, të cilin e kemi vendosur në rrugën Gjilan-Ferizaj. Ai në Kosovë la solidaritet dhe përkushtim, luftoi për lirinë në Kosovë dhe ndihmoi ndërtimin

e shtetit", është shprehur Haziri. Ndërkaq, rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, e ka vlerësuar lartë kontributin e Joseph R. "Beau" Biden III, për mbështetjen e madhe që ai i dha Kosovës, gjithmonë në shërbim të drejtësisë dhe lirisë.

"Vlerësojmë lartë kontributin dhe veprën e Beau Biden në fushën e drejtësisë. Ai padyshim që është një prej amerikanëve që ka bërë shumë për Kosovën, sidomos në periudhën e pas luftës, duke na ndihmuar në ndërtimin e sistemit ligjor. Andaj, vepra dhe kontributi i tij dhënë për Kosovën, nuk duhet harruar asnjëherë", ka thënë rektori Hajrizi.



UBT lider i implementimit të standardeve ndërkombëtare dhe evropiane në Kosovë



UBT ka qenë gjithmonë prijës në implementimin e cilësisë dhe standardeve, si institucioni më i madh i arsimit të lartë në vend, i vlerësuar me çmimin më të lartë nga Këshilli i Ekselencës botërore, konkretisht nga Organizata e njohur për Menaxhimin e Cilësisë (EFQM) me Çmimin e Ekselencës me Pesë Yje.


Gjatë gjithë kësaj kohe, UBT vazhdimisht ka kontribuar në zhvillimin e standardeve dhe cilësisë, ku edhe ka hartuar një sistem modern të sigurimit të cilësisë, i certifikuar në përputhje me kriteret e standardeve të sigurimit të cilësisë të ISO 9001:2000, si dhe është vlerësuar nga ekspertë të jashtëm dhe nga një institucion i akredituar evropian dhe ndërkombëtar.

UBT vitin e kaluar ishte nikoqir i Asamblesë së Përgjithshme të

Organizatës për Cilësi në Evropë, nën udhëheqjen e organizatës "Quality Kosova", që drejtohet nga presidenti i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi. Aty u diskutua për mbështetjen dhe angazhimin shoqëror që duhet dhënë arsimit të lartë, teksa pjesëmarrësit shkëmbyen përvojat e tyre mbi mënyrën e sigurimit të cilësisë.

Se UBT i kushton vëmendje dhe rëndësi të veçantë sigurimit të cilësisë, dëshmon fakti se ajo ka themeluar Zyrën për Sigurimin e Cilësisë dhe Performancës. Kjo zyrë përcakton funksionet e të gjithë stafit në procesin e sigurimit të cilësisë dhe performancës, dhe harton një plan vjetor të zhvillimit, i cili parashikon indikatorët dhe kriteret për sigurimin e cilësisë.

UBT zhvillon strategjinë e projektit "Kosova Smart City", përgatit planin për 6 komuna



UBT do të përgatisë strategjinë "Kosova Smart City" për gjashtë komuna të Kosovës, përfshirë Prishtinën, Gjilanin, Pejë, Prizrenin, Vushtrrinë dhe Lipjanin, projekt që u siguron këtyre qyteteve qasje inovative ndaj problemeve lokale.

Komunat në fjalë do të participojnë financimin dhe zbatimin e projektit, teksa do të trajtohen sektorët që që kanë nevojë për trajtim me prioritet. Kështu u tha në takim dhe zhvilluar online, ku pjesëmarrës ishin rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, drejtori i Qendrës për Studime Urbane në UBT, Shqiprim Ahmeti, përfaqësues nga SDC-ja zviceriane në Kosovë, si dhe morën pjesë drejtorët e drejtorive të urbanizimit të gjashtë komunave të lartëpërmendura.

Gjatë këtij takimi virtual është bërë

e ditur se UBT në këtë strategji tejet inovative ka përfshirë partnerë edhe universitete të njohura në botë, si Universitetin TU Wien, në Austri, ETH Zurich, në Zvicër, Universitetin Mimar Sinan Fine Arts, në Turqi. Projekti "Kosova Smart City" do të mbledhë 20 ekspertë nga akademia dhe ekspertë nga institucionet partnere, si dhe nga industria, të cilët do të hartojnë gjashtë strategjitë për gjashtë komunat, strategji që do t'u mundësojë këtyre qyteteve një zhvillim të qendrueshëm urban.

Projekti do të fillojë të implementohet në shtator të këtij viti, teksa në të do të punësohen edhe 18 profesionistë të rinj nga secila komunë, ku së bashku me ekipin punues do të përgatitin deri në 18 plane veprimi.

MASH-i shpall fitues projektin e profesorëve të UBT-së në fushën e Shkencave të Ushqimit dhe Agrikulturës



Projekti i hartuar nga profesorët në UBT, Fidan Feka, Berat Durmishi, Gjengiz Cesko, si dhe nga studentet e UBT-së, Fjolla Vllasaliu dhe Era Bruçi, i titulluar "Hulumtimi i Efekteve të Pesticideve mbi Aktivitetin e Enzimës Polifenol Oksidazë në Molla (Jonagold)", është shpallur fitues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH).

Projekti fitoi në kuadër të "projekteve të vogla shkencore për vitin 2020, i cili ka të bëjë me përdorimin e pesticideve në rritjen e pemëve dhe efektin e

pesticideve të përdorura zakonisht në aktivitetin e enzimave, që studimi do të vlerësojë përdorimin e polifenol oksidazës (PPO).

Ky është projekti i dytë i profesorëve dhe studentëve të UBT-së që shpallet fitues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Kosovë, në kuadër të "Projekteve të Vogla shkencore për vitin 2020". Projektet do të mbështeten financiarisht nga MASH-i muajt e ardhshëm.

UBT ka filluar përdorimin e teknologjisë aeronautike, funksionalizohen dronët për transport të shërbimeve

UBT është institucioni i parë i arsimit të lartë në Kosovë që ka bërë investime në industrinë e aeronautikës dhe hapësirës ajrore përmes Fakultetit të Mekatronikës, program që mesin e specializimet unike e ka edhe Inxhinierinë e Aeronautikës. Përveç ofrimit të studimeve në një fushë tashmë të re në Ballkan, në UBT në kuadër të këtij fakulteti po punohet edhe në implementimin e teknologjive tejet inovative në industri, sikurse është edhe teknologjia e dronit. Përveç edukimit dhe zhvillimit

të kësaj teknologjie, UBT ka zhvilluar programin për "SMART CITY" dhe "SMART MOBILITY", program në të cilin po përdoren dronët në transportin e shërbimeve të ndryshme në komunikim ndërmjet objekteve dhe kampuseve inovative të UBT-së. Tashmë dronët janë vënë në funksion dhe është bërë lansimi i parë i përdorimit të tyre, teknologji në të cilën përfshihen edhe elementet e inteligjencës artificiale, teknologjia arodinamike e hapësirës, teknologjia e shmangies së objekteve dhe

të tjerët, sigurisë kibernetike, si dhe teknologji të tjera të ndërlidhura me këtë projekt.

Ky program ka për qëllim ngritjen mobilitetit të qëndrueshëm duke zvogëluar ndotjen e ambientit, rritjen e efikasitetit dhe efijencës në punë.

UBT përpos kësaj teknologji e dini se ka impletuar edhe teknologjitë tjera të së ardhmes, siç janë: Robotika, 3D Printerët, Teknologjia 5G, Siguria Kibernetike, etj.

Ambasadori i Japonisë në Kosovë, Ogasawara Mitsunori vizitoi UBT-në

Ambasadori i Japonisë në Kosovë, Ogasawara Mitsunori, ka vizituar UBT-në, institucionin lider dhe model në rajon për cilësi, leadership, inovacion.

Ambasadori Mitsunori u prit nga rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, ku bashkërisht panë nga afër infrastrukturën tejet moderne, si dhe gjitha objektet që posedon institucioni në Kampusin Inovativ në Lipjan.

Ata panë rreth 100 laboratorë inovativ të të gjitha fushave të studimit, sallat për pjesën teorike, bibliotekën

me mbi 250 mijë tituj dhe libra fizik, sallat e leximit, ambientet rekreative, sallat për pjesën praktike, etj.

Me këtë rast, rektori Hajrizi theksoi se UBT ka krijuar infrastrukturë me pajisje të fjalës së fundit të teknologjisë, infrastrukturë që është e krahasueshme me atë të universiteteve prestigjioze botërore.

Rektori Hajrizi tregoi se praktikat dhe profesionalizmin e e ftuar, UBT i ka vënë në shërbim të popullit dhe shtetit të Kosovës.

Në anën tjetër, ambasadori



Mitsunori u shpreh i lumtur që pa, duke potencuar se ky krijuar një proces cilësor e të me kushtet infrastrukturore institucion vlerësohet të ketë lehtësuar studimi.

Rektori Hajrizi pritet në takim nga zyrtarë të TIKA-s në Kosovë



Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi është pritur në takim punime nga zyrtarë të Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim "TIKA", zyra ndërlidhëse në Prishtinë.

Bashkërisht ata diskutuan mundësitë e bashkëpunimit lidhur me implementimin dhe jetësimin e projekteve kryesisht në fushën e

shkencës dhe teknologjisë, zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme me karakter studimor, etj.

Përfaqësuesit të TIKA-s u shprehën të interesuar të përkrahin projekte të tilla inovative, teksa thanë se do të ndërtohet një bashkëpunim ndërinstitucional në të ardhmen.

UBT pjesë e Rrjetit për Hulumtim dhe Edukim i Kosovës, nënshkruan memorandum me MEA-në



Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me ministrin në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuqi, për projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës (KODE), në kuadër të Rrjetit për Hulumtim dhe Edukim i Kosovës.

Me nënshkrimin e këtij memorandum nga UBT, si dhe institucione tjera, u jetësua edhe Rrjeti për Hulumtim dhe Edukim i Kosovës, ngjarje kjo e cila u cilësua

edhe si e rëndësishme që ndërlidhi bashkë arsimin dhe teknologjinë.

Memorandumi parasheh bashkëpunim në promovimin e zhvillimit ekonomik, rritjen e punësimit përmes fushës së teknologjisë së informimit dhe komunikimit, njëherësh edhe krijimi i qasjes së resurseve të teknologjisë dhe dijes për studentët dhe profesorë të të gjitha kolegjeve dhe universiteteve në Kosovë.

Rrjeti për Hulumtim dhe

Edukim i Kosovës po punon në zhvillimin e komunitetit e hulumtuesve, duke i siguruar këtij komuniteti qasje në resurse të ndryshme digjitale, përfshirë qasjen në infrastrukturë moderne të teknologjisë së informacionit, shërbime të ndryshme digjitale, qasje në literaturë, si edhe të ofrojë bashkëpunim në mes të institucioneve arsimore brenda dhe jashtë Kosovës.

Rektori Hajrizi mori pjesë në konferencën "Universitetet Publike Shqiptare Përballë Sfidave të Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë"

Është mbajtur konferenca e dytë të rektorëve të universiteteve shqiptare, me temë: "Universitetet Publike Shqiptare Përballë Sfidave të Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë", në Korçë, ku mori pjesë edhe rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi.

Konferenca u organizua nga Universiteti "Fan S. Noli", teksa mobiliteti në universitetet shqiptare ishte një nga parimet kryesore që u diskutua në këtë konferencë, me ç'rast u theksua nevoja për një bashkëpunim të tillë sepse më së shumti do të përfitonin studentët dhe stafi akademik. Rektori i Hajrizi potencoi që institucioni që ai drejton është i gatshëm të bashkëpunojë në hulumtime shkencore, do të kontribuojë në hapjen e programeve të përbashkëta studimi, njëherësh do të ndihmojë në aspektin profes-



sional institucionet tjera në rritjen e cilësisë dhe ngritjen

e kapaciteteve.

Në përgjithësi, rektorët në

këtë konferencë u pajtuan që të mbështesin studentët në

përfitim të kompetencave të duhura në profesionin që ata zgjedhin, të nxjerrin kuadro që i përmbushin kërkesat e tregut të punës, ndërkaq si sfidë e theksuan uljen e numrin të studentëve si rezultat i emigracionit, rënies së natalitetit, apo edhe faktorëve tjerë.

Gjatë kësaj konference u diskutuan edhe temat si: Drejtimi i Universitetit Publik, Autonomia, Strukturat dhe Gjithëpërfshirja, Ndërkombëtarizimi i Universiteteve Publike, Sfida dhe perspektiva, Potenciali i pashfrytëzuar i menaxhimit të cilësisë dhe Kurrikula Universitare dhe Punësimi.

UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Sporteve të Tiranës

Rektori i UBT-së prof.dr. Edmond Hajrizi, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me rektorin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, prof.dr. Agron Kasa.

Rektori Hajrizi, këtë bashkëpunim e cilësoi shumë të rëndësishëm, që studentëve do t'u mundësoj shkëmbim të njohurive dhe do të shtyjë përpara projekte të përbashkëta akademike e shkencore. "Kjo marrëveshje bashkëpunimi është e rëndësishme, pasi



që shtyn përpara projekte të përbashkëta akademike e kërkimore, si dhe zhvillim të programeve të përbashkëta akademike e shkencore, mes dy institucioneve.", ka thënë rektori i UBT-së prof.dr. Edmond Hajrizi.

Me këtë marrëveshje synohet shkëmbim i stafit akademik dhe studentëve, që do t'i hap rrugë dy universiteteve për punë të përbashkët në fushën shkencore dhe hulumtuese.

Rektori Hajrizi pritet në takim nga rektori i Universitetit të Sporteve të Tiranës




Rektori i UBT-së prof. dr. Edmond Hajrizi, u prit në një takim pune nga rektori i Universitetit të Sporteve të Tiranës prof. dr. Agron Kasa. Rektori i UBT-së prof. Dr. Edmond Hajrizi, e cilësoi shumë të rëndësishëm këtë takim,

që do t'i hap rrugë dy universiteteve për punë të përbashkëta në fushën shkencore dhe hulumtuese, që do të ndërlihd arsimin e lartë mes Prishtinës dhe Tiranës. Rektori i Universitetit të Sporteve të Tiranës, prof. dr.

Agron Kasa, e cilësoi këtë takim të rëndësishëm dhe premtues, duke shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar me UBT-në, edhe më tutje përmes projekteve të ndryshme të bashkëpunimit.

Rektori Hajrizi u prit në takim nga kryetari i Korçës, Sotiraq Filo



Në kuadër të vizitave zyrtare në Shqipëri, rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi është pritur në takim pune nga kryetari i Bashkisë së Korçës, Sotiraq Filo. Në këtë takim rektori Hajrizi dhe kryetari biseduan për tema që lidhen me zhvillimin e projekteve në fushën e digjitalizimit, inovacionit, punësimit të rinjve dhe çështje tjera për zhvillim.

Bashkërisht ata diskutuan mundësitë e bashkëpunimit dhe implementimin e praktikave më të mira që tani më ekzistojnë edhe në qytetin e Korçës. Ata theksuan se përmes këtyre projekteve, dyja institucionet synojnë mundësinë unike për punësimin e të rinjve të Korçës, dhe në përgjithësi të rinjve nga Shqipëria dhe Kosova.

Në cilësinë e ndërmarrësit të suksesshëm, rektori Hajrizi mori pjesë në Digital Weekend

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi ka marrë pjesë në Digital Weekend, në Korçë, aktivitet që promovoi vlerat e inovacionit, teknologjisë dhe njohurive digjitale.

Ai para mbi 200 pjesëmarrësve ka ndarë përvojat dhe ka rrëfyer suksesin e UBT-së, që tashmë është vlerësuar ndërkombëtarisht si institucion i suksesshëm dhe është modeli më i mirë për ndërmarrësit e ardhshëm kosovarë, që të kenë sukses sidomos në botën akademike.

Rektori Hajrizi tha se ndërmarrësia në institucione arsimore është mjaft komplekse dhe e vështirë sepse përveç se duhet të krijojnë një stabilitet për vetë ndërmarrjen, është e nevojshme që të krijojnë kompetenca dhe kuadro për kompani tjera duke përgatitur kuadrot të së ardhmes, gjë që UBT ka arritur ta realizojë.

"UBT si institucion i arsimit të lartë ka filluar nga zero në vitin 2001, ndërsa tani është institucioni që numëron numrin më të madh të stafit dhe numër

të madh të studentëve, rreth 25 mijë studentë, si dhe numrin më të madh të programeve të akredituara. Universitetet kanë një përgjegjësi shumë të madhe sepse përveç edukimit të duhet të gjenerojnë dije të reja si dhe të sjellin inovacionet e fundit, siç ka sjell UBT teknologjitë e fjalës së fundit", theksoi ai.

Tutje, ai potencoi se funksionet e dizajnuara dhe të implementuara nga UBT janë të bazuara në taktikat më të mira në botë dhe kontribuojnë dukshëm në ngritjen e punësimit, vetëpunësimit, bashkëpunimit, edukimit dhe industrisë, duke krijuar kështu një ekosistem.

"Roli i universiteteve në krijimin e ekosistemeve është i rëndësishëm, ky koncept edhe ma i rëndësishëm është lidhja e palëve të interesit dhe lidhja mes lidershit dhe qytetit, ku bashkërisht i bashkojnë konceptet dhe krijojmë një transformim në qasje inovative", tha rektori Hajrizi.

Rektori Hajrizi mori pjesë në konferencën e rektorëve "Universiteti, Politika dhe Vlerat e Arsimit të lartë"



Është mbajtur konferenca e dytë e rektorëve të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë me temën: "Universiteti, Politika dhe Vlerat e Arsimit të lartë", me ç'rast mori pjesë rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, si dhe udhëheqës tjerë të universiteteve publike, udhëheqës institucional, shefja e zyrës së BE-së dhe ambasadorë.

Me këtë rast rektori Hajrizi tha se ndërtimi i një shteti

të fuqishëm ekonomikisht e ka bazën tek lidhja dhe bashkëpunimi i ngushtë mes arsimit të mirëfilltë dhe industrisë.

Si një model të tillë ai e paraqiti UBT-në, si institucion i cili tash e 17 vite ka përgatitur studentë që në të ardhmen të shndërrohen në ndërmarrës të suksesshëm.

"UBT është prijës i ndryshimeve dhe inovacioneve në Kosovë, fusha në të cilat

është dëshmuar ndër vite, pra konsideroj që ky institucion i arsimit të lartë shërben si qendër që prodhon dije dhe vend që po përgatitin gjeneratat për zhvillim, model që duhej të përcillet nga institucione tjera", tha rektori Hajrizi.

Ndërkaq, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti potencoi se do të angazhohet maksimalisht që ti përmbush përgjegjësitë ndaj arsimit të lartë në Kosovë.

"Koha është tash dhe ky është momenti që kemi pritur. Kurrë nuk ka pasur qeveri më të interesuar, e më të përkushtuar për zhvillimin e arsimit, që është parakusht për zhvillimin e vendit", deklaroi kryeministri Kurti.

Në këtë konferencë u tha se institucionet përkatëse do të rrisin investimet në arsimin e lartë, njëherësh edhe të bëhen referoma që mundësojnë tejkalimin e sfidave në këtë proces.

UBT dhe Komuna e Vushtrrisë nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi për fillimin e projektit “Smart City Kosova”

Rektori i UBT-së prof.dr. Edmond Hajrizi dhe kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, në emër të institucioneve që drejtojnë, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e projektit për hartimin e strategjisë “Smart City Kosova” në qytetin e Vushtrrisë.

Ky projekt synon që të përgatisë dhe komunikojë strategji gjithëpërfshirëse të qyteteve të mëdha, të cilat do t'u sigurojnë qyteteve të Kosovës qasje inovative ndaj problemeve të komunitetit, si dhe do të ndihmojnë në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm hapësinor dhe urban. “Kjo marrëveshje është një hap shumë i rëndësishëm drejt



zhvillimit të qytetit të mëdha në Vushtrri, ndërsa UBT tashme

ka filluar me implementimin e këtij koncepti në Kampusin Ino-

vativ në Lipjan, ku është krijuar një qendër e cila bashkon të rin-

jtë në zgjidhjen e problemeve të komunitetit të tyre.”, tha rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi. Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri e ka mirëpritur nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me rektorin e UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi. Ai ka përsëritur projektin të cilin UBT po e zhvillon në bashkëpunim me gjashtë komuna të Kosovës, produkt final i të cilit do të jetë hartimi i strategjive gjithëpërfshirëse për zhvillim të mëdha hapësinor, urban, socio-ekonomik dhe infrastrukturor për këto komuna.

Rektori Hajrizi pritet në takim pune nga kryetari i Pejës, finalizojnë synimet për projektin “Smart City”

Peja është komuna e radhës me të cilën UBT së shpejti do të nënshkruaj marrëveshje bashkëpunimi për projektin “Smart City”, strategji që i mundëson këtij qyteti qasje inovative ndaj problemeve lokale.

Për të finalizuar synimet për këtë strategji inovative, rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi dhe drejtori i Qendrës për Studime Urbane në UBT, Shqiprim Ahmeti, janë pritur në takim pune nga kryetari i Pejës, Gazmend Muhaxheri, drejtori i Urbanizmit në këtë komunë, Rejan Arapi, si dhe nga zyrtarë tjerë komunal. Bashkërisht diskutuan çështjet finale për ti hapur rrugë

nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit, teksa thanë se përmes këtij bashkëpunimi jetësohet projekti gjigant e shumëdimensional “Smart City”. UBT do të përgatisë strategjinë “Smart City” edhe për komuna tjera të Kosovës, përfshirë Prishtinën, Gjilanin, Prizrenin, Vushtrrinë dhe Lipjanin, tashmë edhe për Pejën, projekt që mbledhë ekspertë nga academia, institucionet partnere dhe industria, të cilët do të hartojnë strategji që do t'u mundësojë këtyre qyteteve një zhvillim të qëndrueshëm urban.



UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e Junikut



Rektori i UBT-së prof.dr. Edmond Hajrizi dhe kryetari i Komunës së Junikut, Agron Kuçi, në emër të institucioneve

që drejtojnë, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Gjatë këtij takimi, rektori Hajrizi dhe kryetari Kuçi shprehën

gatishmëri të bashkëpunojnë në hartim të projekteve që do të kenë ndikim pozitiv në zhvillim të qëndrueshëm lokal, e të cilat do të gjejnë zbatim në praktikë. Kjo marrëveshje siguron bashkëpunimin në hartim të projekteve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, urban, arsimi dhe turizmin natyror të kësaj komune.

Gjithashtu, drejtuesit e dy institucioneve janë pajtuar në organizimin e aktiviteteve që janë në interes të përbashkët, që kanë të bëjnë me shkencën, inovacionin dhe jo vetëm.

UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e Istogut



Rektori i UBT-së prof.dr. Edmond Hajrizi dhe nënkryetari i Komunës së Istogut, Agim Ademaj, në emër të institucioneve që drejtojnë, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Kjo marrëveshje siguron bashkëpunimin në hartim të projekteve për zhvillim ekonomik, urban dhe industrial të kësaj komunë, projekte që do të gjejnë zbatim edhe në praktikë. Gjithashtu, drejtuesit e dy institucioneve janë pajtu-

ar në organizimin e aktiviteteve që janë në interes të përbashkët, që kanë të bëjnë me shkencën, inovacionin dhe jo vetëm. Ndërkaq, UBT do të ndihmojë Komunën e Istogut në dhënien e ekspertizave profesionale me qëllim të arritjes së një shkalle të suksesshme të ndërtimit të kapaciteteve institucionale dhe zhvillimore, veçmas në ide, projekte, pilot-projekte etj.

UBT do të hartojë Planin Zhvillimor Komunal për Komunën e Vitisë



Me qëllim të zhvillimit të një strategjie gjithëpërfshirëse e të qëndrueshme, UBT ka zgjeruar bashkëpunimin dhe ka nënshkruar marrëveshje për hartimin

e Planit Zhvillimor Komunal me Komunën e Vitisë, ku do të mbledhë ekspertë e profesionistë që do të mbështesin këtë projekt.

Projekti do të mbledhë ekspertë e profesionistë të fushës, staf akademik të UBT-së dhe zyrtarë të komunës, të cilët do të bashkëpunojnë në hartimin e këtij plani profesional. Grupi punues i projektit do të ofrojë mbështetje profesionale dhe organizative, teksa do të mbajnë vizita në terren, si dhe do të mbajnë konferenca informative lidhur me projektin.

Projekti ka për qëllim përmirësimin e menaxhimit hapësinor dhe urbanistik, si dhe të rregullojë dhe forcojë strukturat organizative të përshtatshme për planifikim strategjik.

Rektori Hajrizi pritet në takim nga zv.kryeministri i parë i Kosovës, Besnik Tahiri

Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi është pritur në takim nga zëvendëskryeministri i parë i Kosovës, Besnik Tahiri, të cilët bashkërisht kanë biseduar për rolin e akademisë, konkretisht për kontributin që UBT ka dhënë si institucion në fuqizimin e emrit të shtetit tonë në nivelet më të larta të edukimit, shkencës dhe inovacionit. Bashkërisht ata kanë folur për një sërë çështjesh të karakterit bilateral të bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e arsimit të lartë,



ku u theksua nevoja për mbështetjen institucionale për inovatorët e ardhshëm. Me këtë rast, rektori Hajrizi i ka dëshiruar suksese në punën institucionale zv.kryeministrit Tahiri, i cili njëherësh është edhe profesor në UBT. Rektori Hajrizi tha se ndjehet i kënaqur që një profesor i UBT-së po jep kontributin e tij profesional, kontribut që është jashtëzakonisht i rëndësishëm në shtetndërtimin e Kosovës.

Lansohet aplikacioni online për leje ndërtimi, donacion i UBT-së për Komunën e Prishtinës



Prishtina është komuna e parë në Republikën e Kosovës dhe në rajon që ka lansuar sistemin "Aplikacioni online për leje ndërtimi", aplikacion që është krijuar nga UBT, si institucioni më inovativ i arsimit të lartë në vend. Përmes këtij sistemi është digjitalizuar edhe procedura për leje ndërtimi, sepse aplikacioni mundëson procedurë digjitale të aplikimit dhe procesit të trajtimit të kërkesave që i adresohen Drejtorisë së Urbanizmit. Ky sistem online do të për-

shpejtojë procesin e aplikimit dhe do të rritë transparencën, njëherësh ndikon në uljen e kostos dhe ruajtjen e ambientit. Kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti ka falënderuar UBT-në për mbështetjen e pakursyer në digjitalizimin e procedurës për leje ndërtimit, duke shtuar se aplikacioni do të implementohet në fazë. "Aplikacioni online për leje ndërtimi" do të implementohet në fazë, ku fillimisht do të mundësohet aplikimi dhe trajtimi i kërkesave për

KUSHTE NDËRTIMI kategoria 1, ku në muajt në vijim do të pasojë me çasje në sistem edhe për procedurat e trajtimit edhe të kërkesave tjera pasi që të njëjtat janë në fazën e testuese. Aplikacioni për disa ditë është në fazën testuese, ndërsa nga e hëna, 12.10.2020, mund të shfrytëzohet zyrtarisht. Falënderojmë Kolegjin UBT për mbështetje dhe për këtë donacion të rëndësishëm", theksoi kryetari Ahmeti.

Rektori Hajrizi mori pjesë në emisionin "Metropol", thekson rëndësinë e orientimit në karrierë



Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ishte i ftuar në emisionin "Metropol" që transmetohet në Radio Kosova, i cili gjerësisht ka folur për orientimin në karrierë, si dhe për të rinjtë si sivjet do të fillojnë rrugëtimin akademik universitar. Rektori Hajrizi potencoi se vendi dhe bota në përgjithësi ka nevojë për ekspertë dhe profesionistë, megjithatë, në raport me kërkesat ka mungesë të njerëzve të kualifikuar, prandaj sipas tij, është e rëndësishme zgjedhja e profesionit. Tutje, ai theksoi se investimi në shkollim cilësor është çelës

kryesor për t'u shndërruar në profesionist. "Edukimi nuk duhet të ndalet as në kohë lufte, sepse nëse ndalet atëherë humbet shoqëria, ndalet edhe zhvillimi", theksoi rektori Hajrizi. Më pas, rektori Hajrizi foli edhe për organizimin e suksesshëm të provimeve online në UBT, rolin model që UBT e pati në kohën e pandemisë COVID-19, teksa në cilësinë e ekspertit në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, përmendi edhe teknologjinë 5G, si dhe mundësitë enorme që kjo teknologji i ka ofruar institucionit në kohë pandemie.

Rektori Hajrizi pritet në takim pune nga drejtuesit e portalit "Telegrafi"

Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi dhe koordinatoreja e Media Group në UBT, Jehonë Kapllani-Ilazi janë pritur në takim pune nga drejtuesit e portalit të lajmeve "Telegrafi", të cilët kanë biseduar për mundësitë e bashkëpunimit. Ata folën për angazhimin e studentëve të Fakultetit Media dhe Komunikim në punë praktike në këtë medium me mundësi punësimi, organizimin e konferencave në fushën e medias dhe komunikimit, njëherësh u pajtuan për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta

me karakter studimor. Tanimë disa studentë të Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, janë punësuar në këtë portal, falë bashkëpunimit që UBT dhe Telegrafi e kanë ndërtuar tash e disa vite. Media dhe Komunikim është program i akredituar në UBT që u ofron studentëve dije teorike dhe praktike, në mënyrë që kuadrot e dala nga ky institucion të kryejnë me sukses punët në organizatat ku do të punojnë, kështu duke performuar suksesshëm në të gjitha fushat e komunikimit.

Rektori Hajrizi vizitoi kompani të industrisë ushqimore në Gjilan



Në kuadër të partneritetit që UBT ka me kompani të njohura nga industria e ushqimit në mbarë vendin dhe më gjerë, rektori i UBT-së, prof.

Edmond Hajrizi, ka vizituar kompaninë e lëngjeve "Fluidi" dhe kompaninë e vajit "Flu-oil", njëherësh edhe qumështoren "Kabi", në Gjilan.

Rektori Hajrizi është shoqëruar nga profesori, Fidan Feka, dekani i Fakultetit Shkencat e Ushqimit dhe Fakultetit të Agrokulturës, Medin Zeqiri, u pritën drejtuesit e kompanive në fjalë, teksa diskutuan për vazhdimin e bashkëpunimit me qëllim të ndërlidhjes së akademisë me industrinë prodhuese dhe përpunuese. Drejtuesit e këtyre kompanive thanë se ky institucion i arsimit të lartë ka nxjerrë kuadro tejet profesionale, ku si rezultat një pjesë e stafit në këto industri ushqimore përbehet nga studentë e ish-studentë të UBT-së, si teknologë, ekonomistë, juristë, inxhinierë, etj.

Mediat e UBT-së





Studentja e UBT-së shndërron vajin në biodizel që përdoret për shërbime transporti

Për muaj me radhë, studentja e Fakultetit Inxhinieri e Energjisë Eficiente, në UBT, Laura Nushi ka hulumtuar në tregun e Kosovës, konkretisht në sektorin e gastronomisë, lidhur me sasinë dhe gjendjen e vajit të mbetur të shfrytëzuar, e më pas ka studiuar mundësisë e riciklimit të kësaj lënde.

Këtë ajo e zhvilloi si hulumtim në laboratorin e kimisë në UBT, ku vajin e mbetur sidomos nga sektori i gastronomisë, e shndërroi në biodizel, e që mund të përdoret nga mjetet transportuese apo si burim i energjisë.

I gjithë hulumtimi u finalizua nën mentorimin e profesorit Sami Makolli, teksa gjeti mbështetje nga vetë rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Ha-



rizi, Fakulteti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT, si dhe nga institucione vendore qeveritare.

Nga hulumtimi i studentes së UBT-së, Laura Nushi, doli se Kosova çdo vit mesatarisht humb 4.5 milionë litra vaj të shfrytëzuar, sasi nga e cila mund të prodhohen 3.5 milionë litra biodizel.

Ajo tha se shndërrimi i vajit të zakonshëm në biodizel mund të shfrytëzohej mjaft mirë për shërbime transporti, ku njëherësh do të mundësohej ulja e ndotjes së ajrit.

“Nëse kjo sasi vaji do të shndërrohej në energji elektrike (38890 MWh), i gjithë sektori i amvisërisë do të mbulohej, ndërkaq përdorimi i tij si karbu-

rant për qëllime transporti do të ulte dukshëm praninë e grimcave ndotëse në ajër. Me këto Kosova do të ishte një hap para arritjes së caktit të saj të caktuar për eficientë”, ka theksuar ajo. Laura ka falënderuar UBT-në si institucion lider në arsimin e lartë, stafin akademik të UBT-së, për mbështetjen, njohuritë dhe praktikën profesionale të marra përgjatë studimeve universitare dhe rrugëtimit akademik. Rezultatet e këtij hulumtimi janë prezantuar në Konferencën Ndërkombëtare të UBT-së, për Shkencë, Teknologji, Biznes dhe Inovacion, ku këtë vit i zhvilloi punimet edicioni i nëntë, me rreth një mijë studiues vendorë e ndërkombëtarë.

Bard Bajçinovci pjesë e stafit akademik në UBT



Studenti i Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, Bard Bajçinovci është bërë pjesë e stafit akademik të UBT-së, në cilësinë e asistentit, i cili është i angazhuar në lëndët: “Konstrukcione Arkitektonike 3” dhe “Banim”.

Bardi, gjatë kohës së studimeve ka përfutur njohuri shkencore e profesionale, me një bashkëpunim të ngushtë me profesorët dhe ekspertët e UBT-së, si dhe ishte një nga studentët e shumtë që vizituan universitetet e ndryshme evropiane.

Ai ka thënë se mundësia e dhënë nga UBT për të qenë pjesë e stafit akademik është një privilegj për të, ndaj edhe është shprehur shumë falënderues ndaj të gjithë atyre që ndihmuan atë në rrugëtimin akademik.

“Jam falënderues dhe mirënjohës të gjithë stafit akademik të Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor për mbështetjen profesionale përgjatë rrugëtimit 5 vjeçar të studimeve”, ka thënë Bardi.

Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, vazhdimisht është duke përgatitur ekspertë të arkitekturës për identifikimin dhe analizën e problemeve arkitektonike, hartimin dhe zhvillimin e tyre në arkitekturë, ndaj edhe studentët e këtij drejtimi sistemohen shpejtë në tregun e punës.

Enur Pakashtica, student dhe ndërmarrës i suksesshëm



Shumë studentë të UBT-së janë shndërruar në ndërmarrës të rinj e të suksesshëm, disa prej tyre, si Enuri, madje filluan biznese, themeluan kompani dhe krijuan vende të reja të punës. Enur Pakashtica është student i Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, tashmë pronar i kompanisë së shërbimeve të postës së shpejtë “Posta Mik Mik”, që numëron rreth 54 punëtorë, një prezantues me

përvojë profesionale në industrinë e medias, dhe një profesionist i specializuar për Marketing në UBT.

Duke folur për eksperiencat gjatë studimeve në UBT, ai inkurajoi studentët e rinj që të besojnë në aftësitë e tyre dhe të vendosin qëllime në jetë, teksa potencoi se përkushtimi është qelës i suksesit në përpjekjet aktuale dhe të ardhshme.

Ish-studentit të Fakultetit të Mekatronikës në UBT, i njihet diploma në Gjermani



Diploma e UBT-së është njohur në shtetin e Gjermanisë, fakt që tregon se UBT ka qenë dhe mbetet një institucion i cili njihet ndërkombëtarisht. Ish-studentit të Fakultetit Menaxhim i Mekatronikës në UBT, Ilir Mahmutaj, i është barasvlerësuar diploma e UBT-së në Gjermani, me një shkollim të ngjashëm me atë që ka diplomuar në UBT.

Iliri, ka studiuar në nivelin bachelor në Menaxhim të Mekatronikës, në periudhën 2016-2019, dhe është ndarë i kënaqur me profesorët dhe stafin e UBT-së. Sipas tij, ai në UBT ka përfutur eksperiencën dhe udhërrëfime të pazëvendësueshme për karrierën e tij profesionale.

Ai e ka vlerësuar lartë qasjen perëndimore që UBT gjithmonë e ka pasur si institucion i lartë i arsimit, ndaj edhe procesi i nostrifikimit sipas tij ishte proces relativisht i thjeshtë.

“Procesi ishte relativisht i thjeshtë, falënderojë administratën e cila ka qenë gjithmonë e gatshme, e kuptueshme dhe shumë e shpejtë në shërbimet për studentët”, ka thënë Iliri. Fakulteti Menaxhim i Mekatronikës në UBT, studentëve u ofron programin studimor në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, e që diploma e UBT-së ka vlerë të barabartë me të gjitha vendet e BE-së dhe më gjerë.

Studenti i gazetarisë, Aid Berkolli pjesë e “Pro Real Estate”



Studenti i Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, Aid Berkolli, është punësuar në Agjencinë për Patundshmëri “Pro Real Estate” në cilësinë e kameramanit. Ai punon edhe në cilësinë e videoeditorit në këtë kompani, teksa njëkohësisht është edhe kameraman në Televizionin 7 (T7), aty ku bën xhirimin e emisioneve të ndryshme televizive. Duke marrë parasysh pasionin

që Aidi e kishte për fotografimin dhe videon, ai kishte zgjedhur Fakultetin Media dhe Komunikim në UBT, për të vazhduar studimet e tij në fushën e gazetarisë.

Kushtet e mira infrastrukturore, si dhe mundësitë për të praktikuar profesionin, i mundësuan atij që ai të marrë njohuritë e mjaftueshme për të nisur karrierën e tij profesionale në këtë

lëmi.

“Studimet në UBT më mundësuan që të përfitojë shumë njohuri, ashtu siç përfutur shumë studentë të tjerë, ngaqë aty ligjëronin profesorë eminent dhe asistentë adekuat, që na shpjegonin punën e mediave në vendin tonë, e njëkohësisht na mundësonin që të punojmë me video e fotografi, duke na dhënë hapësirë që të praktikonim montazhin me paketën e Adobes”, ka thënë studenti Berkolli. Aidi ka vlerësuar lartë vizitat studimore që i ka bërë bashkë me studentët e tjerë, organizuar nga Fakulteti Media dhe Komunikim në UBT, nëpër medime të ndryshme si në Kosovës ashtu edhe në Shqipëri, e që për të dhe studentët e tjerë ishin më se të nevojshme për të parë nga afër punën e të bërit gazetari.

Fakulteti Media dhe Komunikim në UBT, vazhdimisht është duke i ofruar Kosovës gazetarë, kameramanë, videoeditor, e zyrtarë të mediave, të profesionalizuar në fushën e medias dhe komunikimit, falë programit unik, të gërshtuar me elemente të shumta të gazetarisë, që posedon ky fakultet.

Studenti i masterit, Baton Neziri ndërmarrës i ri në fushën e teknologjisë informative

Baton Neziri është student i nivelit master në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, i cili falë njohurive dhe përvojës së fituar të punës në fushën e teknologjisë informative, ka filluar karrierën si ndërmarrës i pavarur.

Ai sapo ka themeluar kompaninë "Prishtina Tech Group", ku ofron shërbime në fushën e IT-së për individ dhe institucione, teksa Batoni është i angazhuar edhe si uebmaster për projektin e financuar nga Bashkimi Evropian "Mbështetje për Kodin Civil të Kosovës".

"Vlerësoj shumë UBT-në për njohuritë e fituara gjatë kohës së studimeve të magjistraturës. Këto njohuri më kanë shërbyer për ndërtimin dhe përgatitjen



e së ardhmes në fushën e ndërmarrësisë", theksoi studentin Batoni.

Batoni ka përvojë profesionale në fushën e teknologjisë informative, përfshinë organizatat e huaja në Kosovë: Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (European Union Office in Kosova), institucionet publike (Kuvendi i Kosovës, Instituti Albanologjik i Prishtinës), dhe në sektorin privat (MDA, UBO Consulting, Cambridge School, Air Prishtina).

"Përveç punës si ndërmarrës, jam i angazhuar nga Giorgio Cini Foundation (Venedik, Itali) në bashkëpunim me Universitetin e Harvardit (Boston, Amerikë),

për të promovuar trashëgiminë kulturore të shqiptarëve, Eposin e Kreshnikëve, në konferencën ndërkombëtare të mbajtur në Venedik, 2018. Gjatë viteve 2011-2012 ka punuar në New Jersey, SHBA. Njëherësh jam i angazhuar si konsulent i IT-së përfshinë edhe vendet në rajon (Shqipëri, Mal i Zi, Maqedoni)", tregoi ai.

Batoni është i certifikuar nga CISCO: IT Hardware & Software dhe CISCO Certified Networking Academy (CCNA 1-4), po ashtu është i certifikuar në mirëmbajtjen e rrjeteve sociale, uebfaqeve, në dizajn grafik, sisteme operative dhe siguri të IT-së (cybersecurity).

Tutje, ai është i certifikuar nga Shoqata Ndërkombëtare e

Transportit Ajror (IATA), dhe Federata Botërore e Agjentëve të Turizmit në fushën e industrisë së udhëtimit dhe turizmit. Ka ndjekur trajnime për lider-ship, menaxhment, trashëgimi kulturore dhe teknologji informative në Kroaci, Greqi, Holandë dhe Itali.

Batoni ka pasion edhe trashëgiminë kulturore. Ai është anëtar i dy organizatave në Itali dhe Holandë, The Life Beyond Tourism Travel to Dialogue Movement dhe The Future is Heritage Network, të cilat zbatojnë projekte në fushën e trashëgimisë kulturore në botë.

Studentët e Arkitekturës në UBT qasen lehtësisht në tregun e punës



Ish-studentja e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, Drilona Berisha, është bërë pjesë e stafit të UBT-së, në cilësinë e asistentes në departamentin e Arkitekturës dhe të Dizajnit të Integruar.

Dëshira dhe ëndrra e saj për të arritur në jetë dhe për të korrur suksese ka bërë që ajo të bëhet pjesë e UBT-së, dhe të marrë titullin arkitekthe. Kontributi i saj për komunitetin, angazhimet e shumta në fushën e arkitekturës,

si dhe përvoja e fituar si e punësuar në dy studio projektuese, kanë bërë që ajo të bëhet pjesë e institucionit më të madh të arsimit në rajon, UBT-së.

Drilona ishte përfituese edhe e bursës së mobilitetit në Anhalt University of Applied Sciences në Dessau të Gjermanisë, partneritet ky me UBT-në. Ajo studimet e saja i kishte shtrirë në fushën e "Design Research", fushë në të cilën kishte përfituar njohuri të reja në fushën e hulumtimit në aspektin

e dizajnit.

Drilona, ka vlerësuar lartë cilësinë e studimeve në UBT, profesionalizmin e ligjëruesve, si dhe punën e madhe që bëhet në këtë institucion arsimor.

"Përveç cilësisë së lartë në studime, ligjëruesve me shkollim të lartë akademik dhe eksperiencën shumë profesionale, partneritetet e shumta kombëtare dhe ndërkombëtare, UBT-në e bëjnë të veçantë dhe lider në treg eksperiencën dhe storie të shumta suksesi të studentëve të dalluar, të cilët lindën dhe u rritën brenda mureve të dijës që përbëjnë supet e forta të një institucioni tempull gjithmonë në rritje", ka thënë ajo. Fakulteti Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, në UBT, u ka dhënë studentëve hapësirën e nevojshme, me të gjitha mundësitë për të studiuar në këtë fushë, me mundësi specializimi në Dizajn të qëndrueshëm, Menaxhim Urban, Mirëmbajtje dhe Restaurim në Arkitekturë, Dizajn Enterieri, si dhe Planifikim Urban.

Studentja e Juridikut, Erlinda Ahmeti punësohet në UBT



Erlinda Ahmeti është në përfundim të studimeve bachelor në Fakultetin Juridik, e cila tashmë është punësuar dhe është bërë pjesë e stafit të Qendrës së Karrierës në UBT.

Përveç që ndihmon në koordinimin e kësaj qendre, ajo merret edhe me studentët që synojnë të përfundojnë kurset e gjuhëve të huaja në UBT.

Erlinda tha se studimet në UBT dhe puna e profesorëve kanë qenë shumë të frytshme në fillim-

in e zhvillimit të saj profesional. "UBT ofron zgjidhje të shumta studimesh, ofron edukim cilësor si dhe kushte të mira në zhvillimin e mëtutjeshëm të njohurive", vlerësoi ajo.

UBT si institucion i arsimit të lartë rëndësi është duke ju dhënë edhe afrimit të stafit të ri e të talentuar dhe po përgatit kadro profesionale për tregun e punës ku çdo vit dalin qindra studentë të diplomuar e mbi 90% akomodohen në tregun e punës.

Studentja e Shkencave të Ushqimit, Xheneta Luma punësohet në Ministrinë e Shëndetësisë



Studimet në UBT, cilësia dhe përvojat e marra nga profesorë dhe ekspertë të fushës së Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë, kanë bërë që studentja e nivelit master, Xheneta Luma, të plotësojë të gjitha kriteret për t'u punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë. Xheneta është duke punuar në cilësinë e inspektore sanitare, e cila tashmë me situatën e krijuar nga pandemia COVID-19, merret

me zbatimin e ligjit për masat anticonid, në sektorin e gastronomisë.

Sipas saj, UBT i ka dhënë përkrahje të pakursyer, duke vënë në dispozicion laboratorë të sofistikuar të pajisur me pajisjet më të reja teknologjike, bibliotekën fizike dhe online.

"UBT-ja të ofron mundësi të shumta që hapin rrugë për punësim. Studimet në UBT i bën të veçanta komunikimi me profesorë dhe pajisja me laboratorë të kohës moderne, gjë që është shumë e rëndësishme për profesionin që kam përzgjedhur", tha Xheneta.

Fakulteti Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, ka bërë ndërlidhjen unike të industrisë ushqimore me teknologjinë dhe aplikimin e tyre në praktikë, andaj studentët e diplomuar nga ky drejtim sistemohen menjëherë në tregun vendor e ndërkombëtar të punës.

Liridon Llozani punësohet në Radio Televizionin "Dukagjini"



Liridon Llozani është student i vitit të tretë në Fakultetin Media dhe Komunikim. Njohuritë e fituara përgjatë studimeve dhe puna e tij intensive, atij i janë shpërblyer me punësim në "Radio Televizionin Dukagjini", pas më shumë se dy muajve të kaluar si praktikant.

Ai aktualisht është i punësuar si gazetar në deskun informativ, me ç'rast po i mbulon ngjarjet politike, me fokus politikën e brendshme.

Liridoni theksoi se shndërrimi i pasionit në profesion është gjëja më e mirë që mund të ndodhë në rrugëtimin tuaj drejt një karrierë të suksesshme.

"Studimet në Kolegjin UBT

padyshim kanë ndikuar që pasionin për gazetarinë ta kthejë në profesion. Programi Media dhe Komunikim është i përgjithësuar por që për 3 vjet studime bachelor ju tashmë jeni të gatshëm të njihni secilën fazë, mënyrë e formë të prodhimit të lajmit. Prandaj profilizimi bëhet shumë më i lehtë", vlerësoi ai.

Programi Media dhe Komunikim në nivelin bachelor në UBT, synon të japë informacione të gjera mbi parimet dhe standardet akademike e praktike, duke u ndihmuar studentëve të fokusohen në qëllimet akademike, të sistemohen në tregun e punës si dhe të vlerësojnë eksperiencat e zhvilluara.

Studenti Egzon Hasi përfitues i bursës për vazhdim të studimeve në Portugali

Studenti i Fakultetit Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieri, Egzon Hasi, është përfitues i bursës për vijimin të studimeve në universitetin prestigjioz "Nova

de Lisboa", në Portugali. Ai do të specializojë për Web Programming, ku tha se do të përfitojë njohuri profesionale, si dhe do të njoh kulturën e këtij vendi.

Egzoni është përzgjedhur përfitues i kësaj burse falë notës mesatare mbi 9.0 që e ka arritur gjatë studimeve në UBT.

Ish-studentja e Fakultetit të Mekatronikës punësohet në UBT



Ish-studentja e Fakultetit Menaxhim i Mekatronikës, Natyra Kabashi është punësuar në institucionin më të madh të arsimit të lartë në rajon, aty ku

studioi dhe mori njohuri nga më të ndryshmet në fushën e mekatronikës, në UBT.

Ajo është duke punuar në cilësinë e koordinatores së Fakultetit Menaxhim i Mekatronikës, duke ndihmuar në mbarëvajtjen sa më të mirë të procesit akademik në këtë departament.

Natyrë, ndjehet e lumtur që ka zgjedhur UBT-në për të studiuar dhe zhvilluar vetën në mënyrë akademike, gjersa ka vlerësuar lartë formën se si zhvillohet procesi mësimor dhe mundësitë që UBT u ofron studentëve.

"UBT-në e kam zgjedhur për cilësinë e studimeve, si dhe për mundësitë që u ofron studentëve për zhvillimin sa më të

mirë të tyre, jo vetëm nga ana teorike por edhe nga ajo praktike, gjë që ka qenë shumë e rëndësishme për mua si studente e departamentit të Mekatronikës", ka thënë ajo.

Natyrë, UBT-në e ka vlerësuar si institucionin i cili u siguron të ardhme të rinjve të Kosovës, përdherisa u ndihmon atyre që përgjatë studimeve të përgatiten fuqishëm për tregun e punës. UBT, vazhdon të jetë qendër e studimeve në fushën e mekatronikës, e njohur si vatër e inovacioneve në Kosovë, rajon dhe më gjerë. Studentët e UBT-së marrin pjesë çdo vit në garat e robotikës, duke u përgatitur në mënyrë profesionale në laboratorët inovativë të mekatronikës.

Studenti Edin Pula përfitoi bursë studimi në National University of Public Service

Edin Pula është student i Fakultetit Shkenca Politike në UBT, i cili jetësoi ëndrrën e tij për të vazhduar studimet në një universitet të njohur në botë.

Ai përmes UBT-së vijoi studimet për një semestër në universitetin shtetëror për shërbime publike, në Budapest të Hungarisë, saktësisht në National University of Public Service.

Edini është vetëm njëri nga qindra studentë të UBT-së që janë pranuar dhe kanë vijuar studimet nëpër universitete prestigjioze në botë. Pas për-

fundimit të studimeve me bursë, studentët e UBT-së po kthehen në Kosovë me dëshirën më të madhe për të dhënë kontribut ngaqë po përfitojnë kompetenca të larta, përvojë që synojnë ta ndajnë në vendin e tyre.

UBT ka marrëveshje bashkëpunimi me 450 universitete dhe institucione të njohura ndërkombëtare, të cilat parashohin shkëmbimin e studentëve, stafit akademik, bashkëpunim në aspektin shkencor dhe teknik, vizita studimore, etj.

Ish-studentja e Arkitekturës, Abetare Rexhepi pjesë e stafit akademik



Ish-studentja e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Abetare Rexhepi, është bërë pjesë e stafit akademik, në cilësinë e asistentes në këtë fakultet.

Bindja e saj se UBT do t'i ndihmojë në synimet e saj, në qëllimet që ajo i kishte vënë e vetës, dhe në atë se UBT qëllim parësor e ka zhvillimin e studentëve, ajo kishte zgjedhur UBT-në për të vazhduar rrugën akademike.

Studimet në UBT, asaj i kanë mundësuar që të marrë njohuritë e mjaftueshme për t'u bërë pjesë e stafit akademik, dhe përveç kësaj ajo është edhe zyrtare për Leje Ndërtimore në Departamentin për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në Komunën e Lipjanit.

Abetarja, periudhën e studimeve në UBT, e ka cilësuar të veçantë në formësimin e saj akademik, teksa UBT-në e ka vlerësuar si tempull të dijes.

"Vitet e studimeve bachelor në UBT janë vitet e mia vitale në formësimin e asaj që unë doja të arrija në subkoshiençën time. Në UBT kuptova rrënjësisht se çfarë do të thotë Arkitekturë. Përveç studimeve të mirëfillta në këtë fushë, kam përfituar edhe nga ofertat dhe mundësitë e shumta e simbolike të UBT-së, ku gjatë viteve të studimeve jam shpërblyer me bursë universitare si studente elitare e programit të Arkitekturës", ka thënë ajo.

Studenti i Inxhinierisë së Energjisë punësohet në kompaninë "Muqa Solar Company"



Studenti i vitit të tretë të Fakultetit të Inxhinierisë së Energjisë, Albert Guri, është punësuar në kompaninë e specializuar për projektimin dhe montimin e paneleve solare dhe paneleve termike "Muqa Solar Company". Pas më shumë se dy muaj prak-

tike, falë punës intensive dhe njohurive të fituar përgjatë studimeve, atij mundi i është shpërblyer me punësim në këtë kompani.

Alberti vlerësoi se studimet dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me profesorët ia ka mundësuar

ar ta fillojë karrierën ende pa diplomuar.

"Këtë vit e kam filluar praktikën time të parë. Përvoja ime disa mujore aty është përmbushur edhe më shumë duke i kombinuar teorinë e mësuar në UBT me punën praktike. Rëndësinë e këshillave të ligjëruesve e kuptova ditën e parë të punës, ku çdo gjë të mësuar më herët, aty po e zbatoja", tha ai.

Ndërkaq, Alberti theksoi se një ndër institucionet që ofron cilësi të lartë gjatë studimeve dhe që i ka ndihmuar shumë në aspektin profesional dhe akademik, ishte UBT.

"Gjatë studimeve kam parë se angazhimi i profesorëve në punë është për t'u marrë shembull. Është universiteti me cilësi dhe standarde të larta, ndaj shpresoj që në të ardhmen të jem pjesë e kuadrove të mira që kanë dalë nga këtu", potencoi ai.

Dikur student, tash asistent në UBT


Ish-studenti i Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Blend Dema shkollimin e mëtutjeshëm dhe ngritjen e tij profesionale e vazhdoi në njërin ndër universitetet më të mira në Gjermani, Universitetin Anhalt Dessau.

Për pranim në këtë universitet, ai i është dashur të ndjek disa procedura, të cilat i ka kaluar me shumë sukses falë përgatitjes së tij profesionale, si dhe ndihmës së ofruar nga institucioni.

Blendi tashmë është kthyer në Kosovë, ku përvojën profesionale dhe praktikën e marra gjatë studi-

meve po i transmeton si asistent në Fakultetin e Arkitekturës në UBT, teksa mban pozitën edhe si arkitekt në kompaninë "Maden-Group".

"Studimet në UBT i dallon qasja ndaj studentëve, atmosfera e punës përgatitja profesionale, programe studimi që bën studentët kosovarë të jenë të barabartë me ata të Vjenës, Berlinit, etj., kurrikula të harmonizuara me tregun e punës, e që të mundojnë vazhdimin e studimeve master me njohje të pakontestueshme të diplomës. Po ashtu, bashkëpunimet e shumta



me universitetet botërore dhe me programet evropiane e dallojnë UBT-në në këtë pikë. Në UBT, studentët kanë mundësinë të zhvillohen profesionalisht falë workshopeve që organizohen me profesorë ndërkombëtarë, konferencave të ndryshme, ligjëratave nga guest lecture", tha ai.

Vlera që e kanë studimet dhe diploma e UBT-së brenda Kosovës, tash e shumë vite i kanë kaluar kufijtë shtetërorë. Falë qindra partneriteteve që institucioni ka me universitetet prestigjioze në botë, diploma e UBT-së njihet ndërkombëtarisht.

Studentja Leartë Mataj punësohet në "Prishtina High School"

Studentja e Fakultetit të Infermierisë, Leartë Mataj është punësuar në shkollën private amerikane "Prishtina High School". Ajo është duke punuar në cilësinë e infermieres së shkollës duke u dhënë studentëve ndihmë psikologjike dhe fizike në mënyrë që studentët të përmirësojnë rezultatet e tyre.

Ajo ka folur për mundësitë që UBT i ka ofruar për të studiuar



dhe për t'u qasur në tregun e punës, aty ku edhe nisi karrierën akademike. Sipas Leartës, UBT i ka dhënë mbështetjen e nevojshme në studime me të gjitha kushtet infrastrukturale e laboratorike, për t'u zhvilluar si infermiere.

"Nga UBT kam përfituar shumë njohuri teorike por sidomos praktike, sepse kam pasur hapësirën e nevojshme nga profesorët, për t'i zhvilluar aftësitë

profesionale në mënyrën më të mirë të mundshme", ka thënë Learta.

Leartë Mataj, ka thënë se UBT dallohet nga cilësia që ofron tek studentët, e nga profesionalizmi që gjatë gjithë kohës e mbanë këtë institucion në nivelet më të larta.

"UBT veçohet me kualitetin arsimor në Kosovë dhe me inovacionet më të përsosura, të cilat na mundësojnë që të jemi

praktik duke aplikuar njohuritë e përfituara nga studimet, si dhe duke na mundësuar zhvillimin edhe në zhvillimin e personalitetit dhe të shprehisë së punës", është shprehur ajo.

Studentët e UBT-së, menjëherë ose gjatë studimeve, fillojnë me punën nëpër institucione të ndryshme, falë punës profesionale të profesorëve, studentëve dhe stafit të UBT-së.

Projekti i profesorit Tafa dhe i studentit Salihu prezantohet në konferencë në Mal të Zi

Profesori në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, prof. Dr. Zhilbert Tafa, së bashku me studentin e nivelit master të UBT-së, Bashkim Salihu, kanë marrë pjesë në konferencën me renome ndërkombëtare në fushën e shkencave kompjuterike dhe elektroteknikës, "IEEE Mediterranean Conference on Embedded Computing". Në edicionin e nëntë të kësaj konference, studenti Salihu e prezantoi online punimin e përbashkët me prof. dr Zhilbert Tafa me titull: "On Computational Performances of the Actual Image Classification Meth-

ods in C# and Python". Kjo konferencë mbahet çdo vit në Mal të Zi, dhe është e indeksuar në databaza prestigjioze si IEEE, Scopus, etj. Në këtë konferencë, edicioneve të kaluara punimi i profesorit Tafa ishte vlerësuar si më i caktuari në punime të ndryshme shkencore dhe libra, si pjesë e literaturës në lëmin e shkencave kompjuterike. Gjithashtu, në mesin e shumë emrave, në Institutin "MECONet", përfshirë edhe fituesve të çmimit Nobel, figuron edhe emri i profesorit Tafa, si anëtar dhe hulumtues i çështjeve teknologjike.

Studentja Saranda Krasniqi punësohet në UBT



Saranda Krasniqi është studentja e radhës e cila është punësuar në UBT. Saranda ka studiuar në Fakultetin Media dhe Komunikim në UBT, ku nga aty ka marr praktikën më të mirë nga ekspertët dhe profesionistët të fushës së gazetarisë. Talenti dhe dëshira e saj për fushën e gazetarisë bëri që ajo

të zgjedhë Median dhe Komunikim në UBT dhe sot ajo të bëhet pjesë e saj. Vlerësimet e larta që ajo kishte marrë nga të tjerët për UBT-në, i kishin ndihmuar asaj që të përzgjedhë institucionin që do t'i ndihmojë asaj në formimin akademik e profesional. "Kam vendosur të studiojë në UBT, pasi kam dëgjuar shumë

nga shoqëria duke e vlerësuar si një institucion të lartë të arsimit, ndër më të mirët në vend, e më pas duke hulumtuar sado pak mbi sukseset që kanë arritur personat në fushën që isha e interesuar", ka thënë Saranda. Ajo tani është punësuar në Radio Campus, ku aty punon në cilësinë e gazetares, teksa është edhe prezantuese e emisionit të mëngjesit "Campus AM". Saranda thotë se UBT i ka ofruar kushtet e nevojshme për të zhvilluar vepërimitarinë e saj në fushën e gazetarisë. "UBT më ka ofruar kushte dhe mundësi shumë të mira për punën praktike si dhe për zhvillimin e teorisë. Pajisjet teknike të kohës së fundit të cilat gjenden në UBT, na kanë dhënë një shtysë tjetër për t'u zhvilluar në fushën e medias", ka thënë ajo.

Studentja Marigona Xhigoli bëhet pjesë e Radio Campus

Tani, radhës së studentëve të punësuar në UBT, i është shtuar edhe studentja Marigona Xhigoli. Menjëherë pasi kishte përfunduar shkollimin e mesëm, Marigona kishte filluar të mendonte e hulumtonte se ku të vazhdonte rrugëtimin e saj akademik. Ajo kishte zgjedhur Fakultetin Media dhe Komunikim në UBT, për të zhvilluar vetën profesionalisht në fushat mediatike, kështu edhe duke tejkaluar pritshmëritë e saj. Marigona, është punësuar në Radio Campus, në cilësinë e gazetares, teksa moderon një emision nga ora 10:30 deri në orën 12:00, ku gjatë kësaj kohe ajo informon publikun rreth fushave të ndryshme, me informacione atraktive dhe intere-

sante. Ajo, zhvillimin profesional ia atribuon UBT-së, pasi që sipas saj, përgjatë tri viteve të studimit UBT i ka ofruar mundësi të shumfishta për t'u zhvilluar në fushën e medias dhe komunikimit, fotografisë, montazhës e marketingut. "Mund të them se e gjitha ajo që jam unë sot në aspektin profesional është falë UBT-së. Kjo sepse falë profesorëve dhe punës praktike përgjatë tri viteve të studimeve, kam arritur të mësoj fillimisht rëndësinë e medias e më pas edhe mënyrën e duhur të të punuarit në media. Programi Media dhe Komunikim në UBT përveç punës në gazetari më ka ndihmuar shumë edhe në aspektin e fotografisë



dhe editimit të saj dhe videove, e edhe në fushën e marketingut", ka theksuar Marigona. Marigona ka vlerësuar lartë ndërlidhjen e punës praktike

me atë teorike që e ka hasur në këtë institucion, si dhe përkushtimin e madh të profesorëve që kanë ndaj të gjithë studentëve pa dallim.

"Ajo që i bënë të veçanta studimet në UBT është ndërlidhja e punës praktike me pjesën teorike. Përkushtimi i profesorëve dhe gatishmëria që ata kanë çdo herë për studentët e bënë këtë institucion të veçantë dhe të pazëvendësueshëm", ka përfunduar ajo. Fakulteti Media dhe Komunikim në UBT, është fakulteti më i kompletuar në vend, pasi ka të integruar të gjitha elementet e gazetarisë në një program të vetëm, gjë që e bën unik si fushë studimi, ndaj edhe sukseset e studentëve të këtij programi janë të shumta, marr parasysh kuadron profesionale që del nga ky fakultet.

Hulumtimi shkencor i profesorit Jajaga dhe studentit Kaçiu publikohet në Francë



Profesori i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri i nivelit master prof.dr. Edmond Jajaga, në bashkëpunim me studentin e nivelit master të UBT-së, Arian Kaçiu, ka marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare "CLOUD COMPUTING 2020, The Eleventh International Conference on Cloud Computing, GRIDs, and Virtualization", që është mbajtur në Nice të Francës. Në edicionin e njëmbëdhjetë të kësaj konference, studenti Kaçiu e prezantoi online studimin e përbashkët me profesorin, Edmond Jajaga, me titull "Migration of Data and Applica-

tions in the Cloud". Rëndësia e kësaj konference të përvitshme është e madhe, pasi që tërheqë një audiencë të madhe globale, që ngjallin diskutime të shumta rreth informatikës e shkencave kompjuterike, duke mbledhur studiues, inxhinierë, akademikë, politikëbërës e të targetuar të tjerë. Profesorët dhe studentët e UBT-së vazhdimisht bëjnë publikime shkencore në konferenca të ndryshme, duke dhënë kontribut të madh në zhvillimin e shkencës, jo vetëm në vendin tonë por edhe më gjerë.

Përgjatë një semestri, mbi 10 studentë të Medias dhe Komunikimit sistemohen në tregun e punës



Shtatë gjenerata kanë dalë në tregun e punës në fushën e Gazetarisë, Medias dhe Komunikimit në UBT, të cilët paraprakisht u aftësuan profesionalisht në laboratorët dhe morën njohu-

ri teorike e praktike nga profesionistët të shquar nga vendi dhe rajoni. Vetëm përgjatë semestrit të fundit, mbi 10 studentë janë të punësuar nëpër media të ndryshme prestigjioze vendore.

Studentët dhe ish-studentët e këtij fakultetit, nëpër vendet e tyre të punës e të praktikës, po i shpalosin njohuritë dhe kompetencat e tyre si gazetarë, fotografë, kameramanë, montazherë, zyrtarë për informim dhe zyrtarë të PR-it. Nisur nga statistikat e regjistrimit të vit pas viti studentët e Fakultetit Media dhe Komunikim kanë arritur që të tregojnë rezultate në studime si dhe në gjetjen e tyre pas diplomimit. 90% e studentëve të gazetarisë janë të punësuar dhe po e dëshmojnë suksesin në tregun e punës.

Studenti i UBT-së, Fatbardh Kabashi do të përfaqësojë Kosovën në garën e BE-së

Studenti i Fakultetit Dizajn i Integruar në UBT, Fatbardh Kabashi synon të bëhet ambasador i ri i Evropës, falë nismës së BE-së për të bashkuar të rinjtë nga Evropa në garën "Become a Young European Ambassador". Gara ka mbledhur kandidatë nga 6 vende të Ballkanit, teksa Fatbardhi do të përfaqësojë Kosovën me qëllim të kontribuoj që zëri i të rinjve vendas të dëgjohet nga vendet e Evropës. Fatbardhi theksoi se pjesë

e garës do të jenë rreth 30 kandidatë, ndërkaq do të përzgjidhen 30 ambasadorë dhe 30 atashe, ku nëpërmjet kësaj nisme të përfaqësohen vlerat e Bashkimit Evropian, si dhe promovohen mundësitë që ofron Bashkimi Evropian. "Përzgjedhja e ambasadorëve do të bëhet nga numri i votave, pra është një numër i kufizuar, por për ta parë edhe Kosovën të përfaqësuar në mënyrë sa më të fuqishme, nevojitet përkrah-

ja me numër sa më të madh të votave", tha studenti i UBT-së, Fatbardh Kabashi. Stafit dhe studentët që duan të kontribuojnë që Fatbardhi të përfaqësojë Kosovën në BE, votimi bëhet online, në www.webalkans.eu/voting/fatbardh-kabashi/, duhet të regjistroheni me e-mail, më pas bëhet verifikimi me anë të e-mail, teksa në fund përzgjidhet kandidati për t'u votuar.

Studentja Edona Sulejmani punësohet në Radio Campus



Gazetaria është një prej fushave që studentja Edona Sulejmani kishte zgjedhur të vazhdonte rrugëtimin e saj akademik. Dëshira për të punuar në media bëri që ajo të zgjedhë Fakultetin Media dhe Komunikim në UBT, ku edhe u pasurua me njohuritë dhe përvojën e duhur për të vazhduar rrugëtimin profesional në karrierën e saj.

Edona, është punësuar si gazetare në Radio Campus në UBT, ku është duke informuar publikun me më të rejtat e fundit nga fusha e teknologjisë e shkencës, e duke mbajtur shoqërinë aktive me informacione nga këto fusha.

Ajo ka theksuar se UBT i ka ofruar të gjitha kushtet e nevojshme për të studiuar në fushën e medias, duke i ofruar në dispozicion të gjitha pajisjet e nevojshme për të zhvilluar aktivitetin e saj gjatë periudhës së studimeve.

“Përveç ligjërimit korrekt dhe të pazëvendësueshëm nga profesorët e UBT-së, UBT më ka ofruar edhe kushte për studime të mirëfillta, që më kanë lehtësuar punën praktike e teorike”, ka thënë Edona.

Ajo ka shtuar se UBT është institucion ku njihet profesionalizmi dhe vlerësohet puna dhe angazhimi i secilit student, ndaj

edhe kjo e ka bërë më të lehtë zgjedhjen e duhur për studimet akademike.

“Veçantia e studimeve në UBT qëndron tek profesionalizmi dhe rëndësia që u kushtohet studentëve të këtij institucioni, ndaj edhe zgjedhja ishte e lehtë për të studiuar në Media dhe Komunikim”, ka potencuar ajo.

Fakulteti Media dhe Komunikim në UBT, vazhdon të nxjerrë kuadër profesionale për fushën e medias, dhe si i tillë është duke kontribuar në zhvillimin profesional të fushës së medias dhe komunikimit.

Studenti Edonit Behluli punësohet në Media Group-in e UBT-së


Pasioni për profesionin e gazetarisë ka bërë që Edonit Behluli dy vite më parë të fillojë studimet në Fakultetin Media dhe Komunikim në UBT, ku falë përfitimit të kompetencave profesionale është sistemuar edhe në tregun e punës.

Edoniti tashmë është punësuar në Media Group-in e UBT-së, dhe po ndihmon në fuqizimin e imazhit kombëtar dhe ndërkombëtar të institucionit, përmes lajmeve, marketingut, mediave sociale, si dhe aktiviteteve të tjera.

Ai theksoi se studimet në UBT i mundësuan përgatitje për karrierë të suksesshme. Këtë sukses Edoniti ia atribuon Fakultetit Media dhe Komunikim, ngaqë siç tha, është program i harmonizuar në atë mënyrë sa që

kombinon ligjëratat teorike me praktikë, organizon aktivitete me partnerë medial, vizita studimore brenda dhe jashtë vendit në mediat më të njohura.

“Interesimi për gazetarinë dhe median në përgjithësi, ka bërë që unë të kërkoja një program studimi më ndryshe, më të përgjithësuar, që mua në tregun e punës të mos më kualifikonte si gazetar. Media dhe Komunikim në UBT ishte programi më i mirë që mua më mundësoj të ecë përpara. UBT më ka hapur të gjitha dyert për t’u zhvilluar profesionalisht në karrierë, për të marrë përvojën e duhur në fushën e medias e komunikimit, dhe duke më mundësuar që të punoj me profesionistët më të mirë të kësaj fushe, me teknologjinë më të re”, potencoi Edoniti.



Tutje, ai tha se programi i studimit Media dhe Komunikim në UBT u ofron studentëve përgatitje praktike për karrierë të suksesshme mediale, i vetmi fakultet që u mundëson

studentëve edhe specializimin në fushat si: gazetari, komunikim, menaxhim i medias, marrëdhënie me publikun, regji televizive, gazetari on-line, kamerë dhe fotografi.

“Praktika dhe teoria i bën të

veçanta studimet në UBT. Është më se e nevojshme që studentët të kenë mundësi atë që e mësojnë edhe ta praktikojnë, ta ndjejnë, ta shohin për së afërmi, sepse vetëm kështu studentët janë gati për të filluar karrierën e tyre, andaj unë mendoj që kjo është formula e suksesit në UBT”, shtoi ai.

Në këtë program studimi, këtë vit është bashkëngjitur edhe trendi i fundit i teknologjisë, ku studentët do të mësojnë përmes Realitetit Virtual, mësim që zhvillohet dhe shfaqet përmes syzeve 3D. Përveç kësaj, UBT posedon edhe Televizionin, Radion, Portalin dhe Gazetën, në kuadër të së cilave studentët zhvillojnë punën praktike me qëllim të zbatimit të teorisë në praktikë.

Studentët e Fakultetit Media dhe Komunikim punësohen menjëherë pas përfundimit të studimeve



Njomza Maxhuni është njëra nga shumë studentë të Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT,

të cilët menjëherë pas përfundimit të studimeve bëhen pjesë e stafit nëpër media të ndryshme si gazetarë, moderatorë, realizatorë programesh, kameramanë, teknik regjie, montazherë, zyrtarë për marrëdhënie me publikun, zyrtarë për informim, etj.

Njomza tani është e punësuar në Radio Vicianum, në cilësinë e moderatores së emisionit, “Online Mesdita”.

Ajo theksoi se arma e saj më e fortë si studente ishte zëri, e cila me ndihmën e profesorëve dhe përmes punës praktike në UBT, arriti ato ta përkeqësojë dhe karrierën ta fokusoj në këtë drejtim.

“UBT ka ndikuar jashtëzakonisht pozitiv në jetën dhe në karrierën time. Me programin të cilin e ofron institucioni dhe me punën e palodhshme të profesorëve,

ka qenë shumë më e lehtë për mua t’i kaloj sfidat profesionale”, theksoi ajo.

Njomza shtoi se UBT ofron të gjitha kapacitetet për zhvillimin studentor dhe ndërtimin e bazës profesionale për një të ardhme profesionale dhe karrierë të suksesshme.

“Jam shumë falënderuese që kam mësuar nga përvoja të shumta të profesorëve dhe të asistentëve, të cilët pa hezitim kanë punuar për të shpërndarë njohuritë e tyre të frytshme. Përmes laboratorëve dhe pajisjeve që i posedon ky fakultet studentët e gazetarisë kanë mundësi të fitojnë njohuri të thelluara në anën praktike, teorike si dhe teknike”, tha ish-studentja e Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, Njomza Maxhuni.

Studentja e Medias dhe Komunikimit punësohet në emisionin Oxygen Show



Studentja e vitit të tretë të Fakultetit Media dhe Komunikim, Enisa Puka ka filluar punën në emisionin Oxygen Show, që transmetohet në Klan Kosova. Aktualisht ajo po punon si gazetare e emisionit Oxygen dhe portalit Oxygen Press, duke i mbuluar ngjarjet ditore nga fusha të ndryshme.

Enisa theksoi se UBT i ka ndihmuar të përvetësojë njohuritë teorike dhe aftësi praktike në fushën e gazetarisë, njohuri të cilat tashmë po i shërbejnë në punën e përditshme.

“Programi i studimit në UBT ka qenë një ndihmë shumë e madhe dhe një shtysë që unë të fitoj njohuritë e nevojshme dhe të qasem lehtë në tregun e punës. Elita e profesorëve të kualitetit

të lartë dhe ekspertë të fushës së gazetarisë, më ka ndihmuar jashtëzakonisht shumë që të marrë hapat e duhur në këtë profesion sfidues”, është shprehur studentja, Enisa Puka.

Enisa, vitin e kaluar ishte moderatore e emisionit “YouthTalk”, emision i emetuar në radio Gjakova dhe Tv Syri Vision, realizuar në kuadër të projektit “Të rinjtë për të rinjtë” dhe financuar nga USAID.

98% e studentëve të Fakultetit Media dhe Komunikim janë punësuar në institucione shtetërore, publike dhe private, që e dëshmon kualitetin dhe profesionalizmin që ofron ky program.

Studentja e UBT-së, Diellza Azemi është punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë

Diellza Azemi është studente e nivelit master në Fakultetin Shkenca Ushqimore dhe Bioteknologji, e cila tashmë është punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë.

Ajo zhvillon punën profesionale si inspektore sanitare, teksa theksoi se njohuritë dhe praktikat e marra gjatë studimeve në UBT po i ndihmojnë në ushtrimin e detyrës.

“Pasioni për studimin e Shkencave Ushqimore dhe



Bioteknologjisë më bëri të zgjedh UBT-në për rrugëtimin tim të së ardhmes, dhe tani jam shumë e lumtur për sukseset e arritura” ka thënë ajo.

Djellza ishte edhe studente e nivelit bachelor në Fakultetin Shkenca Ushqimore dhe Bioteknologji në UBT, ku është specializuar në Menaxhim të Cilësisë dhe Sigurisë Ushqimore.

Ulpiana Emra punësohet në Artmotion



Studentja e Fakultetit Media dhe Komunikim, Ulpiana Emra, është pjesë e Artmotion, në emisionin ASIST, në cilësinë e moderatores,

gazetares dhe komentatores të sportit.

Ulpiana theksoi se studimet, kurrikula, puna praktike dhe puna profesionale e profesorëve i kanë ndihmuar shumë në zhvillimin e karrierës së saj dhe është e gatshme të punojë në secilën sferë të gazetarisë.

“Për mendimin tim UBT është një institucion arsimor që të ndihmon të zhvillohesh në aspektin profesional në mënyrë më të mirë të mundshme”, potencoi ajo.

Fakulteti i Medias dhe i Komunikimit, në UBT vazhdon të sistemojë në treg profesionistë, që janë entuziastë dhe të suksesshëm për punën që e bëjnë.

Studenti Endrit Luri vazhdon studimet e nivelit master në Bauhaus, Dessau



Falë bashkëpunimit që ka UBT me Universitetin e Bauhaus në Dessau, studenti i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Endrit Luri, është pranuar për studimet e nivelit master.

“Loja e ritmit, dritës, hijes, harmonisë, planifikimit u mishëruan

në mua që nga fillimi dhe t’i ekuilibrosh të gjitha këto është kreativitet. U provokova në këtë drejtim dhe rrugën e UBT-së, e gjeta me orientim nga familja ime ku edhe këtë profesion e kam trashëguar nga ata”, theksoi Endriti.

Ai është njëri nga shumë studentët e UBT-së, i cili falë an-

gazhimit dhe suksesit të treguar përgjatë studimeve përfitoi mundësinë për vazhdim të studimeve jashtë vendit.

“Një semestër në Bauhaus-in e njohur, vërtetë është një rast i shkëlqyer për të parë dhe për tu ballafaquar me arkitekturën e njohur në botë. Falë angazhimit dhe suksesit të treguar kam hasur në një mirëkuptim dhe mbështetje në stafin menaxhues të Bauhausit, ku më pas bëra dhe aplikimin për të vazhduar në programin master”, potencoi Endriti. Duke e falënderuar stafin e fakultetit për përkrahjen dhe bashkëpunimin e ngushtë, ai tani e fitoi mundësinë për ta vazhduar rrugëtimin e tij në njërin nga universitetet më prestigjioze në botë në fushën e arkitekturës.

Ish-studentja Saranda Fazliu punësohet në konsullatën e Kosovës në Gjermani



Ish-studentja e Fakultetit Shkencat Politike në UBT, Saranda Fazliu, është punësuar në konsullatën e

përgjithshme të Kosovës në Düsseldorf të Gjermanisë. Saranda, fillimisht falë njohurive

të fituara nga profesorët dhe studimet në UBT, ajo rrugëtimin profesional e kishte filluar si praktikante në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës.

Ajo tashmë po vazhdon studimet në nivelin master në UBT, në Fakultetin Politika Publike dhe Menaxhim, teksa ka falënderuar UBT-në për profesionalizmin e vazhdueshëm dhe mundësitë që ajo po i ofron studentëve të saj.

Rreth 95% të studentëve në UBT, punësohen menjëherë pas përfundimit të studimeve ose edhe gjatë zhvillimit të tyre akademik.

Studenti Ermal Ferati zë vendin e parë në garën e programimit

Janë shpallur fituesit e garës së dytë të programimit që ishte mbajtur në kuadër të “Global UBT Fest 2020”, me ç’rast në vendin e parë është renditur studenti i Fakultetit Shkencat Kompjuterike në UBT, Ermal Ferati.

Tutje, në vendin e dytë është renditur studentja e Fakultetit Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Jehona

Konushefci, teksa në vendin e tretë është renditur Bardh Mehmeti, student i Universitetit të Prishtinës.

Në këtë garë, garuesit kanë përdorur shkathtësitë dhe njohuritë e tyre në fushën e programimit, duke shfrytëzuar algoritme dhe teknika të ndryshme për zgjidhjen e problemeve në këtë fushë.

Studentët e Shkencave Politike në UBT do të vazhdojnë studimet në Salzburg të Austrisë



Studentët e vitit të dytë të Fakultetit Shkencat Politike në UBT, Dafina Aliu, Suana Selmani dhe Bardh Hoxha, kanë arritur që të fitojnë bursa studimi që studimet e tyre akademike t’i vazhdojnë në Fakultetin e Shkencave Politike në Salzburg të Austrisë.

Studentët ndjehen të lumtur që vitin e tretë akademik do ta vazhdojnë në Austri, dhe u shprehën

të lumtur për faktin se UBT u ka siguruar mbështetje maksimale e profesionale në rrugëtimin e tyre akademik.

Të gjitha këto suksese vijnë si rezultat i punës së palodhshme të studentëve dhe profesorëve profesionistë të UBT-së, si dhe bashkëpunimeve që UBT ka me universitete të mëdha prestigjioze në botë.

Ish-studenti i UBT-së, Lum Sadiku pranohet në universitetin Northern Illinois University të SHBA-ve



Ish-studenti i Inxhinierisë së Energjisë në UBT, Lum Sadiku, është pranuar në universitetin Northern Illinois University – MBA, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai u pranua menjëherë pas përfundimit të nivelit bachelor në UBT, dhe do të vazhdojë studimet akademike në nivelin master në këtë universitet.

Ai madje, gjatë këtij viti ishte

bashkautor në një rast studimi, në Technical University of Berlin, me temën “Construction and Demolition Waste in Kosovo”, bashkë me 28 studentët më të mirë të këtij universiteti, studim ky që ishte në bashkëpunim me GiZ’in dhe ambasadën gjermane. Ky studim është i pari i këtij lloji në Kosovë dhe do të përdoret si bazë për studimet dhe kalkulimet e radhës,

nga personat e tjerë që dëshirojnë të studiojnë rreth temës: “Waste Management”, në Kosovë dhe më gjerë.

Lumi ka falënderuar të gjithë stafin profesional të UBT-së, për përkrahjen dhe korrektësinë që ata kishin në rrugëtimin e tij profesional e akademik. Ai është i lumtur që do të vazhdojë studimet në një prej universiteteve më të njohura në botë.

“I jam falënderues gjithë stafit të UBT-së, pasi që kanë qenë 3 vite studimi shumë të mira dhe efektive, marrë parasysh korrektësinë dhe profesionalizmin që profesorët dhe stafi akademik kanë treguar. Falë UBT-së dhe shtrirjes ndërkombëtare të saj, unë nuk kam hasur në ndonjë problem me njohur e diplomës.”, ka thënë Lum Sadiku.

UBT, edhe njëherë dëshmon se diploma e saj është e njohur ndërkombëtarisht, falë partneriteteve që ajo ka me universitetet më prestigjioze në botë.

Studentja Ariana Lushi përfitoi bursë për studime në National University of Public Service

UBT që nga themelimi ka mbështetur jetësimin e ëndrrës së studentëve për vazhdimin e studimeve në universitetet më të mira dhe më të njohura në botë, si rezultat ka arritur të nënshkruaj 450

marrëveshje bashkëpunimi me universitete prestigjioze. Nga mundësitë unike që i ofron UBT, ka përfituar studentja e Fakultetit Shkencat Politike, Ariana Lushi. Ajo përfitoi bursë studimi për

të vazhduar semestrin veror në universitetin shtetëror “National University of Public Service”, në Budapest. “Kjo është një mundësi shumë e mirë e ofruar nga UBT. Ka qenë përvojë e jashtëza-

konshme, mbi gjitha kam përfituar njohuri profesionale, praktikë, njëherësh jam njohur edhe me kultura të reja”, tregoi ajo. Deri më sot, qindra studentë të UBT-së janë pranuar dhe

kanë vijuar studimet nëpër universitetet më prestigjioze ndërkombëtare, prej ku po kthehen me kompetenca të larta dhe me dëshirë të madhe për të dhënë kontribut për Kosovën.

Fitim Tasholli punësohet në kompaninë "Premium Brot GmbH", në Gjermani

Ish-studenti i drejtimit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, Fitim Tasholli është punësuar në kompaninë Premium Brot GmbH, në Gjermani, si asistent në menaxhimin e prodhimit. Me eksperiencën e fituar gjatë studimeve në UBT, Fitimi ashtu si edhe shumë studentë të tjerë, ka arritur që shumë shpejt të depërtojë në tregun e punës, falë njohurive të përfituara nga profesionistë e ekspertë të fushës. Ai ka falënderuar UBT-në për profesionalizmin e treguar dhe përkushtimin që ky in-



stitucion ka për studentët e saj, në mënyrë që ata të arrijnë suksese në ëndrrat e tyre

përgjatë karrierës profesionale.

"Si rezultat i eksperiencës së fituar gjatë studimeve në UBT, falë stafit akademik dhe profesorëve profesionistë, vendor e ndërkombëtarë, kam arritur që të depërtojë në tregun gjerman të punës," ka thënë Tasholli.

UBT vazhdon të jetë e përkushtuar në sjelljen e kadrove profesionale dhe të përgatitur për tregun e punës, duke iu ofruar të gjitha mundësitë për të zhvilluar punën praktike, për secilën fushë.

Edin Pula përfitoi bursë për shkëmbim semestral në Universitetin e Hungarisë



UBT i ka mundësuar shkëmbim semestral studentit të Shkencave Politike, Edin Pula, në universitetin shtetëror për shërbime publike, në Budapest të Hungarisë, saktësisht në National University of Public Service.

Edini falë bursës së fituar vazhdoi studimet në këtë universitet për një semestër, ëndërr kjo e kamotshme e tij për të qenë pjesë e një universiteti të njohur në botë. Pas përfundimit të semestrit,

ai është kthyer në Kosovë me dëshirën më të madhe për të dhënë kontribut si rezultat i kompetencave të larta, përvojë që tashmë synon ta ndajë në vendin e tij.

UBT ka partneritet dhe bashkëpunim me rreth 500 universitete dhe institucione të shquara në botë, falë së cilave bëhet shkëmbimi i studentëve, stafit akademik, si dhe ka krijuar bashkëpunim në aspektin shkencor dhe teknik, vizita studimore, etj.

Studenti Fatbardh Kabashi, zgjidhet ambasador i ri i Evropës në garën "Become a Young European Ambassador"



Studenti i Fakultetit Dizajn i Integruar në UBT, Fatbardh Kabashi është zgjedhur ambasador i ri i Evropës për tri vitet e ardhshme, në nismën që Bashkimi Evropian mori për të bashkuar të rinjtë nga Evropa në garën "Become a Young European Ambassador".

Pjesë e garës ishin rreth 300 kandidatë nga 6 vende të Ballkanit, ku prej tyre u zgjodhën 30 ambasadorë, në mesin e tyre edhe student i UBT-së, Fatbardh Kabashi, i cili do të përfaqësojë Kosovën, me qëllim që zëri i të rinjve kosovarë të dëgjohet në vendet e Evropës.

Kabashi ka falënderuar të gjithë ata që e kanë përkrahur në veçanti UBT-në për

mbështetjen që i ka dhënë rrugëtimin e tij profesional. "Falënderoj UBT që gjithmonë më ka dhënë mbështetjen e pakursyeshme, mua dhe secilit student, në rrugëtimin akademik, në përpjekjen për të arritur sukseset që kam synuar. Do mundohem që të jem zëri i të gjithë të rinjve të Kosovës për shqetësimet, kërkesat dhe interesat që ne si rini kemi," ka thënë Kabashi.

Studentët e UBT-së vazhdimisht janë duke treguar suksese në fusha të ndryshme, duke dëshmuar përkushtimin dhe profesionalizmin që UBT ka në rrugën për të nxjerrë ekspertë dhe kadro profesionale.

Kosova pranohet në kompaninë Apple, falë kontributit të studentit Emin Emini

Kosova ka fituar pavarësinë që nga viti 2008, por deri më tani nuk paraqitej si shtet në Apple Maps, gjë që ka shtyrë Emin Emini të ndërmarrë një iniciativë dhe të filloi komunikimin me këtë kompani, me qëllim që edhe vendi ynë të figuronte në këtë aplikacion.

Emin Emini është student i Fakultetit Shkenca Kompjuterike në UBT, i cili rreth pesë vite më parë filloi komunikimin zyrtar përmes email-it me Apple, e më pas edhe me kompaninë furnizuese me maps në Apple, Tom Tom.

"Gjithçka ka filluar në vitin 2015, ku Kosova nuk figuronte askund në kompaninë Apple. Në atë kohë, kam dashtë të kyçem si zhvillues i aplikacioneve (app developer) në këtë kompani. Por, fatkeqësisht, ka qenë e vështirë të kyçem sepse Kosova nuk konfiguronte dhe nuk njihet nga Apple, dhe është dashtë të futem me llogari si qytetar i Shqipërisë", tregoi student i Emini.

Pas insistimit të vazhdueshëm të Emini, që Kosova të futej në hartën e shteteve

në Apple Maps, kjo kërkesë u pranua tek në vitin 2020, pasi kompania Tom Tom pranoi që shteti ynë të shtohet në këtë aplikacion.

"Nga ajo kohë, vazhdimisht kam dërguar kërkesa kompaninë Apple për ta shtuar vendin në numrin thirrës, App Store, në hartë Apple Maps, si dhe shumë të tjera. Dhe fatmirësisht në fund të vitit 2019, fillimisht kërkesa për App Store ishte pranuar. Fatmirësisht, jemi bashku të gjithë dhe kemi mbushur peticionin për të futur vendin në këtë kompani, të cilin e shkruajtën mbi 70 mijë persona, dhe si përfundim Kosova është pranuar në Tom Tom, me shpresën që edhe në Apple Maps", potencoi ai.

Emin Emini, student i Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, ishte njëri nga studentët përfitues të bursës për vazhdim të studimeve në Universitetin "Nova de Lisboa", nga Portugalia. Ai ishte përzgjedhur përfitues i bursës në bazë të notës mesatare mbi 9.0, që e ka arritur gjatë studimeve në UBT.

Studentja e Shkencave Kompjuterike, Besa Belegu themelon kompaninë "KRIJO"



Studentja e Fakultetit Shkenca Kompjuterike në UBT, Besa Belegu, ka themeluar kompaninë "KRIJO" platformë

online që ofron shërbime për krijimin e një biznesi të ri, krijimin e web-faqeve, brendimi i bizneseve, e-commerce, mar-

keting digjital, transformim digjital të bizneseve, si dhe dizajnin e produkteve.

Besa ka fituar grantin Start-up, përmes projektit "Mundësitë e grave në treg, ekonomi dhe rrjetëzim", i cili implementohet nga Kosova Women 4 Women, teksa financohet nga qeveria gjermane në kuadër të GIZ Kosova.

Platforma "KRIJO", që e krijoi studentja e UBT-së, Besa Belegu, ofron shërbime me kosto minimale kohore dhe ekonomike për gjithë ata që synojnë të hapin biznese të reja, njëherësh edhe për ata që aktualisht kanë biznes.

Studentja Danijella Pera e punësuar në studion e dizajnit "Dekorit"



Danijella Pera është studente e Fakultetit Dizajn i Integruar në UBT, saktësisht është duke specializuar për Dizajn të Brendshëm, e cila tashmë

është punësuar në studion e dizajnit "Dekorit".

Ajo tha se njohuritë e përfituara nga studimet po i shërbejnë në punën si dizajnere, teksa u shpreh falënderuese ndaj UBT-së, si dhe profesorëve të këtij drejtimi për përkushtimin në aspektin akademik.

"Përveç që jam e angazhuar në studion e dizajnit "Dekorit", kam pasur dhe disa projekte të ndryshme private. Vlen të theksohet se palët janë ndarë shumë të kënaqur me punën dhe detajet, njohuri që i përfitova pikërisht në institucionin e lartë arsimor,

në UBT. I jam mirënjohëse institucionit dhe falënderuese për dijen që kam marrë falë angazhimit të stafit dhe profesorëve në UBT", theksoi studentja Danijella, duke shtuar se "e veçanta e UBT-së është se i shndërron të rinjtë tanë në profesionistë për tregun vendor dhe ndërkombëtar".

Fakulteti i Dizajnit të Integruar është fakulteti i parë në Kosovë dhe rajon që i aplikon dhe integron në sistemin akademik teknologjitë e Realitetit Virtual (Virtual Reality) dhe Realitetit të Shtuar (Augmented Reality).

Ambasadori Kryeziu takoi studentët e UBT-së që përfunduan studimet me bursa në Portugali

Ambasadori i Kosovës në Portugali, Ylber Kryeziu ka pritur në takim studentët e UBT-së që ishin përfitues të bursës për vazhdim të studimeve në Universitetin "Nova de Lisboa", në Portugali.

Studentët e UBT-së, Emin Emiri, Egzon Hasi, Lumbardh Elshani dhe Behar Haxhismajli, si dhe studentë të tjerë, ishin pjesë e universitete prestigjioze në Portugali, ku tashmë po kthehen në Kosovë me njohuri dhe përvoja të reja.

Ambasadori Kryeziu, përmes një postimi në facebook, falënderoi studentët e UBT-së që përfaqësuan imazhin e Kosovës, teksa theksoi se ata



përfunduan studimet me nota të larta. "Pasi kryen studimet me nota të larta dhe përfaqë-

suan imazhin e vërtetë të Kosovës në universitete elitare në Portugali, një grup i

dytë me studentë po riatdhe-sohet sot në Kosovë. Suksese djema, rrugë të mbarë dhe

faleminderit për miqësinë! #meStudentët", ka shkruar ambasadori Kryeziu.

UBT vazhdon të jetë institucioni i parë i arsimit të lartë në Kosovë për nga numri i partneriteteve ndërkombëtare. Institucioni numëron mbi 450 marrëveshje bashkëpunimi me universitete prestigjioze dhe institucione ndërkombëtare, përmes të cilave studentët e UBT-së përjetojnë ndjenjën e të qenit pjesë e universiteteve më të njohura botërore, karshi studentëve nga e tërë bota.

Studenti i UBT-së, Orhan Hajrullahi, inxhinier në kompaninë prestigjioze "Alba Group"



Fakulteti Inxhinieri e Ndërtimit në UBT hyn në mesin e programeve të mësimi që është i bazuar me standarde dhe vlera evropiane, program falë të cilit studentët ngritën profesionalisht dhe pozicionohen fuqishëm në

tregun e vendor e ndërkombëtar të punës.

Gjeneratë pas gjenerate, studentët e UBT-së po punësohen në kompanitë më të mëdha e më të suksesshme, të cilët po i praktikojnë aftësitë e tyre profesionale në gjitha fushat e ndërtimit.

Një nga qindra këta studentë, është edhe Orhan Hajrullahi, tashmë inxhinier në kompaninë prestigjioze të ndërtimit "Alba Group".

Orhani potencoi që puna praktike dhe vizitat e shumta në terren të realizuara gjatë viteve akademike, i kanë ndihmuar shumë në aspektin profesional.

"Në UBT kam gjetur një ambient shumë miqësor studimi, me profesorë që nxisin

diskutimet gjatë ligjëratave dhe që stimulojnë mendimin kritik. Metodologjia moderne e ligjërimit, shoqëruar me pamje në projektor, përdorimi i programeve softuerike si: Autocad, Etabs e të ngjeshëm, si dhe puna praktike dhe vizitat studimore në terren më kanë ndihmuar jashtëzakonisht për ngritje profesionale. I jam mirënjohës UBT-së, që falë punës praktike, tash që jam edhe i punësuar nuk kam ndonjë pengesë në punë", tha ai. Fakulteti Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturë, që nga themelimi ofron edukim profesional në gjitha specializimet, derisa, programi ka për qëllim që të diplomojë ekspertë të kësaj lëmie.

Ish-studentja Alma Memeti vazhdon studimet në universitetin prestigjioz të Zagrebit



Alma Memeti, është një ndër shumë studentët e Fakultetit të Juridikut të cilët po përfitojnë nga studimet në UBT. Pas studimeve bachelor dhe master në UBT, ajo po vazhdon specializimin në Universitetin e Zagrebit, saktësisht në drejtimin "Prava drustava i trgo-

vacka prava".

Ajo theksoi se diploma e UBT-së është e njohur ndërkombëtarisht, prandaj tha se pa hezitim bëri zgjedhjen e duhur që i ka besuar UBT-së formimin e saj si juriste.

"Gjatë studimeve në UBT kam përfituar njohuri të cilat më kanë ndihmuar që të përgatitem profesionalisht. Aktualisht jam pjesë e Universitetit prestigjioz të Zagrebit, ku kam vazhduar studimet për të specializuar në profesionin tim", theksoi ajo.


UBT e ofron programin Juridik me standardet e larta të studimit, institucioni mbështetë studentët në sfidat e të mësuarit, përmes përvojave dhe praktikave për zbatimin e ligjit në jetën reale.

Studentja Lularta Buja punësohet në agjencinë e lajmeve KosovaLive

Studentja e Fakultetit Media dhe Komunikim, Lularta Buja, ka nisur punën në cilësinë e gazetares dhe e koordinatorës së trajnimeve në agjencinë e lajmeve KosovaLive.

Ajo aktualisht po merret edhe me asistimin e projekteve të organizuar në kuadër të kësaj agjencie si dhe është përfaqësuese e projektit GlobalGirl Media Kosova (GGMK).

Duke folur për përvojën rreth studimeve, Lularta theksoi se njohuritë që i ka fituar dhe puna praktike që e ka realizuar me profesorët dhe asis-



tentët e këtij fakulteti kanë qenë shumë efektive dhe kanë shërbyer që të jetë e përgati-

tur për tregun e punës.

"Arsyeja pse unë jam në UBT, e tregon më së miri se çfarë mendimi kam për UBT-në, jam shumë e lumtur që marr shembull nga shembujt", theksoi ajo.

Nisur nga statistikat e regjistrimit të vit pas viti studentët e Fakultetit Media dhe Komunikim kanë arritur që të tregojnë rezultate në studime si dhe në gjetjen e tyre pas diplomimit. 90% e studentëve të gazetarisë janë të punësuar dhe po e dëshmojnë suksesin në tregun e punës.

Diploma e UBT-së e njohur ndërkombëtarisht, hap rrugë për punësim në kompani prestigjioze jashtë vendit

Ish-studenti i UBT-së në Fakultetin Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, Ermal Krasniqi, është punësuar në kompaninë Heggelund og Koxvold në Oslo, në cilësinë e arkitektit.

Ai aktualisht po i përgatit skicimet e projekteve deri tek planet zbatuese dhe dorëzimet finale.

Ermali potencoi se është inspiruar nga sukcesi i shumë studentëve të UBT-së, falë përgatitjes së tyre profesio-

nale që e kanë fituar në këtë institucion.

"Përshtypjet e mia për UBT-në janë shumë pozitive me që sukcesi është i dukshëm jo vetëm në Kosovë por edhe jashtë kufijve", theksoi ai.

UBT po përgatit quadro profesionale për tregun e punës, ku çdo vit dalin qindra studentë të diplomuar dhe mbi 90% të tyre gjejnë vende punë si arkitektë në Kosovë dhe jashtë.

Studentja Meral Çukiqi, dizajnere grafike dhe zhvillon brendingun e kompanive të reja

Sistem i integruar i mësimi të fushave të dizajnit, sikur dizajni grafik, ai i enterierit, dizajni i produktit, dhe modës, e kanë shndërruar studenten e Fakultetit Dizajni i Integruar në UBT, Meral Çukiqi, në konkurrence të fortë në tregun e punës dhe profesioniste të kësaj fushe.



Merali tashmë po u ofron ekspertizat profesionale dhe zhvillon brendingun e kompanive të reja për në botën e tregtisë, teksa po u ndihmon edhe për dizajne që përdoren nga kompanitë në rrjetet sociale.

Ajo tha se UBT i ofroi mundësinë e studimeve

cilësore, studime që barasvlerësohen në nivel ndërkombëtar.

"UBT, saktësisht drejtimi Dizajni i Integruar më mundësoi të njoh gjitha fushat e dizajnit, njëherësh më përgatiti për atë që jam tani, dizajnere grafike", theksoi studentja Meral Çukiqi.

Dizajni i Integruar është program nga i cili të diplomuarit fitojnë njohuri dhe kompetenca në art dhe dizajn, mendim kritik, struktura dhe materiale, teknologji informative, realitet virtual/shtuar (VR/AR), teori dhe kritikë arti dhe dizajni, punë ekipore dhe shkenca shoqërore.

Studenti i Mekatronikës, Mustafë Abazi, i angazhuar në kompaninë e njohur "Formon"



Studenti i Fakultetit të Mekatronikës në UBT, Mustafë Abazi është angazhuar në pozitën e teknikut të monti-

mit në kompaninë e njohur "Formon".

Ai bën montimin e printerëve 3D, si dhe merret me strukturën e epërme, me lidhjen e qarqeve elektrike, por edhe me testimin final të printerëve.

Studenti Abazi tha se është zhvilluar profesionalisht në UBT, ndërkohë lehtësisht është qasur edhe në tregun e punës.

"Që nga vitet e para të studimeve, synimi i UBT-së ka qenë të na përgatisë nga ana praktike dhe ajo teorike në

nivel profesional, në mënyrë që ne si studentë të jemi të gatshëm të fillojmë karrierën profesionale edhe pas studimeve. Po ashtu, bashkëpunimet që ka UBT me kompani të shumta të vendit tonë ka qenë ndihmesë e madhe që unë si student ta kem më të lehtë të gjejë një vend të punës", tha ai.

Në këtë kompani tashmë janë angazhuar me punë disa studentë të UBT-së, kjo si rezultat i profesionalizmit të treguar në fushën e mekatronikës.

Studenti i Mekatronikës, Gramos Bimbashi, i angazhuar në kompaninë e njohur "Formon"

Studenti i Fakultetit të Mekatronikës në UBT, Gramos Bimbashi është angazhuar dhe po punon në linjën e montimit në kompaninë e njohur "Formon".

Ai konkretisht bën montimin e pjesës së poshtme të printerit 3D, njëherësh bën edhe lidhjen e qarqeve elektrike. Gramosi tha se kishte zgjed-

hur UBT-në për të vazhduar studimet, pasi siç tha, ky institucion i përgatit studentët në aspektin teorik dhe praktik në nivel profesional.

"UBT-ja na ka ofruar mundësi shumë të mirë, sepse, që në vitet e para të studimeve jemi përgatitur në aspektin teorik dhe atë praktik në nivele profesionale. Përveç kushteve të

mira të cilat na ka ofruar që të realizojmë idetë tona, në UBT ka të punësuar staf profesionist dhe të kualifikuar në fushën që ata ligjërojnë", potencoi ai.

Gramosi theksoi se lidhshmëria mes mësimin teorik dhe praktik në UBT, e ka bërë atë të jetë i gatshëm për detyrat që i jepen në punë.

Studentja Egurrona Myrtaj monitoroi punimet e objektit të pikës kufitare mes Kosovës e Maqedonisë



Studentja e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, tanimë arkitekte profesionale, Egurrona Myrtaj, ishte pjesë e ekipit implementues të një prej projekteve të rëndësishme ndërkufitare, pikës kufitare në Stanqiq që lidh Kosovën me Maqedoninë, ku investitor ka qenë Bashkimi Evropian.

Në cilësinë e arkitektes, ajo ka mbajtur direkt kontaktin me personat e autorizuar nga BE-ja për mbikëqyrje, teksa

monitoroi secilën fazë të projektit, duke filluar nga matjet gjeodezike dhe topografike, punimet e strukturës, arkitekturës, instalimet elektrike, mekanike dhe të ujit.

Egurrona është shprehur e lumtur që objekti i pikës kufitare është përfunduar me sukses, teksa bëri të ditur që është bërë edhe pranimi teknik nga ana e BE-së.

"Jam falënderuese institucionit që kam studiuar, sidomos profesorëve të Fakultetit të Arkitekturës, ngaqë njohuritë teorike dhe praktike të përfituara në UBT më kanë shërbyer në secilën fazë të këtij projekti. Jam formuar profesionalisht në fushën e arkitekturës, ngaqë më janë ofruar studime cilësore", potencoi studentja Myrtaj.

Ajo tha se pas përfundimit të suksesshëm të këtij projekti, Bashkimi Evropian e ka ftuar të marrë pjesë edhe në projekte tjera të investuara nga BE.

Studenti i Arkitekturës, Shpëtim Shishani, i punësuar në kompaninë "Metal TECH"



Studenti i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Shpëtim Shishani, është duke punuar në kompaninë MetalTECH, në cilësinë e arkitektit dhe të dizajnerit enterier.

Shpëtimi ka theksuar se: "Ar-

ritja e një suksesi të mirë varet nga përkushtimi dhe mbarëvajtja e rregullave mësimore siç parashihen në planprogramin studimor në UBT".

Ndërkaq, ai potencoi se ndërlidhja e teorisë dhe praktikës në fushën e arkitekturës ofron mundësi të shumta, pasi që kjo mënyrë e të mësuarit ndihmon studentët që të përforcojnë njohuritë e tyre praktike dhe të përgatiten profesionalisht për tregun e punës.

UBT ka shkollën më të madhe të Arkitekturës në Kosovë dhe rajon, prej ku çdo vit dalin qindra studentë të diplomuar dhe të përgatitur plotësisht për tregun e punës, mbi 90% prej të cilëve gjejnë vende pune si arkitektë në Kosovë dhe jashtë.

Studentët e Arkitekturës në garën ndërkombëtare "Young Talentet Architects Award" në Barcelonë



Zana Prelvukaj, Falaka Sylja, Erona Jakaj, Arxhenda Lipovica, Kushtrim Lushtaku, Sami Podvorica dhe Florian Ajdari, janë studentët që po e përfaqësojnë Kosovën në mesin e 155 shkollave të arkitekturës nga mbarë bota

në Forumin e Arkitektëve të Rinj në Spanjë gjegjësisht në Barcelonë.

Dy vitet e para studentët tanë kanë arritur të hyjnë në listën e finalistëve dhe edhe këtë vit ata e synojnë çmimin e nominuar për vendin e parë

Mies van der Rohe, arkitekt i njohur i modernizimit.

Ky konkurs synon të mbështesë talentet e rinj në botën profesionale të arkitekturës, planifikimit urban dhe të peizazhit, të cilët do të jenë përgjegjës për transformimin e mjedisit tonë të ndërtuar në të ardhmen.

Konkursi është mbyllur me 27 Prill 2020 dhe në muajt në vijim priten rezultatet nga juria profesionale.

Fituesit do t'i marrin çmimet e tyre në një ceremoni që do të mbahet në Shtator 2020, në kontekstin e Bienales së Arkitekturës në Venecia. Projektet e tyre do të prezantohen në një ekspozitë që do të zhvillohet në të gjithë Bienalen dhe më pas do të udhëtojnë në Evropë dhe më gjerë.

Studenti i UBT-së, Arbnor Demaj prodhon maska për foshnjat e porsalindura



Studenti i UBT-së, Arbnor Demaj, përmes kompanisë së

tij "MARO", ka bërë prodhimin e maskave për foshnje të por-

salindura, së bashku me OJQ-në "Help Kosovo".

Ai së bashku me OJQ-në, "Help Kosovo", janë përgjigjur në kërkesën e QKUK-së për të krijuar maska për foshnje të porsalindura, ku kanë krijuar modele shumë të veçanta dhe funksionale, mirëpo edhe unike sa i përket dizajnit dhe funksionit të tyre.

"UBT është vendi ku i kam fituar njohuritë për t'u përgatitur për tregun aktual të punës, dhe përveç përkrahjes profesionale, UBT na ka përkrahur edhe me mjete të nevojshme në krijimin e maskave ndaj virusit COVID-19",

theksoi Arbnori.

Duke qenë student i Fakultetit Dizajn i Integruar, ai tha se e ka marrë këtë nismë duke e parë nivelin e lartë të rrezikut me të cilin përballen foshnjat e porsalindura, e mbi këtë koncept, pra të ofrimin të zgjidhjeve për problemet e shoqërisë, e ka hapur edhe kompaninë e vet.

"Duke i marrë në bazë aftësitë dhe njohuritë e marra nga drejtimi im në UBT, gjatë kohës së studimeve jam mundur që të ofrojë çdoherë produkte të reja, unike dhe inovative, që shërbejnë për zgjidhjen e problemeve dhe për ofrimin e zgjidhjeve me

anë të dizajnit. Për këtë arsye edhe e kam themeluar kompaninë time. Synimet e mia janë që të rris stafin, si dhe të investojë në teknologji të avancuara, që kështu të shndërrohem në fuqi prodhuese të produkteve, duke kontribuar në përmirësimin e sfidave të jetesës si shoqëri dhe duke kontribuar në zhvillimin ekonomik në Kosovë", tregoi Arbnori.

Studentët e UBT-së nga të gjitha fakultetet i kanë dalë në ndihmë institucioneve dhe kompanive vendore në tejkalimin e kësaj periudhe të vështirë të pandemisë.

Studenti i UBT-së projektton maskën mbrojtëse më inovative me printer 3D për punëtorët shëndetësorë



Nevoja për pajisje mbrojtëse ndaj virusit COVID-19, sidomos për stafin mjekësor, por në përgjithësi edhe për qytetarët, ka shtyrë studentin e Fakultetit Arti dhe Media Digjitale në UBT, Arbnor Demaj, të përdorë zgjuarsinë dhe aftësitë e tij për të projektuar maskën mbrojtëse më inovative, që tashmë e ka krijuar dhe punuar me printer 3D. Ai ka përdorur formatin 3D, pajisje që i ka ndihmuar në

nxjerrjen e produktit final, produkt do të jetë në dispozicion për institucionet shëndetësore kosovare si ndihmë në luftën ndaj këtij virusi që ka prekur botën. Vetë ideatori i maskës, studenti i UBT-së, Arbnor Demaj, tha se kjo pajisje është shumë praktike dhe është dizajnuar në atë mënyrë sa që mbulon pjesët e fytyrës. "Përdorimi i maskës është shumë i lehtë dhe i thjeshtë,

vendoset në kokë, në pjesën balllore. Gjithashtu maska mund të përdoret më shumë se një herë, përkatësisht vetëm plastika transparente mund të ndërrohet dhe të zëvendësohet me një të re, duke mundësuar përdorimin e kornizës së maskës më shumë se një herë. Kështu që falë këtij dizajni përveç që do të mbrojmë jetën e mjekëve apo infermierëve, si dhe individëve të cilët e përdorin, mundësohet që të ruhet mjedisi falë materialit të saj riciklues dhe shumë përdorues duke mos pas nevojë që të hedhet produkti", potencoi studenti Arbnor Demaj. Prodhimi i këtij produkti është përkrahur fuqishëm nga UBT, e nga vetë rektori, prof.dr Edmond Hajrizi, i cili ka deklaruar se institucioni do të ndihmojë në çdo aspekt prodhimin e një sasive të konsiderueshme të maskave të tilla falë laboratëve inovativë që institucioni posedon.

Mbi 150 studentë të infermierisë përfitojnë kontrata pune në Gjermani



Institucione të shquara shëndetësore gjermane kanë krijuar mundësinë për t'i punësuar mbi 150 studentë të Fakultetit të Infermierisë në UBT, për siç thuhet, ngaqë institucioni ka përgatitur profesionalisht këta studentë në aspektin teorik dhe praktik. Studentët përfituan kontrata pune 5 vjeçare falë marrëveshjes që UBT ka me kompaninë "TG Personalconsulting", të cilët kontributin e tyre profesional do ta japin në spitale dhe klinika të shtetit gjerman. Gjithashtu, mbi 150 studentët


e punësuar në Gjermani kanë përfituar edhe bursa studimi, pasi që studimet e tyre do të paguhen nga spitalet ku ata kanë nënshkruar kontratat e punës. UBT është qendër e inovacionit për mjekësi në Kosovë dhe rajon, e pajisur me mbi 100 laboratorë shkencor për të gjitha fushat e shëndetësisë: Infermieri, Stomatologji, Mjekësi e Përgjithshme, Farmaci, Interno, Pediatri, si dhe me pajisje të sofistikuar, ku çdo vit nxjerr kuadro të përgatitura profesionalisht në fushën e shëndetësisë.

Studenti Emin Emini përfitues i bursës për vazhdim të studimeve në Portugali

Emin Emini, student i Fakultetit Shkenca Komputerike dhe Inxhinieri në UBT, është njëri nga studentët përfitues të bursës për vazhdim të studimeve në Universitetin "Nova de Lisboa", nga Portugalia. Ai është përzgjedhur përfitues i bursës në bazë të notës mesatare mbi 9.0, që e ka arritur gjatë studimeve në UBT. Emini ka thënë në këtë universitet ka vazhduar

studimet në specializimin për Inteligjencë Artificiale, ku tregoi se do të marrë njohuri profesionale për automatizimin e pajisjeve dhe programonin e robotëve. Së fundmi katër studentët të UBT-së kanë përfituar bursë studimi përmes programit Erasmus+, për të vazhduar studimet në Universitetin "Nova de Lisboa", nga Portugalia.

Ish-studenti i UBT-së, Dardan Iseni themeloi kompaninë e ndërtimit "Intact"



Ish-studenti i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës në UBT, Dardan Iseni ka themeluar kompaninë "Intact", që është e fokusuar në sektorin e ndërtimit.

Si themelues, drejtor dhe inxhinier i kompanisë, Dardan Iseni ka arritur të menaxhojë shumë projekte ndër të cilat janë edhe hartimi i projektit ideor në repartin e radiologjisë në spitalin regional të Prizrenit si dhe renovimi i QMF-së në qytetën e Mamushës. Përpos përpjekjeve personale, ai thotë se për ndërmarrjen e këtij hapi rol të madh kanë luajtur njohuritë e fituara përgjatë studimeve në UBT. "Kam vendosur të studioj në UBT sepse e dija faktin që kemi mundësi të shumta për ndërlidhjen e teorisë me praktikën. Mënyra interaktive e ligjëratave, vizita nëpër ob-

jekte të ndryshme, mbështetja profesionale e stafit dhe e profesorëve kanë luajtur rol të rëndësishëm në rrugëtimin tim", theksoi Dardani. Duke folur për periodat e zhvillimit të karrierës ai veçoi mundësinë që e ka fituar përmes UBT-së, ku fillimisht është punësuar në cilësinë e teknikut të laboratorit, në një laborator të materialeve ndërtimore dhe matjeve gjeomekanike. Dardan Iseni është një nga shumë studentë të UBT-së, të cilët kanë arritur të themelojnë kompanitë dhe fabrikat e tyre pas përfundimit të studimeve në UBT.

Studentët e UBT-së hapën ekspozitë me punime të konceptit Smart City, në Vushtri



Punime të shumta të studentëve të Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, janë prezantuar në hapjen e ekspozitës në kalanë e qytetit, në Vushtri. Punimet e studentëve janë realizuar në nivelin master në kuadër të lëndës Advanced Urban Planning, ligjëruar nga profesori Skender Kosumi, i cili njëherësh ka mentoruar planet e hartuara dhe ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm që këto projekte në të ardhmen të

gjejnë zbatim në këtë komunë. Punimet i dedikohen konkretisht qytetit të Vushtrrisë, ku në mënyrë profesionale është projektuar urbanizimi i kësaj komune, projekte që janë hartuar duke përfshirë gjithnjë konceptin Smart City. Trashëgimia kulturore, turizmi, hapësirat publike, bujqësia, mobiliteti urban janë vetëm disa nga temat që janë trajtuar në punime, për të cilat studentët kanë dhënë ide inovative në funksion të shndërrimit të

Vushtrrisë në një qytet të qëndrueshëm e të mençur. Në hapjen e ekspozitës morën pjesë rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, drejtori i Qendrës për Studime Urbane në UBT, Shqiprim Ahmeti, zyrtarë komunal, përfshirë drejtorin e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit në Vushtri, Berat Sadiku, profesorë dhe studentë. Ata theksuan se UBT ka studentë dhe staf mjaft të përgatitur sa që bashkërisht ideojnë punime kualitative urbane-arkitektonike, që mund të implementohen edhe në praktikë. Ekspozitën patën mundësi ta shohin të gjithë të interesuar, ku edhe janë informuar rreth realizimit të punimeve, ndërkaq ekspozita do të jetë e hapur përgjatë 30 ditëve.

Studentja Erdita Bajraktari përfiton bursë studimi në Universitetin "Van Hall Larensten", në Holandë

Erdita Bajraktari është studentja e radhës e cila ka përfituar bursë studimi në Universitetin e Shkencave të Aplikuara "Van Hall Larensten", në Holandë, ku tashmë po specializon në Fakultetin Teknologji e Ujit dhe Shkencat Mjedisore. Ajo tha se po përfiton njohuri profesionale për menaxhimin e rreziqeve mjedisore në shkallë të gjerë, po përfiton aftësi për trajtimin dhe teknologjitë e avancuara të ujit, etj. Erdita tregoi se ndjehet e kënaqur për vazhdimin e studimeve në Holandë, ndërkaq tregoi se sukcesi ka ardhur si rezultat i mësimin dhe humulimit në UBT.



Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Energjisë vizituan Termokosin



Nevoja për pajisje mbrojtëse ndaj virusit COVID-19, sidomos për stafin mjekësor, por në përgjithësi edhe për qytetarët, ka shtyrë studentin e Fakultetit Arti dhe Media Digjitale në UBT, Arbnor Demaj, të përdorë zguarsinë dhe aftësitë e tij për të projektuar maskën mbrojtëse më inovative, që tashmë e ka krijuar dhe punuar me printer 3D.

Ai ka përdorur formatin 3D, pajisje që i ka ndihmuar në nxjerr-

jen e produktit final, produkt do të jetë në dispozicion për institucionet shëndetësore kosovare si ndihmë në luftën ndaj këtij virusi që ka prekur botën.

Vetë ideatori i maskës, studenti i UBT-së, Arbnor Demaj, tha se kjo pajisje është shumë praktike dhe është dizajnuar në atë mënyrë saqë mbulon pjesët e fytyrës.

"Përdorimi i maskës është shumë i lehtë dhe i thjeshtë, vendoset në kokë, në pjesën

ballore. Gjithashtu maska mund të përdoret më shumë se një herë, përkatësisht vetëm plastika transparente mund të ndërrohet dhe të zëvendësohet me një të re, duke mundësuar përdorimin e kornizës së maskës më shumë se një herë. Kështu që falë këtij dizajni përveç që do të mbrojmë jetën e mjekëve apo infermierëve, si dhe individëve të cilët e përdorin, mundësohet që të ruhet mjedisi falë materialit të saj riciklues dhe shumë përdorues duke mos pas nevojë që të hedhet produkti", potencoi studenti Arbnor Demaj.

Prodhimi i këtij produkti është përkrahur fuqishëm nga UBT, e nga vetë rektori, prof.dr Edmond Hajrizi, i cili ka deklaruar se institucioni do të ndihmojë në çdo aspekt prodhimin e një sasive të konsiderueshme të maskave të tilla falë laboratëve inovativë që institucioni posedon.

Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Energjisë realizuan vizitë studimore në KOSTT



Studentët e vitit të dytë Fakultetit të Inxhinierisë së Energjisë, realizuan vizitë studimore në nënstacionin e KOSTT-it, nën shoqërimin e profesorëve Vehbi Sofiu, Besa Veseli, Nexhmi Krasniqi, Afete Shala, Nexhat Balaj, Faton Maloku, Sami Gashi, Armend Ymeri dhe Afrim Osmani. Vizita u realizua në kuadër të lëndës "Praktika në Industri", ku studentët patën mundësi të shohin nga afër detajet inxhinierike

ku edhe u inkuadruan me pyetje dhe diskutime të ndryshme.

Të vetëdijshëm se inxhinierët e sotëm duhet të jenë të aftë t'i zgjidhur probleme komplekse, shumë të fokusuara praktike, si dhe atyre të fushave të Inxhinierisë, UBT e ofron këtë program studimor, ku njëra ndër metodat themelore përgjatë studimeve është shndërrimi i njohurive teorike në praktikë.

Studentët e Ndërtimitarisë realizojnë vizitë studimore në Qendrën Tregtare "Prishtina Mall"

Studentët e Fakultetit Inxhinieri Ndërtimore dhe Infrastrukturë në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në qendrën tregtare "Prishtina Mall", ku janë duke vazhduar punimet në ndërtimin e kësaj qendre tregtare.

Studentët u informuan dhe panë për së afërmi punimet që janë duke u zhvilluar në qendrën tregtare "Prishtina Mall", me organizimin e punës, kontrollimin e kualitetit të punës, betonimin,

teksa u njohën më shumë me përgjegjësitë dhe kompetencat që ata do t'i kenë në të ardhmen, në ushtrimin e këtij profesioni.

Kjo vizitë është realizuar në kuadër të lëndës Organizimi dhe Teknologjia e Ndërtimit, ku ligjëruesit e kësaj lënde, Muhamet Ahmeti dhe Anjeza Alaj, bashkë me studentët u pritën nga profesorët Nebi Pllana dhe Përparim Neziri, që njëherësh janë edhe përgjegjës dhe



mbikëqyrës të këtij projekti.

Qendra tregtare "Prishtina Mall", do të ketë një hapësirë prej 250 mijë metra katrorë dhe do të ketë rreth 200 brende prestigjioze ndërkombëtare.

UBT i konsideron tejet të rëndësishme vizitat studimore, pasi që studentët e shohin nga afër zhvillimin dhe mënyrën se si realizohet puna në profesionin dhe fushën që ata kanë zgjedhur të studiojnë.

Studentët e Ndërtimitarisë realizojnë vizitë studimore tek objekti i 40-katëshit



Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në UBT, në kuadër të punës praktike kanë realizuar vizitë studimore tek ndërtesa 40-katëshe, me qëllim për të parë nga afër punimet që po kryhen nga Alba Group.

Studentët u shoqëruan nga profesorët dr.Muhamet Ahmeti dhe Gent Hasimja, ku u informuar lidhur me proceset e ndërtimit të objektit, duke filluar nga plan-

ifikimi, menaxhimi dhe ndërtimi i ndërtesës 40-katëshe.

Konkretisht studentët u informuan për betonimin, hidroizolimimin, kallupimin, montimin e konstruksioneve të çelikut, si dhe procese tjera ndërtimore.

Interesimi i studentëve për të vizituar këtë ndërtesë ishte i madh, të cilët përmes pyetjeve të tyre përfituan njohuri dhe përvoja profesionale.

Studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor realizojnë vizitë studimore në fshatin Struzhë



Studentët e Fakultetit Inxhinieri Ndërtimore dhe Infrastrukturë në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në qendrën tregtare "Prishtina Mall", ku janë duke vazhduar punimet në ndërtimin e kësaj qendre tregtare. Studentët u informuan dhe panë për së afërmi punimet që janë duke u zhvilluar në qendrën tregtare "Prishtina Mall", me organizimin e punës, kontrollimin e kualitetit të punës, betonimin,

teksa u njohën më shumë me përgjegjësitë dhe kompetencat që ata do t'i kenë në të ardhmen, në ushtrimin e këtij profesioni. Kjo vizitë është realizuar në kuadër të lëndës Organizimi dhe Teknologjia e Ndërtimit, ku ligjëruesit e kësaj lënde, Muhamet Ahmeti dhe Anjeza Alaj, bashkë me studentët u pritën nga profesorët Nebi Pllana dhe Përparim Neziri, që njëherësh janë edhe përgjegjës dhe mbikëqyrës të

këtij projekti.

Qendra tregtare "Prishtina Mall", do të ketë një hapësirë prej 250 mijë metra katrorë dhe do të ketë rreth 200 brende prestigjioze ndërkombëtare.

UBT i konsideron tejet të rëndësishme vizitat studimore, pasi që studentët e shohin nga afër zhvillimin dhe mënyrën se si realizohet puna në profesionin dhe fushën që ata kanë zgjedhur të studiojnë.

Në Fakultetin Media dhe Komunikim u mbajtën ligjërata tematike online për artin dhe sfidat në media



Pos ligjëratave të përditshme, Fakulteti Media dhe Komunikim, në UBT, po përpiqet që studentët e vet t'i mbajë në rrjedha të secilës ngjarje, me qëllim që ata të marrin sa më shumë njohuri jashtë kurrikulës mësimore. Si rrjedhojë cikli i ligjëratave tematike po vazhdon me gërshetimin e temave të ndryshme, ku kësaj here u trajtua tema "Arti dhe Sfidat në Media", nga artisti dhe ligjëruesi Gazmend Ejupi. Në kuadër të kësaj ligjërata u diskutua më gjerësisht rreth

ndryshimeve në botën e artit dhe të mediave përgjatë 10 viteve të fundit, ndryshimet në galeri, muze, kurator si dhe për tregtarët e artit. Ligjërata pati karakter interaktiv dhe studentët u inkuadruan gjatë tërë kohës me pyetje dhe diskutim. Kjo ligjërata u mbajt me qëllim të zhvillimit, avancimit dhe ngritjes së cilësisë së studimeve dhe njohurive për studentët e këtij fakulteti në fushën e artit.

Ligjërata tematike online për rolin e medias në politikë

Cikli i ligjëratave tematike online në kuadër të Fakultetit Media dhe Komunikim po vazhdon tutje duke trajtuar tema nga fusha të ndryshme me qëllim që studentët e vet t'i mbajë në rrjedha të secilës ngjarje dhe të marrin sa më shumë njohuri jashtë kurrikulës mësimore.

Për ta parë rolin e medias në politikë, Fakulteti Media dhe Komunikim organizoi për studentë e vet ligjërata tematike online, që për temë kishte ndikimin e mediave në politikë, komunikimin politik në arenën e mediave sociale, evoluimin e mediave



të reja, sigurimin e informacionit politik, anët pozitive dhe negative të rrjeteve sociale si dhe prezencën dhe ngritjen e lajmeve të rreme. Ligjërata tematike u mbajt nga analisti politik njëherësh edhe ligjërues në UBT, Dritëro Arifi.

Ligjërata pati karakter interaktiv dhe studentët u inkuadruan gjatë tërë kohës me pyetje dhe diskutim.

Kjo ligjërata u mbajt me qëllim të zhvillimit, avancimit dhe ngritjes së cilësisë së studimeve dhe njohurive për studentët e gazetarisë në fushën e politikës.

Diskutohet ndikimi psikologjik i pandemisë në punën e gazetarëve



Profesioni i gazetarisë është njëra ndër profesionet ku gazetarët përballen me shumë sfida. Raportimi nga vendi i ngjarjes është një rrezik potencial për infektim, mirëpo aftësia e gazetarëve e mundëson që të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë sa më profesionale dhe me përgjegjësi duke e sfiduar këtë epidemi që na ka kapluar. Periudha e pandemisë ka sjellë një numër normash dhe ndryshime të reja, ku të gjitha këto ndryshime e bëjnë raportimin edhe më të

komplikuar dhe dëmtojnë shëndetin emocional dhe fizik të gazetarëve. Për ta kuptuar nga afër gjendjen psikologjike të gazetarëve, Fakulteti Media dhe Komunikim, ka organizuar ligjërata tematike online me titull: "Ndikimi psikologjik i pandemisë COVID-19 në punën e gazetarëve", e cila u mbajt nga psikologjia dhe profesoresha Violeta Zefi. Në kuadër të kësaj ligjërata është diskutuar zgjerimisht rreth sfidave të raportimit siç janë: siguria personale,

verifikimi i fakteve, dezinformimi, infodemia, paqartësia nga ana e shkencëtarëve, mohimi total i virusit etj. Ndërkaq, studentët u njoftuan edhe me mirëqenien emocionale të gazetarëve, përjetimin dhe menaxhimin e stresit, frikës si dhe kujdesin e shëndetit mendor si gazetarë. Studentët e këtij fakulteti pajisen me njohuri që do t'u shërbejnë atyre dhe shoqërisë në përgjithësi, e që do t'u ndihmojë në profesionalizimin gazetaresk të tyre.

Studentët e Medias dhe Komunikimit mbajnë fizikisht pjesën praktike të mësimit, respektojnë masat e pandemisë



Muajt e pandemisë kanë qenë sfida në vete për çdo institucion arsimor kudo në botë, por me sistemin modern të UBT-së për mësim online, qasja dhe adaptimi i studentëve në mësim është bërë shumë më i lehtë dhe më atraktiv. Megjithatë, në lëndët që punën praktike e kanë në thelb të mësimit, UBT ua ka mundësuar studentëve të gjitha kushtet, në mënyrë që të mos privohen nga zbatimi praktik i njohurive. Kjo metodë mësimi është zbatuar edhe në lëndën "Kamera dhe Fotografia", në

kuadër të Fakultetit Media dhe Komunikim, ku nën mentorimin e asistentes Anisa Rada, si dhe duke i ndërmarë të gjitha masat për mbrojtje ndaj COVID-19, studentët e vitit të dytë po vijojnë punën praktike dhe po përgatiten për tregun e punës. Puna në terren, jo vetëm që po u ndihmon studentëve të mos mbesin prapa në përfitim të shkathtësive praktike mbi kamerën dhe fotografimin, por mbi të gjitha po ju ndihmon studentëve që më lehtë ta tejkalojnë sfidën e të mësuarit online.

FSK e falënderon Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor të UBT-së për mbështetjen e vazhdueshme

Studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT ishin pjesë e konkursit për dizajnin e "Obeliskut të Lirisë" që prezanton transformimin e UÇK-së në TMK-FSK dhe së fundmi në Ushtrinë e Kosovës. Projekti është realizuar nga prof. dr. Arbër Sadiki, nga koordinatori e fakultetit Zana Prelvukaj dhe nga grupi i studentëve të fakultetit i përbërë nga Flaka Sylja, Arxhenda Lipovica, Benart Shalla, Kushtrim Lushtaku dhe Sami Podvorica.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është rikthimi i vlerës dhe të jepet identiteti i obeliskut, që do të shndërrohet



në muze për vizitorë. Projekti do të përfshijë prezantimin e gjithë historikut të

krijimit të Forcave të Sigurisë së Kosovës që nga viti 1918 deri 2018, duke përf-

shirë kohën e Jugosllavisë, fillat e Lëvizjes Popullore të Kosovës, Themelimin e Ush-

trisë Çlirimtare të Kosovës, transformimin e UÇK-së në TMK, shpërbërjen e TMK-së në FSK, pavarësinë e Kosovës e deri te transformimin e FSK-së në ushtrinë e Kosovës.

Projekti është prezantuar para strukturave të larta të FSK-së, gjegjësisht para kolonelit z.Agron Bajrami, i cili e ka falënderuar UBT-në për mbështetje të vazhdueshme. Dekani i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, prof.dr. Lulzim Beqiri, ka shprehur gatishmërinë e UBT-së që të mbështes profesionalisht FSK-në në të gjitha aktivitetet e tyre.

Komuna e Ferizajt ndan mirënjohje për Fakultetin e Arkitekturës në UBT



Me qëllim të bashkëpunimit dhe për kontributin e dhënë në Javën e Kulturës, ngjarje që çdo vit organizohet nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, komuna e Ferizajt ka ndarë mirënjohje për Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT.

Konkretisht, mirënjohja është ndarë edhe për kontributin e dhënë në hartimin dhe përpilimin e projekt-propozimeve nga ana e studentëve të këtij fakulteti,

të cilët realizuan projekte arkitektonike me ide të shumta moderne dhe inovative për zhvillimin urban të Ferizajt.

Këto projekte u monitoruan nga profesorët e fakultetit, teksa më pas janë prezantuar në ekspozitën e mbajtur në sheshin kryesor të komunës së Ferizajt, ekspozitë që ngjalli interesimin e qytetarëve e kësaj komune, ku edhe e vlerësuan lartë kontributin e studentëve të Arkitekturës.

Studentët e Dizajnit të Integruar realizojnë sfilatën "POP-UP"



Studentët dhe profesorët e Fakultetit të Dizajnit të Integruar kanë realizuar një sfilatë mode me krijime të përzgjedhura të studentëve të vitit të tretë dhe vitit të dytë. Koleksioni i kësaj sfilate si tërësi është bazuar dhe titulluar sipas trendit e fundit të modës në botë, "POP-UP", që ka qenë karakteristikë tipike e modës së zhvilluar gjatë këtyre muajve të pandemisë nga stilistët dhe dizajnerët më të njohur.

Profesoresha dhe organizatorja e sfilatës, Afërdita

Statovci potencoi se fillimi i muajit Mars 2020, u shënuar me fillimin e një periudhe sfiduese për të gjitha industrinë, përfshirë këtu edhe industrinë e modës.

"E ardhmja e shfaqjeve, ekspozitave dhe sfilatave të modës ishte e pa sigurt dhe kjo paraqiti një sfidë për dizajnerët të modës, për studentët të modës dhe për brendet të tejkalojnë krizën e pandemisë dhe përkufizimeve sociale që e përcollën atë. Të ballafaquar me domoshmërinë e përkthimit

të modës në një format digjital, në specializimin Dizajn Mode dhe Tekstil, kaluam javët e para të izolimit në muajin Mars duke diskutuar mënyrën se si të bashkëdyzojmë glamurin dhe shkëlqimin e një sfilate mode me 'fototësinë' e internetit. Përgjigja: Sfilatë Virtuale", potencoi Statovci.

Sipas profesoreshës, video lojërat dhe zhanri fantastiko-shkencor kanë qenë prej kohësh një mjet për të ndërtuar një utopi, duke u mbështetur në idenë se përtej realiteteve fizike mund të ndërtohet diçka më e mirë. "Tema e sfilatës ishte 'POP-UP', që në dizajn të modës nënkupton diçka që shfaqet papritmas. Si koncept 'POP-UP', në dizajn të modës është përqafuar fuqishëm nga dizajnerët dhe brendet e modës në tërë globin si një eksperiencë e re, dhe si mjet i cili ofron përvoja të reja për të krijuar lidhje më të thella me publikun duke i lejuar atij të analizojë dhe të shijojë më shumë dizajnet e shfaqura", vlerësoi ajo.

Studentët e Dizajnit të Integruar zhvilluan punëtorinë online për rizbulimin e shtëpisë përgjatë karantinimit

Përmes sistemit modern të UBT-së për mësim online, Fakulteti i Dizajnit të Integruar për studentët e vet, ka organizuar punëtorinë të titulluar "Rizbulimi i shtëpisë", qëllimi i së cilës ishte zbulimi dhe përdorimi i hapësirave në shtëpi përgjatë karantinimit.

Në kuadër të lëndës "Bazat e Dizajnit të Enteriety", nën mentorimin e ligjërueses Sebil Shpat, është trajtuar koncepti mbi përfaqësimet arkitektonike të shtëpisë përgjatë karantinimit, përshatja e aktiviteteve siç janë

blerja, ushqimi, edukimi, aktivitetet sociale, komunikimi si dhe simulimi i revolucionit digjital e cila filloi ta shkatërojë hapësirën fizike.

Punëtorja pati karakter interaktiv dhe studentët u inkuadruan gjatë tërë kohës me diskutime dhe ide të reja rreth temës.

Pos ligjëratave të përditshme online, Fakulteti i Dizajnit të Integruar, studentëve po iu mundëson zbatimin e njohurive shtesë jashtë kurrikulës mësimore, avancimin dhe ngritjen e cilësisë të studimeve.




UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Universita degli Studi del Sannio

UBT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universita degli Studi del Sannio, nga Italia, me qëllim të krijimit të mundësive për studentët që dëshirojnë t'i vazhdojnë studimet në vendet që ata ëndërrojnë. Bashkëpunimi përqendrohet në të gjitha fushat dhe sektorët, ku falë kësaj marrëveshjeje institucionet mund të bëjnë shkëmbim semestral dhe të studentëve, të organizojnë

vizita studimore në shtetet përkatëse, të zhvillojnë konferenca shkencore, apo edhe mund të hartojnë projekte të përbashkëta kërkimore në fushat me interes. Partneriteti mes dyja institucioneve do të kontribuojë në aspektin akademik dhe shkencor, teksa UBT tashmë ka rreth 500 bashkëpunime të tilla me universitete dhe institucione të shquara në botë.



Fakulteti Juridik në bashkëpunim me Fondin Humanitar diskutuan rreth Dhomave të Specializuara të Kosovës



Për ta parë nga afër rolin dhe funksionimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës, Fakulteti Juridik në bashkëpunim me Fondin Humanitar, për studentë e vet organizoi ligjërata tematike online, në mënyrë që ata t'i mbajë në rrjedha të secilës ngjarje, duke fituar më shumë njohuri jashtë kurrikulës mësimore. Panelistët e kësaj ligjërata, konkretisht zyrtari ligjor të institucionit të Ombudsmanit të Dhomave të specializuara të Kosovës, Z. Paul Landers si dhe zëdhënësit, Micheal Doyle e Soleen Mourtier, shpjeguan se si Dhomat e Specializuara dhe

Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës janë pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës. Ndërkaq, në kuadër të kësaj ligjërata u diskutua detajisht rreth njohjes së procesit të formimit të dhomave, mandatin e juridiksionin e përcaktuar, konkretisht për krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera të përkufizuara në Ligjin e Kosovës. Ligjërata pati karakter interaktiv në të cilin studentët dhe stafi i këtij fakulteti u inkuadruan me pyetje dhe diskutim në mënyrë që të marrin njohuri të mirëfillta dhe të ngritën profesionalisht.

Në Shkenca Politike u mbajt ligjërata tematike për sinjalizuesit në Kosovë



Në kuadër të Fakultetit Shkencat Politike në UBT, Ambasada e ShBA-së në partneritet me organizatën jo-qeveritare "Qendra për Studime të Avancuara FIT", mbajtën ligjërata tematike me temë: "Sinjalizuesit – zëri i shoqërisë sonë", përkatësisht "Legjislacioni i ri për sinjalizuesit në Kosovë: si do të ndihmojë ky ligj Kosovën drejt një shoqërie

pa korrupsion". Ligjërata është mbajtur online, teksa studentët u informuan gjerësisht lidhur me sinjalizuesit dhe ligjet në këtë aspekt. Kjo ligjërata u mbajt me qëllim që studentët të përfitojnë njohuri në këtë fushë, ndërkohë pati karakter interaktiv dhe studentët u inkuadruan gjatë tërë kohës me pyetje dhe diskutim.

Në UBT u mbajt ligjërata tematike mbi trajtimin e ujërave të zeza dhe cilësinë e ujit



Në kuadër të Fakultetit të Inzhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës, për studentët e vitit të dytë të nivelit master, konkretisht të specializimit Hidroteknikë, u mbajt ligjërata tematike mbi trajtimin e ujërave të zeza dhe cilësinë e ujit, nga dr Muharrem Sa-

lihaj, përgjegjës i trajtimit të ujërave në kampin ushtarak amerikan, "Bondsteel". Gjatë kësaj ligjërata u trajtua mënyra e monitorimit dhe realizimit të disa projekteve për trajtimin e ujit. Nga eksperiencat amerikane të aplikuara në Kosovë, po ashtu u shpjeguan

hapat dhe mënyrat moderne të trajtimit të ujërave. Ligjërata në fjalë ishte vazhdim i bashkëpunimit ndërmjet KBR-së dhe UBT-së, teksa palët edhe në vazhdim parashohin që zhvillojnë aktiviteteve në interes të dyanshëm.

Është mbajtur punëtorja e projektit për Financimin e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional në Kosovë



Është mbajtur punëtorja e dytë me grupin punues në Financimin e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional në Kosovë, punëtori që po zhvillohet në kuadër të projektit ALLED2 që zhvillohet në bashkëpunim me UBT-në dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Gjatë kësaj punëtorie janë diskutuar aktivitetet që do të zhvillohen në funksion të përmirësimit të cilësisë së arsimit në Kosovë, teksa bizneset që kanë kontribuar në këtë diskutim janë: Meridian Group, Archtime Metal Construction, Elnor Furniture, dhe Muqja Solar Company,

të cilët gjerësisht folën për bashkëpunimin e bizneseve me shkollat profesionale dhe sfidat në këtë proces. Pjesëmarrës të diskutimit në punëtori ishin përfaqësues nga MASHTI, zyra e BE-së në Kosovë, GIZ-i, LuxDev, Helvetas, OEK, dhe KPK.

UBT në mbështetje të Kosovës, dhuron maska mbrojtëse për punëtorët e komunës së Prishtinës



Me qëllim të mbështetjes në luftën kundër përhapjes së pandemisë COVID-19, UBT tash e gati dy muaj është solidarizuar dhe ka dhuruar mjete mbrojtëse institucioneve anë e mbarë Kosovës. Së fundmi, një donacion të tillë e ka pranuar edhe Komuna e Prishtinës, me ç'rast janë dhuruar një sasi e maskave të prodhuara nga stu-

dentët e UBT-së, e që do të shërbejnë për punëtorët e kësaj komune. Maskat janë shpërndarë në kuadër të kampanjës "I Love You All", e cila është organizuar nga Fakulteti Arti dhe Mediat Digjitale. Maskat mbrojtëse tejet inovative, që tashmë janë krijuar dhe punuar me printer 3D janë projektuar nga studenti

i Fakultetit Dizajn i Integruar, Arbnor Demaj dhe mbështetur nga UBT. Deri tash janë prodhuar qindra maska të tilla, teksa do të vazhdojnë të prodhohen edhe një sasi të konsiderueshme maskave mbrojtëse për kategoritë e ndjeshme të shoqërisë.

UBT dhuron maska mbrojtëse për punëtorët e Trafikut Urban në Prishtinë



Në kuadër të kampanjës "I Love You All", të cilën janë duke e realizuar studentët dhe stafi i Fakultetit Arti dhe Media Digjitale në UBT, një sasi e maskave janë dhuruar punëtorëve të Trafikut Urban në Prishtinë. Maskat mbrojtëse tejet inovative, që tashmë janë krijuar dhe punuar me printer 3D janë projektuar nga studenti

i Fakultetit Dizajn i Integruar, Arbnor Demaj dhe mbështetur nga UBT. Me qëllim të mbështetjes në luftën kundër përhapjes së pandemisë COVID-19, UBT tash e gati dy muaj është solidarizuar dhe ka dhuruar mjete mbrojtëse institucioneve anë e mbarë Kosovës.

UBT shpërndan maskat mbrojtëse të prodhuara nga studentët për Shtëpinë e të Moshuarve



Studentët së bashku me stafin e Fakultetit Dizajn i Integruar në UBT, kanë marrë iniciativën dhe për një kohë shumë të shkurtër kanë prodhuar rreth 1 mijë maska kirurgjike, të cilat i ka shpërndarë në Shtëpinë e të Moshuarve. Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i maskave pritet të shpërndahen edhe në strehimoren për viktimat e dhunës në familje "Shtëpia

e Sigurt", në Gjakovë. Studentët filluan qepjen e maskave si rezultat i shtrenjtimit dhe mungesës së tyre, që do të shërbejnë si mjet mbrojtës në kohën e virusit. Studentët do të prodhojnë edhe sasi tjera të maskave mbrojtëse, të cilat do të shpërndahen për institucionet tjera që kanë nevojë në Kosovë.

Studentët e UBT-së prodhojnë maska për Strehimoren e viktimave të dhunës në familje, "Shtëpia e Sigurt"



Studentët e Dizajnit të Integruar në UBT, i janë përgjigjur pozitivisht institucioneve të ndryshme që t'u dalin në ndihmë me masa mbrojtëse.

Së fundmi, studentët dhe stafi i këtij fakulteti kanë prodhuar maska mbrojtëse për një kategori shumë të ndjeshme të shoqërisë, konkretisht për

strehimoren e viktimave të dhunës në familje, "Shtëpia e Sigurt" dhe "Hendikos", në Gjakovë. Po ashtu, një numër i konsiderueshëm i maskave pritet të shpërndahen edhe në Komunën e Prishtinës dhe Policinë e Kosovës. Përgjatë gjithë studimeve të tyre, profesorët e UBT-së përpunon që tek studentët të përçojnë jo vetëm njohuritë profesionale, por edhe anën humane e solidarë. E pandemia COVID-19 ka dëshmuar që studentët tanë nuk po bëhen vetëm profesionistë, por edhe humanistë që do t'i shërbejnë vendit në çfarëdo kushte e rrethana.

Stafi dhe studentët e UBT-së dhuruan gjak



Stafi dhe studentët e UBT-së edhe këtë vit i janë përgjigjur pozitivisht aksionit vullnetar

për dhurimin e gjakut, nën moton "Dhuro gjak, shpëto jetë", organizuar nga Qen-

drën Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut. Ky është viti i pestë që UBT dhuron gjak, madje në vitet e kaluara ka shënuar edhe shifra rekorde të dhurimit në Kosovë, në kuadër të një aksioni të vetëm, prandaj edhe Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzion të Gjakut ndau edhe mirënjohje UBT-së për mbështetjen dhe kontributin e dhënë. Aksioni u zhvillua në Kampusin Inovativ të UBT-së, në Lipjan, teksa thirrjes iu përgjigjen studentë shumë e punonjës të UBT-së.

EON Reality dhe UBT trajnojnë dhe certifikojnë profesorët për realitet virtual ose AVR Edukator



Kompania e madhe botërore për teknologji virtuale, EON Reality dhe UBT, kanë mbajtur trajnimin për nivelin e dytë ku kanë trajnuar dhe certifikuar dhjetëra profesorë të UBT-së për AVR Edukator, konkretisht për realitet virtual.

Profesorët në UBT janë trajnuar nga ekspertët ndërkombëtar të arsimit virtual, Mohamad Ridwan Othman, Nicole Pallares dhe Ridwan Othman, teksa tashmë janë të vetmit në Ballkan, që janë certifikuar për të mundësuar instalimin dhe praktikimin e

realitetit virtual në sistemin arsimor në Kosovë, gjithnjë përmes mësimëve praktike. Profesorët e certifikuar tanimë mund të hartojnë një plan të plotë mësimi duke përfshirë mësimin me realitet të shtuar, njëherësh do të mund të dizajnojnë mësimin në përshtatje me qasjet pedagogjike bazuar në AVR.

UBT në bashkëpunim me EON Reality, janë të parët në Kosovë që kanë organizuar trajnime për AVR Edukator, ndërkaq në nivelin e parë u trajnuan mbi 30 profesorë të UBT-së.

UBT partner i projektit VTECH, mbajnë trajnimin e parë për Realitetin Virtual në Shqipëri

Në Universitetin "Aleksandër Moisiu", në qytetin e Durrësit, në Shqipëri, është mbajtur trajnimi i parë për Realitetin Virtual, në kuadër të projektit VTECH të Erasmus+, ku pjesë e trajnimit ishin staf akademik nga universitetet e Ballkanit Perëndimor.

UBT, meqë është institucioni i parë në rajon që ka nisur mësimin online përmes platformës së realitetit virtual, duke kaluar nga klasat 2.0 në CLASSROOM 3.0, përmes profesorëve Blerim Gjinovci dhe Visar Isufi, ka ofruar mbështetje profesionale në këtë trajnim.

Ata kanë demonstruar dhe praktikuar Realitetin Virtual, kontribuuan dhe ndanë përvojat profesionale me mbi 20 pjesëmarrës nga 4 institucione të arsimit të lartë.

VTECH është një projekt Erasmus +, që ka të bëjë konkretisht për ndërtimin e kapaciteteve në arsimin e lartë, ku bëjë pjesë 11 partnerë, nga të cilët 6 janë nga Shqipëria dhe Kosova dhe 5 partnerë nga vendet e programit përkatësisht Estonia, Polonia, Sllovenia dhe Republika e Maqedonisë së Veriut. Ky projekt parashikohet të zgjasë për 3 vjet.



MASH-i shpall fitues projektin e profesorëve të UBT-së në programin "Projekte të vogla shkencore 2020"



Projekti i ideuar nga profesorët në UBT, Krenare Pireva Nuci, Jorida Xhafaj dhe Bertan Karahoda, i titulluar "Transformimi i mësimdhënies nga klasat në kampus në mësimin online për shkak të pandemisë COVID-19 në Kosovë", është shpallur fitues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH).

Projekti fitoi në kuadër të "projekteve të vogla shkencore për vitin 2020, i cili do të mbështetet financiarisht nga MASH-i për tetë muajt e ardhshëm.

Ky projekt ka për qëllim analizimin e situatës në nivel

nacional, ku përfshirë profesorë dhe ekspertë nga institucione të ndryshme brenda Kosovës, si edhe dhe ekspertë nga Universiteti NTNU ne Norvegji.

"Transformimi i mësimdhënies nga klasat në kampus në mësimin online për shkak të pandemisë COVID-19 në Kosovë" është projekt multidiciplinar dhe do të zhvillojë aktivitete që i përkasin fushës së shkencave kompjuterike, edukimit, teksa përfshinë edhe kornizën ligjore në implementimin e politikave publike.

Tenori Ramë Lahaj mbajti ligjëratë për studentët e Fakultetit të Muzikës Moderne, Produksion Digjital dhe Menaxhment



Në Kampusin Inovativ të UBT-së, në Lipjan, tenori Ramë Lahaj, mbajti ligjëratë tematike për studentët e Fakultetit Muzikë Moderne,

Produksion Digjital dhe Menaxhment, gjithnjë duke respektuar masat e marra nga Ministria e Shëndetësisë për virusin COVID-19.

Tenori Ramë Lahaj, ndau me studentët eksperiencën e tij profesionale në fushën e muzikës dhe shkëmbeu përvojat e tij në rrugëtimin drejt suksesit që ai tani po shijon në muzikë.

Në bashkëbisedimin që ai kishte me studentët, Lahaj u shpjegoi atyre rëndësinë që ky profesion ka për të, dhe i shtyu ata që të vazhdojnë këtë rrugë që ata kanë zgjedhur.

"Gjeni zhanrin që ju dëshironi edhe ju përshtatet, ngrihuni njëherë intelektualisht e pastaj profesionalisht. Keni

vetëbesim dhe besoni në atë që ju dëshironi të bëni", tha tenori Ramë Lahaj, drejtuar studentëve të Fakultetit të Muzikës Moderne, Produksion Digjital dhe Menaxhment.

Pjesëmarrës në këtë ligjëratë ishte edhe rektori, prof. dr. Edmond Hajrizi, i cili falënderoi tenorin Ramë Lahaj për prezencën e tij dhe mundësinë e shkëmbimit të përvojave të tij me studentët.

"Ramë Lahaj është model i suksesit dhe është një shembull i mirë edhe i këngëve të kombinuara popullore dhe artistike, që i bëjnë vlerat më ndryshe. Ajo që ka bërë nuk është një punë e lehtë, por e mundshme", është shprehur rektori Hajrizi.

Mbillen perime në laboratorin bujqësor të UBT-së

UBT ka vite që ka ndërtuar serra të tipit shkollor, me qëllim që studentëve t'u krijohej një ambient atraktiv, motivues dhe praktik për mësim në fushat përkatëse.

Parcelat e ndara çdo vit po mbillen me produkte bujqësore, teksa si të tilla do të shërbejnë si laboratorë eksperimental për studentët, sidomos atyre të fushës së Agrikulturës dhe Shkencave të Ushqimit.



Duke përdorur teknologjinë, tashmë në këto serra janë mbjellur qindra bimë të perimeve të llojit të domateve, trangujve dhe specave.

Serra do të shfrytëzohet si një laborator fushor për eksperimente të ndryshme nga personeli dhe studentët, ku rezultatet e fituara do të përcjellen në sektorin e prodhimit si kontribut i UBT-së në përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së prodhi-

meve bujqësore.

Njëherësh, këto parcela eksperimentale me kultura bujqësore do t'u mundësojnë studentëve të UBT-së punën praktike, teksa ky projekt në të ardhmen do të zgjerohet dhe do të përfshinë parcela për bimë lavërtare, sektori për pemë dhe perime, bimë dekorative dhe lule të ndryshme.

Bisedë: Dekanja e Fakultetit Juridik në UBT, Jorida Xhafaj

Gratë duhet të insistojnë për trashëgiminë e pronës

“Samëshumë emancipoheshoqëritë, samëshumëtë rritet niveli i arsimit dhe ndërgjegjësimi, do të ketë përpjekje për të zvogëluar këtë problematikë sociale, sepse duke ndërvepruar do të kemi rezultate”, tha dr. Xhafaj

Barazia gjinore edhe sot mbetet ndër problemet sociale më të përhapura anembanë botës, gjë që rrjedhimisht shkakton jostabilitet shoqëror.

Ky fenomen në shoqërinë tonë buron nga e kaluara, kur mashkulli kishte të drejta autoritare, dhe kur e drejta zakonore trajtonte rolin e gruas më shumë si nevojë për riprodhim biologjik, shërbim dhe edukim të fëmijëve.

Dekanja e Fakultetit të Juridikut në UBT, Jorida Xhafaj, për portalin UBTNEWS ka thënë se pabarazitë ndaj femrave shprehen në forma të ndryshme në shoqëri.

“Sa më shumë emancipohen shoqëritë, sa më shumë të rritet niveli i arsimit dhe ndërgjegjësimi, do të ketë përpjekje për të zvogëluar këtë problematikë sociale, sepse duke ndërvepruar do të kemi rezultate”, tha ajo.

Tutje, Xhafaj ka diskutuar për çështjen e të drejtave të trashëgimisë nga ana e femrave e që si problem ka vite që po trajtohet. Shumë organizata, tryeza diskutimi mbahen për mbrojtjen e të drejtave për trashëgiminë me qëllim të ngritjes



së vetëdijes së shoqërisë mbi atë se edhe femrat duhet të të gëzojnë pasurinë e tyre.

“E drejta në trashëgimi vjen si një e drejtë e çdo vajze, e çdo nëne, apo motre për të trashëguar paraardhësin e saj, dhe të jetë e barabartë me anëtarët e tjerë të familjes. Por jemi përballë dy

situatave të ndryshme: ka raste kur bëhet diskriminim nga familja, por ka edhe raste kur femrat vullnetarisht heqin dorë nga marrja e pasurisë nga familja, sepse prona ndjek njeriun, jo njeriu pronën”, deklaroi Xhafaj.

E pyetur se sa janë të informuara femrat mbi ligjet dhe këshillat

juridike mbi të drejtat e tyre, ajo tha se dita-ditës po ka më tepër interesim mbi këto tema.

“Kjo dallon mbi dy kritere, pra atë të vendbanimit. Në zonat urbane informimi dhe ndërgjegjësimi është më i lartë, kurse në zona rurale është më i ulët, dhe dallon mbi bazë edukimi”, u shpreh Xhafaj.

Ndonëse vitet e fundit po bëhet përpjekje e vazhdueshme për barazi gjinore, hulumtime dhe analiza të ndryshme të bëra në Kosovë flasin për mospjesëmarrje të barabartë në tregun e punës në mes të femrave dhe meshkujve në fushën e biznesit, por duket se kjo dukuri ka filluar të ndryshojë.

“Pjesëmarrja e femrave në punë është më e vogël në krahasim me meshkujt, por që ka filluar të rritet me 2.1, 2.4 % e që është shumë pozitive. Ka pasur një rritje të ndjeshme të aktivizimit të grave në biznese apo sipërmarrje. UBT po ashtu para periudhës pandemike zhvillonte aktivitete si në festën e 8 marsit, shënimin e ndonjë suksesi në cilëndo fushë. Pra nuk do të thotë të jesh vetëm e arsimuar, por edhe unike, me angazhime në atë që e bëjnë më së miri”, u shpreh ajo.

Megjithatë në Republikën e Kosovës ekziston ligji për barazi gjinore, i cili specifikon përfaqësimin e barabartë gjinor në të gjitha institucionet, dhe si të tilla gratë në Kosovë duhet të përfaqësojnë 50% të fuqisë punëtore në institucione publike.

Flet psikologjia klinike dhe psikoterapistja në Qendrën Këshilluese për Studentë

Pllana: Rëndësia e kujdesit mendor gjatë përballjes me Pandeminë COVID-19

Që nga fillimi i Pandemisë COVID-19 në vendin tonë, në kuadër të Qendrës Këshilluese për Studentë, qendër kjo e cila tash tre vite ofron mbështetje psikologjike për të gjithë studentët e Kolegjit UBT, janë mbajtur shumë aktivitete me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve për rëndësinë e kujdesit për shëndetin mendor gjatë situatës pandemike. Kjo situatë sfiduese ka shkakuar një çrregullim të jetës së përditshme, duke zënë njerëzimin mjaft të papërgatitur në të gjitha nivelet. Nga të gjithë ne, pavarësisht moshës, gjinisë, etnisë, profesionit apo pozitës socio-ekonomike, është kërkuar mobilizim në nivel personal, familjar, komunitar, shoqëror e shtetëror për t’iu përgjigjur dhe përshtatur kërkesave dhe ndryshimeve që ka sjellë kjo situatë. Medoemos, ky mobilizim i përnjëhershëm mund të shkaktojë nivel të lartë të stresit dhe mund të rrezikojë shëndetin mendor.

Shëndeti mendor përfshin mirëqenien tonë në shumë nivele, si atë emocionale, psikologjike dhe sociale, dhe është vetë mënyra se si ne mendojmë, ndjehemi dhe veprojmë. Gjithashtu, shëndeti mendor përcakton mënyrën tonë unike të reagimit ndaj stresit, mënyrën se si lidhemi me të tjerët, si zgjidhim problemet, si marrim vendimet tona apo bëjmë zgjedhjet në jetë. Shëndeti i mirë mendor përfshin një nivel të kënaqshëm, apo një ekuilibër të funksionimit emocional, kognitiv dhe të përshtatjes së sjelljeve, dhe si i tillë ka ndërlidhje të fuqishme me shëndetin tonë fizik, sepse mendja dhe trupi janë një. Kujdesi për shëndet në përgjithësi, e për shëndetin mendor në veçanti, është i rëndësishëm në çdo kohë e në çdo



moshë, sidomos përballë situatave stresuese. Prandaj, në nivel botëror është një brengë e shtuar në mesin e profesionistëve të shëndetit mendor për faktorët e shumtë të shkakuar nga ballafaqimi me pandeminë të cilët mund të rrezikojnë shëndetin mendor.

Faktorët stresues të shkakuar nga ballafaqimi me situatën pandemike, përfshirë edhe kufizimet në lëvizje të lirë dhe karantinë, së pari kanë rrezikuar një përkeqësim dhe rëndim të gjendjes psikologjike të personave të cilët veçse kanë vuajtur nga ndonjë çrregullim psikologjik, siç është depresioni apo ndonjë nga çrregullimet e ankthit, si dhe të personave me histori të traumës. Mirëpo, këta stresorë

kanë rrezikuar edhe mirëqenien psikologjike të personave pa ndonjë histori të shqetësimeve të natyrës psikologjike. Stresorët si rreziku i infektimit me virusin korona, ekspozimi i tepruar në lajme negative, humbjet në njerëz, kufizimi i kontakteve me personat e rëndësishëm, ndryshimi i stilit të jetës, humbja e sigurisë në punë dhe e sigurimit të të ardhurave, e shumë ndryshime të tjera të përnjëhershme, tek shumica e njerëzve kanë nxitur reaksione negative emocionale dhe kognitive. Shumë persona kanë përjetuar frikë, preokupim dhe brengë të shtuar rreth shëndetit dhe mirëqenies së vet dhe të të dashurve të tyre, disponim depresiv si: pikëllim,

humbje shprese e vullneti dhe pasiguri të madhe për të ardhmen. Prandaj kujdesi për shëndetin mendor dhe përkrahja e personave të cilët hasin në më tepër vështirësi përballë këtyre stresorëve janë bërë edhe më të domosdoshëm gjatë kësaj periudhe sfiduese.

Kujdesi për shëndetin mendor dhe mirëmbajtja e një ekuilibri të kënaqshëm psikologjik përfshin një sërë veprime dhe aktivitete, të cilat duhet të zbatohen rregullisht. Pikë së pari, është i rëndësishëm kujdesi për shëndetin fizik duke i plotësuar organizmit nevojat themelore, si ushqimin e rregullt dhe me vlera ushqyese, gjumin e mjaftueshëm, dhe aktivitetet fizike. Gjatë kësaj periudhe është e rëndësishme edhe mirëmbajtja e rutinës ditore, duke planifikuar me kujdes orarin ditor për të mundësuar realizimin sa më të plotë të objektivave dhe detyrave qoftë individuale, familjare, studentore apo profesionale. Kjo na mundëson të mirëmbajmë ndjesinë e kompetencës personale dhe të vazhdojmë të ndjehemi të plotësuar në nivel personal dhe profesional. Në aspektin social, sistemi përkrahës luan një rol tejet të rëndësishëm, prandaj duhet të mirëmbajmë kontakte me personat e rëndësishëm, duke marrë dhe dhuruar përkrahjen e nevojshme për mirëqenien tonë. Në momentet kur stresorët mund të na duken të papërbullueshëm, secili nga ne duhet të konsiderojmë edhe të kërkuarit ndihmë nga profesionistët e shëndetit mendor, posaçërisht psikologut. Përmes një qasje të paanshme dhe profesionale, psikologu përmes këshillimit psikologjik mund të na ndihmojë të fitojmë një këndvështrim më kuptimplotë ndaj problemeve dhe si

rezultat të ndërtojmë shkathtësi të reja për tejkalimin e tyre. Gjithashtu ushtrimet e teknikave relaksuese, përfshirë edhe meditimin dhe “Mindfulness” i mundësojnë mendjes përqendrimin në “këtu dhe tani” dhe lirimin nga preokupimet dhe brengat e tepruara për situatën e rëndë dhe të ardhmen. Përmes këtij përqëndrimi mësohet edhe nderimi dhe respektimi i ndjenjave të cilat i përjetojmë, të cilat shpeshherë bëhen shumë më të fuqishme kur mundohemi të luftojmë apo shtypim.

Duke aplikuar në mënyrë të rregullt hapat e lartpërmendur për kujdesin e shëndetit mendor ne mund të arrijmë të fuqizojmë aftësitë tona të lindura për përshtatje, tejkalim të vështirësive, ripërtëritje, rimëkëmbje, madje edhe të dalim më të fuqishëm nga kjo situatë dhe më të përgatitur për situata të ngjashme në të ardhmen. Mirëmbajtja e ekuilibrit psikologjik dhe menaxhimi i stresit e ankthit gjithashtu ndikojnë dukshëm në një kthjellësi më të mirë mendore, në ngritje të imunitetit, në reagime më të shëndetshme emocionale, në mirëmbajtje më të frytshme të marrëdhënieve ndërpersonale, në realizimin e qëllimeve jetësore, e si rezultat në një vetë-koncept dhe vetë-vlerësim më pozitiv. Duke filluar ditën me moton “përballë kësaj situatë unë po e bëj më të mirën e mundshme” dhe duke ia kujtuar shpesh vetes thënien e famshme “një mendje e shëndoshë në trup të shëndoshë” ne të gjithë mund të bëjmë më shumë për tu kujdesur për vete, të dashurit tanë, madje edhe për të ofruar përkrahje për personat në nevojë.

Elita Hajrizi dhe Vlera Saraqi synojnë fitore në Garën Ndërkombëtare të Microsoft Office Specialists

Ekipi i përbërë prej studentëve të UBT-së, Elita Hajrizi, Vlera Saraqi dhe Artin Ahmeti, do të përfaqësojë Kosovën në kuadër të UBT-së në Kampionatin Botëror të Microsoft Office Specialist në New York. Treshja fantastike muaj më parë u shpallën fitues nga Certiadria në Kampionatin Ballkanik të Microsoft Office Specialist 2020. Gjatë intervistës në Radio Campus, ato folën për përgatitjet që po bëjnë për të përfaqësuar Kosovën sa më mirë në mesin e shteteve tjera.

"Përgatitjet për këtë garë janë intensive, ne shfrytëzojmë rastin ta falënderojmë kolegjin UBT për përkrahjen e vazhdueshme dhe përgatitjen profesionale. Veçanërisht, falënderojmë profesorin Besnik Skenderi i cili punon



vazhdimisht me ne në mënyrë që të jemi të suksesshëm", tha Hajrizi.

Gjatë intervistës, Vlera Saraqi foli edhe për sfidat më të mëdha gjatë procesit të përgatitjes për këtë garë.

"Sfida më e madhe është

gjithmonë koha e limituar për të zgjidhur detyrat në mënyrë korrekte. Emocionet janë shumta dhe natyrisht që kufizimi i kohës e bën edhe më sfiduese pjesën e garës", tregoi Saraqi.

Ndërkaq, të pyetura për al-

ternativat tjera në rast të pamundësisë së zhvillimit të garës për shkak të gjendjes pandemike, ato treguan se shpresojnë të mbahet në New York, mirëpo mundësia tjetër është edhe zhvillimi i garës online.

Ato tutje shtuan se synojnë ta përfaqësojnë Kosovën denjësisht dhe të kthehen si fituese të vendit të parë.

"Synimi ynë është që të japim më të mirën nga vetja dhe të kthehemi fitues nga gara internacionale duke bërë krenar shtetin e Kosovës. Ndërkaq këshilla jonë për të rinjtë e vendit tonë është që të mos ndalen duke punuar për qëllimet e tyre", shtoi Hajrizi. Ndërkaq, kujtojmë që ekipi i Kosovës ka marrë pjesë edhe në gara të tjera në nivel ndërkombëtar, duke veçuar garën "FIRST Global Challenge", në të cilën UBT është vlerësuar nga organizatorët dhe ka marrë medalje të artë për kontributin dhe mbështetjen që ka dhënë dhe po jep për FIRST Global.

"Gresabosh" brendi nga Gresa Boshtraj



Dizajni dhe moda janë fushë e veçantë e viteve të fundit edhe shumë e kërkuar në Kosovë.

Gresa Boshtraj është ish-studente e drejtimit Dizajn i Integruar në UBT, e cila menjëherë pas përfundimit të

studimeve, në moshën 21 vjeçare ka arritur që të fillojë brendin e saj me veshje mjaft të veçanta dhe të bukura.

Në emisionin "N'Stop" në Radio Campus, Boshtraj tregoi për publikun së këto kreacione kanë qenë krijim i peri-

dhës së karantinës.

"Më thënë të drejtën, përgatitja e veshjeve të para ka qenë si diçka si kreacion. Në kohën e karantinës kam thënë pse mos me i shfrytëzua këto kohë pasi veç jam duke ndejtur edhe nuk jam duke bërë diçka, të bëj diçka kreative. Me

ndihmën e prindërve që ma kanë blerë një pajisje edhe një makinë qepëse, kam filluar me i vendos disa gjëra në skica dhe kam dashur të përdorë kontraste, kam dashur me përdorë ngjyra dhe veç i kam bërë disa punime, pastaj i kam lansuar si në formë të koleksionit", tregoi ajo.

Ajo çka është shumë e veçantë tek krijimet e Gresabosh apo ndryshe "GraceBosh" janë edhe ngjyrat të cilat përdoren dhe mënyrat se si ajo i emërton ajo.

Sipas saj, ajo ka arsye të veçantë për emërtimin e këtyre veshjeve, e kjo sepse kur brendi i saj të marrë përmasa botërore, të përdoren fjalët shqipe.

"Përpos ngjyrës që për shembull një veshje që i ka nuanca të kaltrës e kam quajtur "Qielli", përpos asaj kam vendosur që edhe "Gresabosh"

kur të bëhet dikur brend më botëror, këto ende të thirren në gjuhën shqipe sepse mendoj se është gjuhë tepër e bukur, dhe pse jo me i titullua në gjuhën tonë", shtoi ajo.

Boshtraj ka krijuar shumë veshje të ndryshme, mirëpo sipas saj, veshja me e pëlqyer ka qenë një

kreacion i punuar me kompjuter dhe që paraqet një pamje të inspiruar nga koralet.

"Një fustan që është bërë me ilustrim me kompjuter edhe që i kemi paraqitur pastaj në tekstil. Është njëra prej veshjeve që është pritur më së miri. Është një veshje me lloj enëve të gjakut, në njëfarë mënyre po është e inspiruar prej koraleve", deklaroi ajo.

Fokusi i Greses mbetet përdorimi i teknikave dhe ngjyrave të veçanta dhe inspirimi kryesor i saj është natyra dhe pafundësia e saj.

Rritja e imunitetit përmes ushqimeve, këshilla nga nutricionistja Dafina Demolli

Të ushqyerit e shëndetshëm është një nga dobitë më të mëdha që mund t'i bëjmë trupit tonë. Ushqyerja me vitamina dhe minerale bënë që trupi jonë të funksionojë në mënyrë normale dhe pa probleme. E në kohë pandemie, trupi jonë më shumë se kurrë ka nevojë për vitamina të cilat ndikojnë në rritjen e imunitetit.

Nutricionistja Dafina Demolli, ish-studente e UBT-së në drejtimin Shkenca të Ushqimit dhe Bioteknologji, e ftuar në emisionin "STOP" në Radio Campus tregoi detajisht për rëndësinë që kanë ushqimet gjatë kësaj periudhe, ku rritja e imunitetit ka rëndësi të madhe.

"Kemi një laramani të ush-

qimeve që rrisin imunitetin. Të gjitha ushqimet që përmbajnë vitaminë C, si psh, tani që edhe jemi në sezonën e dimrit dhe kemi frutat sezonale si mandarina, portokalli, grejpfruti të cilat kanë sasi të lartë të vitaminës C. Kivi, luleshtrydhet, limoni dhe speci i kuq, kanë sasi të lartë të vitaminës C, brokoli ka vitamina dhe minerale dhe po ashtu është i pasur dhe me antioksidantë. Hudhra gjithashtu është një ushqim që ndikon në rritjen e imunitetit", u shpreh ajo.

Tutje ajo tregoi se edhe xhinxheri, spinaqi, jogurti, bademat, lajthitë dhe çaji i gjelbër, janë të rëndësishme për sistemin imunitar.

Demolli në vazhdim tregoi



edhe për arsyet e tjera pse duhet të përdoren frutat dhe perimet e lartpërmendura. "Gjatë sezonit të dimrit jemi më të atakuar ndaj viruseve dhe ne duhet të marrim ush-

qime që rrisin imunitetin, pra ato të pasura me vitaminë C, zink, jod dhe vitaminë B12 dhe siç e përmenda tërshërën e ngrohtë apo edhe disa gjella që konsumohen të ngrohta,

pasi që temperaturat janë të ulëta dhe na duhen edhe ushqimet nga jashtë për ta mbajtur temperaturën e trupit në normale që është 37 gradë celsius", vazhdoi Demolli.



Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

- Financa, Banka dhe Sigurime
- Kontabilitet, Auditim dhe Tanimë
- Marketing dhe Shitje
- Ndërmarrjet dhe Inovacion
- Biznes Ndërkombëtar
- Logjistika dhe Menaxhimi i Prokurimit
- Menaxhment, Ndërmarrjet dhe Inovacion



Shkencë Komputere dhe Inxhinieri

- Inxhinieri e Sistemeve Software
- Database dhe Sisteme të Informacionit
- Rrjeta dhe Telekomunikacion
- Robotikë dhe Multimedia
- Web Programim
- Robotikë dhe Sisteme Inteligjente
- Informatika Biomjekësore
- Siguria dhe Sigurimi Informacionit
- Informatika Mjekësore
- Sistemet e Database
- Inxhinieri e Komunikimit
- Shkencë e të Dhënave Statistike



Menaxhimi i Mekatronikës

- Menaxhimi i Mekatronikës
- Automatizim Industrial dhe kontrolli Procesi
- Dizajn i Produktive Industriale
- Robotikë dhe Sisteme Inteligjente
- Inxhinieri e Biomjekësorë
- Inxhinieria Elektrike dhe Elektrike
- Inxhinieri Mekanike
- Inxhinieria e Telekomunikimit
- Inxhinieria e Aeronautikës
- Inxhinieri e Proceseve të Prodimit dhe Teknologjia



Media dhe Komunikim

- Gazetar (M)
- Komunikim (M)
- Menaxhimi i medias (M)
- Dizajn i Produktive Industriale
- Marredhënie me publikum (M)
- Regji televizive (M)
- Gazetar Online (M)
- Kamerë dhe Fotograf (M)
- Inxhinieria Elektrike
- Komunikimi politik dhe Organizatat (M)
- Media Digitalë dhe Komunikim (M)



Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment

- Burimet e Energjisë
- Konzentrimi i Energjisë
- Eficienca e Energjisë
- Teknologjia e Informacionit
- Menaxhimi i Energjisë
- Inxhinieria Elektrike
- Sistemet e Qendrueshme
- Konzentrimi i Energjisë në Ndërtesa
- Sistemet e Agriplotës dhe Ftohjes
- Energjia Elektrike dhe Tregjet e Energjisë
- Inxhinieri Energjetike dhe Mjedisit



Dizajni i Integruar

- Dizajni Grafik
- Dizajni i Produktive
- Dizajni Mode
- Dizajni i Entertent
- Menaxhimi i Energjisë
- Inxhinieria Elektrike
- Sistemet e Qendrueshme
- Konzentrimi i Energjisë në Ndërtesa
- Sistemet e Agriplotës dhe Ftohjes
- Energjia Elektrike dhe Tregjet e Energjisë
- Inxhinieri Energjetike dhe Mjedisit



UBT DUKAGJINI Pejë

- Shkencat e Administrimit
- Administrim Biznesi
- Banka, Financa dhe Kontabilitet
- Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi (A)
- Financa, Banka dhe Sigurime
- Kontabilitet, Auditim dhe Tanimë
- Marketing dhe Shitje
- Menaxhment, Ndërmarrjet dhe Inovacion
- Logjistika dhe Menaxhimi i Prokurimit
- Menaxhment, Ndërmarrjet dhe Inovacion
- Biznes Ndërkombëtar
- Biznes Ndërkombëtar
- Biznes dhe Teknologji (BA / Joint Degree) (A)
- Dizajni i Integruar (Dizajn Grafik • Dizajni Produktive • Dizajni Entertent) (A)



UBT ARBËRI Gjiroka

- Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi (A)
- Financa, Banka dhe Sigurime
- Kontabilitet, Auditim dhe Tanimë
- Marketing dhe Shitje
- Menaxhment, Ndërmarrjet dhe Inovacion
- Biznes Ndërkombëtar
- Logjistika dhe Menaxhimi i Prokurimit
- Biznes dhe Teknologji (BA / Joint Degree) (A)



UBT ESIG Peshëna

- Juridik dhe Menaxhimi i Paturdshmerive dhe Infrastrukturas (Other Slovenian internationally recognized degree, provided by European Faculty of Law)
- Menaxhimi i Paturdshmerive dhe Infrastrukturas (A)
- Zhvillim dhe Urbanizëm



Sistemet e Informacionit

- Sisteme të Informacionit
- Sistemet e Informacionit për Biznes
- Sistemet e Informacionit të bashkëveprimit dhe Arkivimi
- Tregtia Elektronike
- Sistemet e Informacionit, Siguria dhe Privatësia
- Sistemet e Geo-Informacionit
- Statistikat, Procedori i të Dhënave dhe Simulimi



Juridik

- Civile
- Penale
- Nderkombëtare
- E Drejta Civile dhe e Procesi
- E Drejta Nderkombëtare dhe Evropiane e Biznesit
- E Drejta Nderkombëtare dhe Evropiane e Biznesit
- Juridik, Krimnologji Komputertike dhe Forenzike



Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

- Arkitekturë e Qëndruesheshme
- Menaxhimi Urban
- Restaurim Arkitektural
- Mërbajtje dhe Restaurim në Arkitekturë
- Dizajn Entertent



Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji

- Teknologjia e Ushqimit
- Nutricion (Te Ushqyent)
- Menaxhimi dhe Sigurimi i Citesave të Ushqimit
- Shkencë dhe Inxhinieria e Ushqimit



Inxhinieri e Agrikulturës dhe Mjedisit

- Prodhimaria Bimore
- Agrobiznes
- Menaxhimi i Mjedisit në Hortikulturë (M)
- Kompozim / Kengshkrues (M)
- Performanca Vokale (M)
- Audio Produksion (M)
- Menaxhment Muzikor (M)



Muzikë Moderne, Produksion Digital dhe Menaxhment

- Kompozim / Kengshkrues (M)
- Performanca Vokale (M)
- Audio Produksion (M)
- Menaxhment Muzikor (M)



Inxhinieri Nderimore (Nderimtari) dhe Infrastruktura

- Inxhinieri Nderimore (Nderimtari dhe Infrastruktura)
- Inxhinieri Strukturore
- Menaxhimi Nderimtari dhe Teknologji
- Infrastruktura Bruqore
- Inxhinieri e Ujrave
- Inxhinieri e Gjeoteknikës
- Inxhinieri e Materialeve



Shkencë Politike

- Administrim Publik
- Marredhënie Nderkombëtare dhe Diplomaci
- Integrimi Evropiane
- Integrimi dhe Qeverisja (Postig)
- Shkencë Politike (M, A)



Politika Publike dhe Menaxhimi

- Politika Publike
- Marredhënie Nderkombëtare dhe Diplomaci
- E-Qeverisje
- Art dhe Media Digitale (M)
- 3D animacion (M)
- Dizajni Digital (M)
- Efektet Vizuale dhe Film (M)
- Multimedia Design (M)



Arti dhe Media Digitale

- Art dhe Media Digitale (M)
- 3D animacion (M)
- Dizajni Digital (M)
- Efektet Vizuale dhe Film (M)
- Multimedia Design (M)



Fakultetet mjekësore dhe shëndetësore

- Informetari (B)
- Stomatologji (Ordent)
- Farmaci (Mn)
- Teknikë i Radiologjisë (B)
- Teknikë i Anestezjologjisë (B)
- Mjekësi e Përgjithshme (A)
- Bachelor Profesional në Fizioterapi (A)
- Kujdesi Palliativ dhe Kurorjik (A)
- Shkencë paramjeksore (A)
- Shëndet Publik dhe Menaxhim (A)
- Laborant i Biokimisë Mjekësore (A)
- Teknik Dentari (A)

UBT

Programet në proces të akreditimit

Biznes dhe Teknologji (B)

- E Drejta Penale (LLM)
- Dizajni i Integruar i Avancuar (M)
- Dizajni i Modës (M)
- Dizajni Produkti (M)
- Dizajni Grafik (M)
- Dizajni Interieri (M)

Psikologji (B)

- Gjuhë Argeze (B)
- Shkencë të Sportit dhe të Lëvizjes (B)
- Studime të Sigurisë (B)
- Gjuhë dhe Kulturë (B)

Biznes dhe Teknologji (PHD)

- Trafiku dhe Menaxhimi i Transportit (B)
- Zhvillim dhe Urbanizëm (M)
- Trajtimin Kulturor dhe Menaxhim i Turizmit (M)

Simply the Best!

- Lider i Asistentit të Lartë në Evropën Juglindore
- Medalla e Artit në Botë për Kontribut të Shkencës dhe Teknologjisë
- I vertet i certifikuar sipas standardeve ISO 9001:2015 për cilësi
- Njohuri me mjetet programore inovative në Kosovë
- Vendet partner në botë për implementimin e rezultatit Virtual në mesindimshme CLASSROOM 3.0
- Aplikjo online: www.ubt.uni.net/apliko
- Aplikjo në qendrat për informim dhe regjistrim në Prishtinë, Ferizaj, Prizren, Gjakovë, Gjiroka, Pejë.



2021